ISSN 1857-6443

VMRO këmbëngul për zgjedhje, Zaevi kërkon pajtim

Fq.3

OEM JEP ALARMIN

Kriza politike po dëmton ekonominë

Fq.5

Mësonjëtorja si metaforë në miniaturë

Fq.11

www.koha.mk

Koha

KOHA për kulturë

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3485 · e martë, 16 tetor 2018 · 9°c | 23°c · 15 DEN

EDITORIAL

Bashkëjetesa politike shqiptaro-maqedonase

Fuqia politike e faktorit vendimmarrës maqedonas gjithmonë është varur nga shkalla e kohezionit brendashqiptar dhe për fat të keq kjo fuqi ka ardhur duke u rritur fal mungesës së bashkëpunimit dhe bashkërendimit të forcave politike të shqiptarëve. Deri më tani nuk ka...

Fq.2

RAJON

Parlamenti i bllokuar

Fq.16

DOSSIER

Historia e Legjionit të Huaj Francez

Fq.19

GLOBI

Markus Söder, kryeministri më i padashur

Fq.17

110 VJETORI, SI NJË GJYSMË FESTE DHE GJYSMË ÇMIMI

SHKUPI DËSHTON NË VITIN E GJERGJIT

Maqedonia, të cilës nga Këshilli mbarëshqiptar iu caktua detyra për të marrë përsipër shënimin e Kongresit të Manastirit, do të dështojë në zhvillimin e aktiviteteve qendrore. Përveç shqetësimit të Muzeut të Alfabetit lidhur me qytetin se ku do të zhvillohet manifestimi qendror, në Shkup apo Manastir, edhe përfaqësues të Maqedonisë në Këshillin mbarëshqiptar janë të alarmuar nga neglizhenca institucionale për hartimin e programit qendror

Fq.4

Pak na kujtohet t'ia shtrijmë dorën tjetrit

Shkup, 15 tetor - Maqedonia është ranguar në vendin e tetë në korniza botërore sipas sasisë së ushqimit të hedhur sipas numrit të banorëve. Rreth 30 për qind e ushqimit të prodhuar apo importuar në Maqedoni asnjëherë nuk konsumohet. Vlerësimet se hedhim 12.000 tonë ushqim me të cilat mund të sigurohen nga tre shujta në ditë për 26.000 qytetarë, ndërkaq tepricat e përgjithshme tejkalojnë 100.000 tonë. Sipas lëvizjes "Eja Maqedoni", vetëm në Prespë këtë vit janë hedhur dhjetëra mijë tonë ushqim. "Vetëdija tek kompanitë dhe organizatat joqeveritare është ngritur, gjithnjë e më shumë regjistrohen, ndërsa qytetarët paraqiten si vullnetarë. Por, ajo që shqetëson është vetëdija tek të rinjtë. Për fat të keq, ata rritën në 'konsumizëm klasik', të cilët duan diçka të shpejtë të shijojnë dhe të hedhin...

Fq.7

EDITORIAL

BASHKËJETESA POLITIKE SHQIPTARO-MAQEDONASE

Emin AZEMI

Fuqia politike e faktorit vendimmarrës maqedonas gjithmonë është varur nga shkalla e kohezionit brendashqiptar dhe për fat të keq kjo fuqi ka ardhur duke u rritur fal mungesës së bashkëpunimit dhe bashkërendimit të forcave politike të shqiptarëve.

Deri më tani nuk ka ndodhur që një parti politike shqiptare , fituese e zgjedhjeve në elektoratin shqiptar, të ketë refuzuar pjesëmarrjen në bashkëqeverisje me ndonjë parti tjetër maqedonase, për shkak të ofertës substanciale që ajo ka ofruar. Deri më tani nuk ka ndodhur që partia më e madhe politike shqiptare që ka dal e para në zgjedhje, të ketë përfshirë në platformën e saj (bashkë)qeverisëse edhe ndonjë gjetje interesante nga platformat e partive tjera simotra shqiptare në Maqedoni.

Deri më tani, partitë shqiptare që ia kanë mësyrë pushtetit, nuk e kanë provuar të sjellin edhe kuadro të përgatitur nga diaspora, të cilët do të ishin një krenari kombëtare dhe një shkëlqim që do të errësonte mitin sllav për "shqiptarin e paaftë të bëjë shtet".

Në anën tjetër, sindromi i zgjatimit në politikë, nuk është fenomen i panjohur, por kur ai shndërrohet në doktrinë ka rrezik që të bëhet pengesë për zhvillimin normal të ideve dhe platformave autentike e origjinale.

Shqiptarët në Maqedoni, çuditërisht prej vitesh e kanë kultivuar këtë sindrom dhe ai ka ardhur duke u zhvilluar në përmasat e një nyje që padrejtësisht ka bllokuar kapilarizimin e jetës politike. Mungesa e platformave kombëtare dhe dominimi i atyre partiake për përdorim ditor, ka bërë që cilësia e përfaqësimit institucional të shqiptarëve të limitohet në kornizat e një vasaliteti të pakuptimtë.

Dy opsionet dominante maqedone që kishin prejardhje të ndryshme ideologjike - VMRO dhe LSDM - me kalimin e viteve u bënë fatpërcjellëse të pashmangshme të shkëlqimit dhe rënies së lavdisë politike të shqiptarëve të Maqedonisë. Si një hije që ndjek udhëtarin e lodhur në shkretëtirë, ishin pikërisht këto dy opsione dhe për pasojë politikëbërja shqiptare, me apo pa vetëdije, u bë peng i ambicies së pashpjeguar për "bashkëshortësi" të përjetshme me këto dy parti kontradiktore maqedone.

Sikur pasojat negative të reduktoheshin vetëm në suaza të mendësisë politike, dëmi do të ishte shumëfish më i vogël, por ndodhi që kjo mendësi të shërbejë së letër lakmusi dhe të shtrihet si një lavë e rrezikshme në gjithë shoqërinë shqiptare, duke e bërë ndarjen edhe më të madhe në mes të shqiptarëve që filluan të identifikohen jo sipas afiniteteve intelektuale e krijuese, por në bazë të dostave dhe kumbarëve të tyre maqedonas. Kjo rrëshqitje e shkallëshkallshme e filozofisë politike të shqiptarëve të Maqedonisë në pragamtizmin banal të bashkëjetesës së dy tendencave etnike që pajtoheshin vetëm për çështje të politikës së ditës dhe për ndarjen e ndonjë trofeu që sjell pushteti, pamundësoi krijimin e frymës së bashkërendimit dhe bashkëpunimit brendakombëtar të shqiptarëve. Ndasia brendashqiptare sikur u bë lajtmotiv i politikave të papjekura që bashkëqeverisjen me partitë maqedone e shndërroi në dogmë nga e cila as sot e gjithë ditën nuk po lirohemi. Ky dogmatizim i teknologjisë së bashkëqeverisjes ka nxjerrë nga përdorimi energji të shumta krijuese e intelektuale të shqiptarëve në Maqedoni dhe diasporë .

Shqiptarëve të Maqedonisë iu nevojitet një absorbim më i madh i mendjeve e veprimeve, në mënyrë që politikat e tyre të mos jenë zgjatime karikaturale të doktrinave djathtiste e majtiste maqedonase. Hapësirë për opozitarizëm të shpifur brendashqiptar nuk ka gjithaq, sepse ajo hapësirë duhet mbushur me idetë e parrumbullaksuara të një zgjimi kombëtar dhe një kundërvënie intelektuale doktrinave maqedone të cilat ende shkëlqimin e tyre e matin me errësirën e sinkopave shqiptare.



PUNËTORËT TRAJTOHEN SI SKLLEVËR

"Gjasat janë maksimale që brenda javes apo muajit të vdes edhe një njeri. Ne vendin e tij te punës, ne kompanite e ndertimit. Shumica e tyre i trajtojne si skllever.

Lajmi për këtë ndodhi tashmë është bërë i zakonshem. Ashtu siç është bërë normale dhe e zakonshme që askush të mos marre pergjegjesi institucionale. Gjendja nuk po ndryshon dhe i njejti njeri vazhdon qe të mbetet ne krye te Inspektoriatit te Punes. Kryeinspektori Basri Ibrahimi.

Ministri i Punes, Skender Reçica, ka pohuar se ka kërkuar më shumë pune nga inspektoret. Por, kjo nuk mjafton. Ai duhet qe ta shkarkoje Ibrahimin nga ky post. Per shkak te mos marrjes se masave adekuate. Nese nuk e bene kete, duhet që te japë vete doreheqje. Rrugë të mesme nuk ka", ka shkruar një status në Facebook, gazetari Parim Olluri.

MË LËHTË TA KRITIKOSH RADIKALIZMIN ISLAMIK SE SA LDK-në

"Më lehtë shpëton ta kritikosh radikalizmin islamik sesa LDK-në! Sipas tyre çdo kush që kritikon LDK-në është i porositur nga Hashim Thaçi, sidomos kur autori qëllon të ketë prejardhje nga Drenica, siç kam për shembull unë. Natyrisht se vlerësimet e tilla nuk e gëzojnë kurrkend më shumë se Thaçin, Veselin dhe klanin Pronto, sepse këta të fundit edhe vetë bëjnë një propagandë të tillë për të kompromettuar kritikat dhe autorët e tyre dhe njëkohësisht për të dekurajuar kndërshtarët politikë.

Ata duan që çdo shigetë drejtuar atyre në publik të kuptohet si një blof duke krijuar impresionin se të gjithë ne që shkruajmë kundër tyre, në fakt jemi të shitur tek ta dhe kritikat i bëjmë për ta kamufluar veten që më lehtë të punojmë për ta!!!

Duhet të keni mend aq sa ka një gjeldeti kur në mungesë faktesh më identifikoni mua si njeri të shitur te PDK-ja apo te kushdqoftë. Këto janë paranoja, apo paragjykime njerëzish të frustruar emocionalisht!

Më parë jeni të shitur ju militantët dhe aktivistët e LDK-së tek Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli sesa që jam unë. Këtë e keni deshmuar me sjelljet dhe veprimet e juaja shumë herë. Unë mund të gjejë shumë lidhje të përbashkëta biznesi dhe krimi mes jush, kurse ju nuk mund të gjeni as më të voglën lidhje që më bën mua të afërt me mafinë e çfarëdo grupi politik.

Shpesh na ngjan që LDK përçarjen e brendshme për interesa meskine, të na e shesë për demokraci dhe liberalizëm! Jo, kjo s'ka të bëjë asgjë me konceptin e demokracisë dhe liberalizmit, por vetëm me gjendjen anarkike të strukturimit partiak!

Një parti që nuk është e hapur ndaj opinioneve dhe kritikave të jashtme për ndryshime pozitive, nuk është parti liberale, por është parti demode dhe me kocept dogmatic", ka shkruar një status në Facebook, Liri Loshi.

MEDIACitate

SERBIA MË SHUMË BASHKËPUNON ME KOSOVËN SE ME RUSINË

Serbia ka bashkëpunim ekonomik shumë më të madh me Kosovën se sa me Rusinë. Këto fakte mund të verifikohen me shifra. Kështu ka deklaruar Sonja Liht, kryetare e Fondit të Beogradit për Politikë të Jashtëzakonshme. "Shikoni si duket bashkëpunimi ndërmjet dy odave ekonomike. Shikoni si duket eksporti ynë në Kosovë, Shikoni se si Kosova, për gjërat nga bujku deri te shërbimet tjera, edhe më tej është treg i rëndësishëm për afaristët tan", citon radio e Evropa e Lirë të ketë thënë ajo. "Për një gjë pajtohem me Aleksandar Vuçiqin, se është e domosdoshme një marrëveshje historike. Nuk më pëlqen termi "historik", sepse tmerrësisht po keqpërdoret, porse na duhet një marrë veshje shoqërore që do të ishte me rëndësi historike për dy popujt, qytetarët e të këtyre dy shoqërive", ka vlerësuar Liht. Sipas fjalëve të saj, zgjidhja, rregullimi, mjegullimi i "nyjës kosovare", siç është quajtur para shumë vjetësh, në fakt është ecje përpara, jo vetëm pse këtë po e kërkon Bashkimi Evropian, por për shkak se përfundimisht është në interesin tonë, sepse po hahen resurset, po hahet koha dhe asgjë e mirë nuk po ndodh.

(REL, 15 tetor)

TENSIONET SHBA-ARABI SAUDITE RRISIN ÇMIMIN E NAFTËS

Marka ndërkombëtare e naftës së papërpunuar, Brent ka filluar sot javën e tregtimit me rritje të çmimit në 81.42 dollarë për fuçi, ndërkohë që çmimi i markës amerikane të naftës së papërpunuar West Texas Intermediate (WTI) është ngjitur në 71.97 dollarë për fuçi. Të premten, nafta Brent tregtohej me 80.44 dollarë, ndërsa WTI 72.50 dollarë për fuçi. Pavarësisht nga mundësia për një rritje të prodhimit në SHBA, sanksionet amerikane mbi Iranin dhe rritja e tensioneve midis Arabisë Saudite dhe SHBA-ve janë nga faktorët të cilët ndikojnë rritjen e çmimeve në tregun e naftës. Të shtunën, presidenti amerikan, Donald Trump, kërcënoi Arabinë Saudite me "ndëshkim të rëndë" në qoftë se gazetari veteran Jamal Khashoggi rezulton të jetë vrarë. Arabia Saudite nga ana e saj u zotua se "do të bëjë një kundërgoditje" të gjitha kërcënimeve apo sanksioneve të vendosura, që kanë të bëjnë me zhdukjen e gazetarit Khashogg.

(Anadolu Agency, 15 tetor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH ISHTE LEKË MATRËNGA?

Lekë Matrënga ishte autori më i vjetër arbëresh i njohur. Lindi në Horë të Arbëreshëve (Sicili). Pasi kreu studimet në një kolegj fetar në Romë, u kthye në fshatin e tij ku shërbeu si prift. Më 1592 përktheu nga italishtja dhe botoi në Romë një katekizëm "E mbsuame e kërshterë". Vepra ka rëndësi të madhe, sidomos për dokumentimin e një faze të vjetër të të folmeve të arbëreshëve të Sicilisë. Ajo paraqet interes edhe për vjershën e shkurtër botuar në të, që është gjurma e parë e botuar e vjershërimit shqip.

Debati në Parlament do të zgjasë dhjetë ditë dhe tek të mërkurën e javës tjetër mund të presim që ndryshimet kushtetuese të procedohen nëpër votim. Kur jemi tek "amnistia", RDK në pushtet dhe Aleanca për Shqiptarët në opozitë janë shprehur kundër asaj që sulmuesve dhe organizatorëve të 27 prillit të lihen të lirë

FILLOI DEBATI PËR NDRYSHIMET KUSHTUESE

VMRO KËMBËNGUL PËR ZGJEDHJE, ZAEVI KËRKON PAJTIM

Koha — Fatos RUSHITI

Shkup, 15 tetor - Kryeministri Zoran Zaev më në fund i bëri thirrje opozitës për pajtim kombëtar lidhur me ngjarjet e 27 prillit të vitit të kaluar, me qëllimin që opozita të votojë ndryshimet kushtetuese për ti hapë rrugë anëtarësimit të vendit në NATO dhe në BE.

Kryeministri Zoran Zaev i bëri këtë ftesë opozitës të hënën në Parlament gjatë seancës plenare me pikën e vetme të rendit të ditës ndryshimi i Kushtetutës në bazë të marrëveshjes për zgjidhjen e çështjes së emrit me Greqinë. Kjo thirrje e kryeministrit për pajtim u kuptua si thirrje për amnisti, por se si do të ndodh kjo, nëse palët merret vesh, pritet të jetë një çështje mjaft e komplikuar politike dhe juridike.

Kjo, nga fakti se në të njëjtën kohë organet gjyqësore - mes tyre dhe Prokuroria Speciale Publike për momentin janë në vlugun e punës jo vetëm me procesin gjyqësor me ngjarjet e 27 prillit, por edhe me procesin gjyqësor lidhur me materialet e përgjuara kur dhjetëra funksionarë të VMRO-së, mes tyre dhe ish kryeministri Nikolla Gruevski, akuzohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe përfitim materiale. Por si Ilija Dimosvki dhe Dragan Danev, kërkesën e kryeministrit për bashkëpunim me opozitës për votimin ndryshimit të kushtetues e quajtën të vonuar nga fakti se, siç thanë ata, Zaevi punoi kokë më vete duke mos e ftuar opozitës në negociata me palën greke dhe as për lidhjen e Marrëveshjes me Greqinë. Ilija Dimosvki nga VMRO bile shkoi më tej duke thënë se kjo përbërje parlamentare nuk ka legjitimitetin e duhur për të ndryshuar Kushtetutën.

"Në përbërjen e Kuvendit, asnjë parti politike ose deputet nuk ka dhënë premtim për ndryshimin e Kushtetutës me qëllim të ndryshimit të emrit kushtetues. Koalicioni i VMRO-DPMNE-së para fushatës zgjedhore premtoi se nuk do ta lejojë këtë, ndërsa koalicioni i LSDM-së premtoi se nuk ka ndryshim të Kushtetutës. Ky Kuvend nuk ka legjitimitet zgjedhor që të hyjë në procedurë. Për ndryshimin e Kushtetutës nuk ekziston referendum konsultativ, ndërsa edhe përkundër kësaj, vendimi i miratuar në referendum është i obliguar", tha Dimovski. Bashkëpartiaku i tij, Dragan Danev u pajtua se këto janë momente historike për shtetin dhe popullin, megjithatë nuk mundet që kjo përbërje parlamentare të ndryshojë emrin e shtetit, sidomos pas dështimit të referendumit.

"Nuk mundet 120 njerëz të vendosin për dy milionë qytetarë, për gjeneratat e kaluara dhe të ardhshme. Kam përfaqësuar qëndrim edhe unë edhe partia se për këtë çështje duhet të shkohet në referendum dhe të respektohet vullneti i popullit. Dhe populli e tha fjalën e vet", tha Danev.

Deputeti Artan Grubi i BDI-së u bëri thirrje deputetëve nga opozita që t'i përkrahin ndryshimet kushtetuese, duke e krahasuar këtë moment me momente dhe personalitete të cilët janë regjistruar në histori, si në vend, ashtu edhe në botë.

"Për këtë qëllim, duke e pasur parasysh fuqinë e duarve tuaja, duke mos e konsideruar konfrontimin dhe kalkulimet partiake, duke e ditur rëndësinë e vendimit, paramendojeni vendimin tuaj me guximin e njëjtë të të lartpërmendurve dhe me vizionin tuaj personal për të nesërmen. Provokojeni populizmin dhe mosdijen, respektojeni detyrën dhe qëndroni në anën e duhur progresive, njëkohësisht edhe të historisë dhe të së ardhmes", porositi Grubi kolegët e tij. Ai u bëri thirrje, siç tha, të mos fshihen pas popullit, pasi ata janë zgjedhur që ta udhëheqin popullin, e jo të udhëhiqen nga populli.

"Mos mendoni në zgjedhjet e ardhshme, mendoni në gjeneratat e ardhshme, bëhuni protagonistë, e jo statistë", tha Grubi

Paraprakisht, kryeministri Zaev pati një fjalim të gjatë, por gjithnjë duke e vënë theksin tek shtrirja e dorës opozitës për pajtim. Ai bëri thirrje që deputetët të votojnë për ndryshime meqë vetëm ata e kanë çelësin për vendimin historik.

"Hajde të pajtohemi, hapi i parë le të jetë 27 prilli. Atëherë, të gjithë ishim shënjestër e mundshme nga individë të manipuluar, dhe kjo është mundësi e shkëlqyer, duke qëndruar bashkë për ardhmërinë e Maqedonisë dhe fëmijët tanë, që t'i falim dhe të pajtohemi. Hajde ju të anës së djathtë të Kuvendit jepuani dorën anës së majtë të Kuvendit, hajde ju kolegë të anës së majtë të, jepuani dorën anës së djathtë", tha Zaev. Barra e vendimit historik dhe e përgjegjësisë, shtoi Zaevi, shtrihet në supet e të gjithëve neve, por përgjegjësia më e madhe është në duart tuaja.

"Çdo deputet sot e ka në duar çelësin e asaj zgjidhje, çelësin për vendimin historik. U bëj thirrje atyre të cilët ende dyshojnë se cila është zgjidhja e duhur ose nëse mendojnë se duhet të përcaktohen për atë zgjedhjen tjetër nëse në përgjithësi izolimi dhe pasiguria mund të jenë zgjedhje, u bëj thirrje atyre që dyshojnë të mendojnë se nuk ka diçka më të vlefshme për të menduar", tha Zaevi para deputetëve duke u bërë thirrje të shikojnë në ardhmërinë e gjeneratave. Zgjedhja tjetër, sipas tij, do të na hedhë në izolim dhe ardhmëri të pasigurt dhe varfëri dhe do të na i kthejë traumat politike që i përjetuam në këto 27 vite pavarësi, e posaçërisht gjatë viteve të fundit. Vota për të ardhme evropiane të vendit tonë, siç tha ai, do të na çojë përpara në anëtarësim të barabartë në NATO dhe BE.

"Tani duhet të vendosni nëse do të fitojmë shumë apo do të humbim shumë", tha kryeministri duke theksuar se deputetët duhet të sjellin zgjidhje shtetërore. Zaevi bëri thirrje që dallimet dhe ndarjet politike të vendosen jashtë dhomës ligjdhënëse. Ai u bëri thirrje të gjithëve edhe pushtetit edhe opozitës që ta bëjnë këtë dhe se dihet që kjo ka çmim politik që është i gatshëm ta paguajë. "Nuk ka mënyrë tjetër që të pajtohet populli ynë nëse ne nuk pajtohemi fillimisht. Ejani të ngrihemi mbi paragjykimet tona politike dhe të mbartim përgjegjësi", tha kryeministri. Vendimin e Parlamentit, siç tha, e presin edhe qytetarët edhe bota. Zaev tha se Qeveria është e gatshme ta jetë maksimalisht e hapur për propozime nga opozita për amendamentet dhe për pranimin e amendamenteve, të cilat do t'i zvogëlojnë komplet shqetësimet e deputetëve, ndërsa në të njëjtën kohë të kundërshtohen në frymën e Marrëveshjes së Prespës.

"Apeloj që ta kryeni detyrën dhe detyrimin tuaj që e urdhëron neni 2 i Ligjit për Kuvendin e RM-së që të merrni vendim si përfaqësues të qytetarëve dhe të vendosni sipas bindjes tuaj personale, të drejtës tuaj dhe në të vërtetë - përgjegjësisë suaj, si përfaqësues të qytetarëve të votoni të lirë nga presioni politik", theksoi kryeministri. Rruga e vetme, shtoi Zaevi, është BE-ja dhe NATO-ja.

Paraprakisht, Ilija Dimovski nga VMRO para votimit për rendin e ditës kërkoi që pika të hiqet nga rendi i ditës, sepse siç tha ai, kjo çështje nuk ka as kredibilitet zgjedhor, as referendumial. Për propozimin e Dimovskit votuan 39 deputetë, ndërsa kundër ishin 67. Në fjalimin e tij, deputeti i VMRO-së tha se Qeveria me Marrëveshjen e Nimicit ka dalë nga mandati i saj për emrin dhe nga Rezoluta nga viti 2008. "Kuvendi tani duhet të konstatojë se propozimi është i papranueshëm dhe të kthehemi në dokumentet e vitit 2008, të cilat janë të fundit relevante nga aspekti juridik", tha Dimovski, i cili potencoi se ky nuk është shtegu i vërtetë nëpër të cikën është nisur Qeveria.

Ndryshe, debati në Kuvend do të zgjasë dhjetë ditë dhe tek të mërkurën e javës tjetër mund të presim që ndryshimet kushtetuese të procedohen nëpër votim. Kur jemi tek amnistia, RDK në pushtet dhe Aleanca për Shqiptarët në opozitë janë shprehur kundër asaj që sulmuesve dhe organizatorëve të 27 prillit të lihen të lirë.

MARRËVESHJA E PRESPËS DO TË RATIFIKOHET NË PARLAMENTIN GREK

Marrëveshja e Prespës është marrëveshje e rëndësishme dhe e favorshme për Greqinë dhe për rajonin dhe do të marrë shumicë të deputetëve në Parlamentin grek, tha ministri grek i Detarisë, Fotis Kuvelis në intervistën për programin e parë të radios shtetërore greke. "Vlerësimi im është, por do të thoja edhe bindje se Marrëveshja e Prespës, është një marrëveshje veçanërisht e rëndësishme dhe volitshme për Greqinë dhe për rajonin më të gjerë dhe do të kalojë. Vlerësimi im është se numri i deputetëve në Parlamentin grek të cilët do të votojnë për Marrëveshjen e Prespës, gjithsesi nëse gjithçka përfundojnë, siç është paraparë në vetë marrëveshjen, vlerësimet e IRJM-së, shumica do të sigurohet edhe nga deputetët të cilët i takojnë SYRIZA-s", tha Kuvelis. Siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina, ministri grek ka thejsuar se pozicionet e Panos Kamenosit, për planin B është qëndrim personal i partnerit të koalicionit në Qeveri. "Është e qartë se zoti Kamenos, Grekët e Pavarur, marrin pjesë në Qeveri, bashkëpunojnë dhe do të bashkëpunojnë edhe krahas asaj që në ditët e fundit ishte shprehur nga ana e Kamenosit, kjo nuk është zgjedhje politike qendrore e Qeverisë në çështjet në politikën e jashtme. Ky është mendim personal i zotit Kamenos", sqaroi ministri i Detarisë së Greqisë.

110 VJETORI, SI NJË GJYSMË FESTE DHE GJYSMË ÇMIMI

SHKUPI DËSHTON NË VITIN E GJERGJIT

Maqedonia, të cilës nga Këshilli mbarëshqiptar iu caktua detyra për të marrë përsipër shënimin e Kongresit të Manastirit, do të dështojë në zhvillimin e aktiviteteve qendrore. Përveç shqetësimit të Muzeut të Alfabetit lidhur me qytetin se ku do të zhvillohet manifestimi qendror, në Shkup apo Manastir, edhe përfaqësues të Maqedonisë në Këshillin mbarëshqiptar janë të alarmuar nga neglizhenca institucionale për hartimin e programit qendror

Koha — Evis HALILI

Shkup, 15 tetor - Jubileu i 110-të i Kongresit të Manastirit nuk do të shënohet me të gjitha nishanet dhe nderimet e pritshme shtetërore. Sekretariati për Implementim e Marrëveshjes së Ohrit edhe pse ka në dispozicion një buxhet për këtë ditë, akoma nuk ka hartuar Programin e manifestimeve, e për rrjedhojë - as mund të aktivizojë këtë fond. Kjo ka bërë që Maqedonia, së cilës nga Këshilli mbarëshqiptar iu caktua detyra për të marrë përsipër shënimin e Kongresit të Manastirit, të dështojë në zhvillimin e aktiviteteve qendrore. Përveç shqetësimit të Muzeut të Alfabetit lidhur me qytetin se ku do të zhvillohet manifestimi qendror, në Shkup apo Manastir, edhe përfaqësues të Maqedonisë në Këshillin mbarëshqiptar janë të alarmuar nga neglizhenca institucionale. Në këtë vit jubilar po ashtu jo vetëm që nuk do të arrijë të jepet as çmimi shtetëror "22 Nëntori", i cili u miratua nga Parlamenti në muajin maj të këtij viti, por as Komisioni për dhënien e çmimit akoma nuk formuar zyrtarisht. Edhe pse janë bërë publike emrat e anëtarëve të tij, ata ende nuk kanë marrë vendimet për emërimet në këtë komision.

Për drejtorin e ITSHKSH-së, Skënder Asani, koha ka mbaruar, ashtu si edhe shansi për shënimin dinjitoz të kësaj date historike.

"Nëse 550 vjetori i vdekjes së heroit kombëtar - Skënderbeut zhvillohej në Tiranë, përvjetori i Lidhjes së Prizrenit në Kosovë, 110 vjetori na u përcaktua neve që të merreshim me organizimin dhe bashkëpunimin me Tiranën dhe Prishtinën. Jo se 110 vjetori nuk do të festohet me aktivitete dhe në formën që e bëjmë çdo vit, por ajo që pritej - shënimi në nivelet më të larta shtetërore, nuk do të ndodhë dhe ne do të zhvillojmë aktivitetet tona si ITSHKSH. Edhe koha për të bërë diçka ka mbaruar, na ndajnë shumë pak ditë që nuk janë të mjaftueshme për të realizuar atë që pritej nga ne. Sekretariati nuk ka gati as Programin, nuk ka përcaktuar as buxhetin dhe nuk e dimë se çfarë do të financohet. As nga Ministria e Kulturës po ashtu nuk ka asgjë të përcaktuar, përveç manifestimeve më të vogla", thotë Skënder Asani, përfaqësues në Këshillin Mbarëshqiptar për shënimin e Vitit të Gjergjit. Në informacionet zyrtare, SIMO ka në dispozicion një shumë prej 5 milionë denarë për të shënuar jubileun e 110 vjetorit të Kongresit të Manastirit, por prej disa javësh nga ky institucion nuk japin asnjë lloj

SKENDER ASANI

Koha për të bërë diçka ka mbaruar, na ndajnë shumë pak ditë që nuk janë të mjaftueshme për të realizuar atë që pritej nga ne. Sekretariati nuk ka gati as Programin, nuk ka përcaktuar as buxhetin dhe nuk e dimë se çfarë do të financohet. As nga Ministria e Kulturës po ashtu nuk ka asgjë të përcaktuar, përveç manifestimeve më të vogla

komenti as lidhur me manifestimet, por as me qytetin që do të jetë kryeqendra e shënimeve.

Shumë ngjarje që u paralajmëruan këtë vit si më të rëndësishmet për shënimin e jubileut akoma nuk kanë filluar të realizohen. Një prej tyre është opera "Skënderbeu", e cila duhej të ngjitej në skenë nga Opera dhe Baleti i Maqedonisë.

Në ndërkohë Tirana, Prishtina dhe Shkupi janë angazhuar në shënimin e disa prej datave të Vitit të Gjergjit, ndërsa institucionet e shkencës dhe artit kanë shfrytëzuar mundësinë për të lidhur marrëveshje dhe nënshkruar memorandume bashkëpunimi pas zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta.

Paditet ish-kryetari i Berovës

Shkup, 15 tetor - Zyra e jashtme për punë kriminalistike në Berovë, deri te Prokuroria Themelore Publike Berovë, ngriti padi penale kundër D.N.(60), ish-kryetar i Komunës së Berovës për shkak të ekzistimit të dyshimit për veprën e kryer penale "keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar", që dënohet sipas nenit 353 paragrafi 4 në lidhje me paragrafin 1 nga Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë. Siç kumtoi MPB-ja, i denoncuari, si kryetar i komunës së Berovës, në tre raste e ka keqpërdorur pozitën dhe autorizimin zyrtar. Më 18.11.2015 nëpunëses së administratës V.P. nga fshati Budinarci në mënyrë joligjore i ka dhënë vërtetim për dhënien e autorizimit edhe pse nuk i përmbushte kushtet ligjore të cilat ishin të nevojshme për atë vend pune. Në periudhën prej 01.01.2016 deri më 31.10.2016 i ishte llogaritur pagë si udhëheqëse e repartit edhe pse ka pasur vendim për sistemim në vendin e punës referente i pavarur. Me këtë veprim i denoncuari e ka dëmtuar buxhetin e komunës së Berovës në vlerë prej 199.488 denarë. Më 26.07.2017 ka lidhur marrëveshje për punësim me B.Sh. nga Berova për vendin e punës referent për përgatitjen e materialeve për seancat për këshillin, për çka nevojitej arsim i lartë ose i mesëm. Ajo e kishte përmbushur kushtin dhe ishte punësuar me arsim të mesëm. Por, pas lidhjes së marrëveshjes për punësim, me vendim për përcaktimin e vlerës së pagës i ishte vërtetuar vlerë e pagës si nëpunës me arsim të lartë. Me këtë vepër i denoncuari e ka dëmtuar buxhetin e Komunës së Berovës në vlerë prej 25.704 denarë. Më 27.06.2017 i denoncuari ka lidhur marrëveshje për punësim me G.R. nga Berova për vendin e punës zjarrfikës, edhe pse në momentin e shpalljes së konkursit nuk kishte mjete të siguruara për këtë dedikim. Nga 26.07.2017 pagesa e rrogës është realizuar nga llogaria e dedikuar për doniacion nga MPB-ja që është e dedikuar për pagesën e pagave për pjesëtarët e Njësisë Zjarrfikëse Territoriale dhe për të cilën pagesë nuk ka marrë leje nga Ministria e njëjtë përmes Ministrisë së Financave. Në këtë mënyrë i denoncuari e kishte dëmtuar buxhetin e komunës së Berovës në vlerë prej 355.660 denarë.

Ademi takoi përfaqësuesen e UNDP-së

Shkup, 15 tetor - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi dje ka zhvilluar takim me përfaqësuesen e UNDP në Republikën e Maqedonisë, Luiza Vinton.

Në këtë takim, siç thuhet në komunikatën e MASH-it, u theksua bashkëpunimi i deritashëm i Maqedonisë me programet e Kombeve të Bashkuara në sferën e arsimit, për projekte të shumta me interes të përbashkët. "Gjatë takimit u diskutua edhe për realizimin e projektit për asistentë personalë për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore, si dhe për projektin për arsimin dhe trajnimin e personave të dënuar që qëndrojnë në entet ndëshkuese-përmirësuese në vend, projekt ky që para do kohe u përmbyll me ndarjen e certifikatave për zbatimin e suksesshëm të të njëjtit", thuhet në komunikatë.

Ministri Ademi në këtë takim, po ashtu, ka prezantuar edhe reformat që i ndërmerr Ministria e Arsimit në drejtim të përafrimit të sistemit arsimor të Republikës së Maqedonisë drejt trendeve moderne botërore në sferën e arsimit.

PROKURORIA SPECIALE I NGJITET ISH-KRYETARIT TË LUSTRIMIT

EDHE AXHIEVI NË HETUESI

Shkup, 15 tetor - Ish-kryetari i Komisionit për lustrim, Tome Axhiev dje është thirrur në hetuesi në Prokurorinë Speciale Publike për rastin "I forti". Rastin "I forti" PSP e paralajmëroi në mars të këtij viti dhe ka të bëjë me gjithsej 13 persona, mes të cilëve deputeti Antonio Milloshoski, babai i tij dhe kryetari i atëhershëm i Komunës Makedonski Brod, Ismail Jajovski.

Sipas PSP, deputeti e ka shtyrë kryetarin e Komunës që të manipulojë Këshillin e Komunës Makedonski Brod dhe babait të tij t'ia shesë objektin në fshatin Izhistë, në të cilën ka qenë e sistemuar Komuna Pllasnicë. Pasi që kryetari i komunës ka kuptuar se është i manipuluar ka kërkuar që procedura të rihetohet.

Që t'i hakmerret kryetarit Jajovski, deputeti i ka dërguar inspeksione në kompaninë e tij "Pucko petrol", ndërsa gjykatësin që e ka gjykuar rastin e ka lustruar dhe e ka pasur të ndaluar ta kryejë detyrën. Për shitjen e objektit është organizuar ankand publik, të cilën kryetari nuk e ka publikuar në Gazetën zyrtare dhe për të është paraqitur vetëm babai i deputetit, i cili e ka blerë objektin për 670 denarë më shumë nga çmimi fillestar. Pastaj me mashtrim në kadastër ka arritur ta vendosë objektin në emër të tij, ndërsa i është shitur edhe tokë shtetërore me çmim prej 100 denarëve për metër katror edhe pse çmimi i tregut ka arritur 400 denarë. Në këtë mënyrë është bërë me vlerë pronësore antiligjore prej një milion e 795,800 denarë, si dhe një milion e 176.000 denarë për blerje të tokës.

Kur ka kuptuar kryetari i Komunës së Pllasnicë, Ismail Jajovski se është shitur objekti, në të cilin është e vendosur komuna ka kërkuar nga Qeveria që ta hetojë situatën, dhe komisioni ka vërtetuar se janë bërë shumë lëshime gjatë shitjes dhe se komuna ka shitur pronë që është e shtetit.

(O.Xh)

VAZHDON RËNIA E NUMRIT TË PUNONJËSVE

KRIZA POLITIKE PO DËMTON EKONOMINË

Dimitrov alarmoi se industria e tekstilit që punëson 40 për qind të fuqisë punëtore të angazhuar në tërë industrinë e vendit, apo me afër 43 mijë të punësuar, ballafaqohet me mungesën e fuqisë punëtore dhe konkurrencën më të lirë nga Lindja e Largët

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 tetor - Nëse situata politike thellohet dhe ka zgjedhje të parakohshme parlamentare, biznesi do të pësojë, nuk do të realizohen investimet e planifikuara, as do të shkohet në pushtimin e tregjeve të reja, paralajmëruan sot punëtorët e tekstilit. Ato në konferencën për media apeluan që politikanët së pari të mendojnë për shtetin dhe pastaj për partitë. Nëse paqëndrueshmëria rritet dhe shndërrohet në krizë sigurie, paralajmëruan, edhe kjo që sot po punojmë, do të zhduket.

"Në situatë të paqëndrueshme politike, asnjë biznesmen nuk vendos të investojë, t'i zgjerojë kapacitetet e tij dhe nuk mendon për tregje të reja. Kompanitë deri në fund të nëntorit duhet t'i parashtrojnë kërkesa për mjetet që vitin e kaluar i kanë investuar, por nëse ka zgjedhje, tërë energjia do të orientohet drejtë procesit, të gjithë do të merremi me politikë, ndërsa do të pësojë biznesi nga i cili presim të mbushen fondet dhe buxheti, për t'i rritur pagesat sociale. Nëse biznesi pëson rënie, do ketë rënie të të gjithë ekonomisë", ka theksuar kryetari Shoqatës së Industrisë së Tekstilit në Odën Ekonomike, Angel Dimitrov. Ai paralajmëroi se industria e tekstilit pret rënie të mëtejme të numrit të të punësuarve, posaçërisht në industrinë e lëkurës. Interesi te të rinjtë për përfundimin e shkollave profesionale të tekstilit është gjithnjë e më i vogël, tha ai, ndërsa nuk ka interes edhe për punësim në kompanitë e tekstilit.

Megjithatë, se si do të veprojë më tej biznesi, ai thotë se kjo do të varet nga stabilizimi i situatës politike si në aspektin e investimeve të reja, punësimeve, por edhe nënshkrimit të marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me partnerët e rinj tregtar. Dimitrov më tej alarmon se industria e tekstilit që punëson 40 për qind të fuqisë punëtore të angazhuar në tërë industrinë e vendit, apo me afër 43 mijë të punësuar, ballafaqohet me mungesën e fuqisë punëtore dhe konkurrencën më të lirë nga Lindja e Largët. Kompanitë e tekstilit në Maqedoni, megjithatë, ende janë atraktive për tregjet profesionale para se gjithash për shkak të afërsisë, serive të vogla, cilësisë së lartë të prodhimeve dhe çmimet solide. Lidhja e marrëveshjeve dhe mbajtja e partnerëve nga vendet perëndimore-evropiane po vazhdon.

Prodhimtaria e tekstilit të Maqedonisë në tetë muajt e parë të vitit në krahasim me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar shënon rritje prej 11.2 për qind, ndërsa prodhimi i veshjeve ulje prej 6.7 për qind. Eksporti ka arritur 386 milionë dollarë që është rritje për 14.8 për qind, ndërsa paraqet 9.8 për qind nga eksporti i përgjithshëm i Maqedonisë. Importi megjithatë, ka qenë 382.7 milionë dollarë.

MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM ENERGJETIK ME USAID-in

PROJEKTE PËR PËRFORCIMIN E SEKTORIT ENERGJETIK

Shkup 15 tetor - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, dje mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të Memorandumit për bashkëpunim mes Qeverisë së Maqedonisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe USAID-it, si dhe mes Komisionit Rregullator për Energjetikë dhe USAID, në lidhje me "Projektin për mbështetje të reformave në sektorin e energjetikës në Maqedoni". Me këtë rast, Bekteshi theksoi se nënshkrimi i këtyre dy memorandumeve për bashkëpunimi me USAID-in, njërin për zhvillimin e tregjeve rajonale energjetike dhe tjetri për të mbështetur reformat në sektorin energjetik në Maqedoni, dëshmon qasjen serioze që ka kjo qeveri ndaj sektorit energjetik.

"Për Qeverinë, energjetika është një nga fushat prioritare strategjike, prandaj i kemi kushtuar vëmendje të veçantë këtij sektori. Objektivi strategjik i saj është që të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori duke bërë të mundur që ajo të jetë konkurruese në tregun e energjisë me përkujdesje të vazhdueshme për ambientin, duke përfshirë edhe ndryshimet klimatik. Prandaj ne po punojmë në përfshirjen sa më të madhe të energjisë rinovuese dhe nxitjen e masave për efikasitet energjetik dhe kemi bashkëpunimin të vazhdueshëm me USAID-in për të siguruar një mjedis të favorshëm për investitorët dhe nga nënshkrimi i memorandumit presim që ky bashkëpunimi ynë të thellohet për të realizuar qëllimet e përcaktuara", tha Bekteshi. Miratimi i Ligjit për Energjetikë në qershor të 2018, tha Bekteshi, ka hapur shumë mundësi të reja për zhvillime të mëtutjeshme si bashkimin e tregjeve energjetike me Bullgarinë, zbatimin e procedurave për ndarjen e operatorëve transmetues për qasje jo diskriminuese në infrastrukturën e energjisë elektrike dhe të gazit, siguri në furnizim dhe diversifikimin e burimeve të energjisë, realizimin e masave për të mbështetur dhe nxitur prodhimin e energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme të energjisë, mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë dhe shumë përfitime të tjera.

Në ndërkohë, ambasadori i SHBA-ve në Maqedoni, Xhes Bejli, nënshkrimin e këtyre memorandumeve e cilësoi si akt të rëndësishëm i cili do t'i ndihmojë qeverisë së RM-së të jetë më afër përmbushjes së rregullativës ligjore të BE-së i cili rregullon tregjet energjetike. Republika e Maqedonisë, si anëtare e Komunitetit Energjetik, është e obliguar të bëhet pjesë e Tregut të Brendshëm të Energjisë në BE. Me ndihmën teknike të USAID-it, u hartua Ligji i ri për Energjetik, që është në harmonizim të plotë me të ashtuquajturin Pako e Tretë e Direktivave që rregullojnë tregjet energjetike të BE-së. *(Z.V)*

Të respektohen të drejtat autoriale

Shkup, 15 tetor - Njohje më të mirë të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë me të drejtat autoriale dhe mënyra si të mbrohen ata të drejta para institucioneve është qëllimi i publikimit të cilin dje e prezantoi Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë të hartuar nga autorët Ivan Breshkovski dhe Igor Markovski.

"Në fushën mediatike në Republikën e Maqedonisë ka shkelje masive të të drejtave autoriale të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë me të a.q. gazetari "kopi pejst" që drejtpërdrejt ndikon në statusin e keq social të gazetarëve.Për tejkalimin e kësaj gjendje nevojitet që gazetarët të edukohen për mënyrën si t'i mbrojnë të drejtat autoriale dhe të ngitet vetëdija te institucionet shtetërore për rëndësinë që të respektohen ata të drejta dhe se kjo drejtpërdrejt ndikon mbi cilësinë e gazetarisë dhe mbi lirinë e mediave", thotë kryetari i SHGM-së Naser Selmani.

Avokati Ivan Breshkovski, i cili së bashke me kolegun Igor Markovski është autor i analizës thekson se krahas përshkrimit të rregullativës vendore dhe të huaj në këtë fushë ajo ofron edhe prezantim të praktikave të organizatave gazetareske ndërkombëtare, të KE-së dhe të direktivave të BE-së të cilat duhet të implementohen në legjislacionin tonë. Janë theksuar edhe rekomandime për tejkalimin e problemeve në fushën e të drejtave autoriale përmes ndryshimeve në ligjin për të drejta autoriale me dhënien e analizës komparative me ligjin kroat, i cili është harmonizuar me praktikën evropiane me theks në mbrojtjen e të drejtave autoriale gjatë marrëdhënies së punës dhe menaxhimin kolektiv me të drejtat autoriale dhje të ngjashme.

"Avancimi i mbrojtjes së të drejtave autoriale është me rëndësi kur bëhet fjalë për respektimin e prodhimeve gazetareske përmes garantimit të pronësisë të teksteve gazetareske, fotografive dhe përmbajtjeve audio-vizuale dhe garantim të të drejtave të materialeve gjegjësisht interesat pronësore të autorit (gazetarit)", thotë Breshkovski.

I pyetur si deri te zbatimi i mbrojtjes së të drejtave autoriale të gazetarëve Selmani dhe Breshkovski janë unanim se kjo duhet të bëhet në Gjykatë përmes ngritjes së procedurave, për çfarë ekziston praktikë e vogël por pozitive edhe në vend. Publikimi "Ndikimi i ligjit për të drejtat autoriale dhe të drejtat e ngjashme punën e gazetarëve fotoreporterë dhe punonjësit mediatikë", financiarisht është mbështetur nga Fondacioni "Konrad Adenauer".

DEBAT PËR EMIGRANTËT NGA LINDJA E MESME DHE AFRIKA

PËR REFUGJATËT, NË NJË VIJË ME EVROPËN

"Fakti se kriza me emigrantët nuk është përmbyllur, më së miri flasin të dhënat se vetëm gjatë këtij viti, duke tentuar për të hyrë në Bashkimin Evropian, në rajonin e Mesdheut kanë ndërruar jetë 1500 emigrantë, me çka 17 mijë të tjerë mezi mbijetojnë në kampet greke", tha profesor Blerim Reka

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 15 tetor - Vendet e Ballkanit duhet ti harmonizojnë politika e tyre sa i përket çështjes së emigrantëve që vijnë nga Lindja e Mesme dhe Afrika. Sekretarja shtetërore e MPB-së, Magdalena Nestrovoska, duke folur në temën "Zhvillimin me imigrantët dhe sfidat e sigurisë", të hënën theksoi se Maqedonia në vitin 2015, përveç që u përballë me një krizë të brendshme politike, megjithatë institucionet e saj me sukses arritën ta menaxhojnë valën e madhe të emigrantëve nga Lindja e Mesme. Gjatë elaborimit të temës së migracionit, ajo tha se Maqedonia dhe rajoni duhet të jenë të gatshëm për çdo valë të re të emigrantëve, pasi sipas saj, arsyetimi se rajoni nuk i është i përgatitur për një sfidë të tillë, nuk do të jetë i qëndrueshëm. Fjalim lidhur me emigrantët dhe hyrjet e tyre ilegale në vendin tonë pati edhe profesori universitar, Blerim Reka, i cili tha se Maqedonia dy vite më parë, me sukses e menaxhoi valën e emigrantëve që erdhi nga Lindja e Mesme, sfidë kjo që vendet e rajonit i shndërroi në korridor transiti.

"Por si duket, sfidat me emigrantët nuk janë përmbyllur përfundimisht. Për momentin, nëpër Maqedoni nuk kalojnë grupe masive të emigrantëve, megjithatë shumë indikator flasin për emigracionin ilegal, respektivisht për trafikimin e imigrantëve dhe tregtinë me njerëz. Buletini policor raporton për trafikime individuale të imigrantëve, ku si trafikues paraqiten shtetas të Maqedonisë, të cilët veprojnë individualisht apo si pjesë e grupeve kriminele vendase ose atyre ndërkombëtare. Përveç territorit të Greqisë, periudhën e fundit imigrantët e shfrytëzojnë kanalin spanjoll për tu futur në Evropë, gjegjësisht emigrantët kanë marrë këtë hap pasi Qeveria e re italiane po i zbaton politikat anti-emigrante. Fakti se kriza me emigrantët nuk është përmbyllur, më së miri flasin të dhënat se vetëm gjatë këtij viti, duke tentuar për të hyrë në Bashkimin Evropian, në rajonin e Mesdheut kanë ndërruar jetë 1500 emigrantë, me çka 17 mijë të tjerë mezi mbijetojnë në kampet greke", tha profesori Reka. Pikë e nxehtë e valës së re të emigrantëve me të cilën mund të ballafaqohet Evropa dhe Maqedonia, siç thotë Reka, vazhdon të mbetet Siria.

Gjatë debatit për migracionin dhe sfidat e sigurisë, u potencua se në vendet e BE-së ka rritje të qytetarëve jo evropian, të cilët në janar të këtij viti arritën në 5 për qind të popullatës së përgjithshme të vendeve të Evropës. Paralelisht me shtimin e kësaj kategorie të qytetarëve, profesori Reka theksoi se rritet edhe përqindja e atyre qytetarëve që nuk i duan emigrantët, me çka ndikuan në ndryshimin e disa ligjeve nga qeveritë e BE-së, siç është rasti i partive që në pushtet erdhën falë platformave kundër emigrantëve, duke filluar nga Hungaria, Çekia, Austria, Sllovakia, Italia dhe Sllovenia. "Për shtetin e Maqedonisë migrimi ilegal dhe i pakontrolluar paraqet rrezik serioz për sigurinë, në veçanti për kufijtë e saj, nga vetë fakti se Korridori Ballkanik i emigrantëve kalon përmes vendit tonë. Ndonëse Maqedonia nuk është destinacion i fundit, por vende transiti, megjithatë një valë e re masive e emigrantëve për vendin tonë do të ishte një sfidë e madhe e sigurisë", tha Reka. Komentin e tij në cilësinë ekspertit e tha edhe profesori Tërpe Stojanovski, sipas të cilit, Serbia e ka shfuqizuar tashmë vendimin për lëvizjes pa viza me Iranin dhe kjo, siç u shpreh ai, besoj se është një prej indikacioneve se si duhet BE të flasë me një gjuhë.

"Shteti i Maqedonisë vepron si një faktor stabilizues në drejtim të sfidave me emigrantët. Të gjitha sfidat me të cilat u ballafaquan institucionet tona, posaçërisht Ministria e Punëve të Brendshme, mendoj se në vazhdimësi janë trajtuar mirë. Ndryshe, politika evropiane në masë të madhe lidhet me sigurimin e kufijve të jashtëm të saj, por zhvillimet që ndodhën me emigrantët në vendin tonë, vijnë nga një shtet anëtar i BE-së. Mendoj se politika që bëhet për integrimin e vendit është në rregull. Për shkak se nëse e shohim pozitën momentale gjeografike të BE-së, është e patjetërsueshme të kërkohet një bashkim rreth sfidave me të cilat përballet Evropa. Kështu që BE me të drejtë insiston në shqyrtimin e politikave të vizave të vendeve të rajonit. Kohën e fundit ishim dëshmitarë të disa fenomeneve të reja sa i përket çështjes së imigracionit. Për shkak të heqjes së vizave mes Serbisë dhe Iranit, kishim rastin të shohim se si emigrantët nga Irani filluan të lëvizin nga veriu përmes jugut (drejtë Greqisë), që deri pak kohë ishte e kundërta. Informacionet e fundit flasin se tashmë Serbia e ka shfuqizuar vendimin për lëvizje pa viza me Iranin dhe kjo besoj se është një prej indikacioneve se si duhet BE-ja të flasë me një gjuhë", tha Stojanovski.

Panel diskutimi për emigracionin dhe sfidat e sigurisë u realizua në pajtim me Kapitullin 24 të Konventës nacionale të BE-së për Maqedoninë, respektivisht në kuadër të skrining-procesit për këtë kapitull.

Hetohet vrasja në Reçicë, motivi ende i panjohur

Tetovë, 15 tetor - Prokuroria Publike e Maqedonisë njoftoi se prokurori publik kujdestar nga Prokuroria Publike Themelore Tetovë ka kryer hetim në Reçicë të Vogël të Tetovës, në vendin ku sipas informacioneve paraprake tetovari 53-vjeçar e ka privuar nga jeta gruan e tij. Sipas PPRM, motivi për ngjarjen e cila ka ndodhur në shtëpinë e prindërve të së ndjerës ende është nën hetim. Duke e lëshuar shtëpinë, i dyshuari ka shtënë edhe në drejtim të një automjeti taksi që ka qenë në afërsi. Drejtuesi i taksisë nuk është plagosur, por janë gjetur projektile në automjet. Pas ngjarjes i dyshuar është arratisur dhe është në kërkim. Prokurori publik kompetent dha urdhër që të kryhet obduksion i të ndjerës, si dhe urdhra për mbledhjen dhe shqyrtimin e provave të ekspertëve dhe dëshmive materiale të gjetura në vendngjarje. *(U.H)*

Shkup, një i vdekur dhe tre të lënduar rëndë në 29 aksidente

Shkup, 15 tetor - Një drejtuesi i motoçikletës e ka humbur jetën, tre persona kanë marrë lëndime të rënda, ndërsa 14 lëndime më të lehta në gjithsej 29 aksidente rrugore që kanë ndodhur gjatë fundjavës së kaluar në rajonin e Qytetit të Shkupit. Në 12 prej aksidenteve rrugore janë regjistruar vetëm dëme materiale. Sipas raportit policor të SPB Shkup, 253 shoferë e kanë drejtuar automjetin me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, 112 shoferë janë përjashtuar nga komunikacioni, prej të cilëve 50 për shkak drejtimit të automjetit nën ndikim të alkoolit, 52 pa marrë patentë shoferi dhe 10 shoferë fillestarë. Nga policia e trafikut janë përjashtuar 57 automjete prej këtyre një ka pasur probleme teknike, ndërsa 56 kanë qenë të paregjistruara. Në mënyrë të parregullt janë parkuar 156 automjete, ndërsa karrotreci i ka larguar 104 automjete.

KRONIKË

Plaçkitet bastorja në qendër të Gostivarit

Të dielën rreth orës 09:00, një person i panjohur ka kryer plaçkitje në bastoren sportive "Marshall Tito", në qendër të Gostivarit. Nga Policia njoftuan se hajni ka patur pistoletë në dorë. Sipas policisë, personi tanimë i panjohur i është kërcënuar të punësuarit dhe i ka kërkuar që ti jap paratë nga arka. Punëtori i frikësuar për jetën e tij, i ka dhënë rreth 150 mijë denarë, të cilët plaçkitësi i ka vënë në çantë dhe ka ikur. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe punohet në zbardhjen e plotë.

Rrihen të rinjtë në Tetovë

20 vjeçari S.P nga fshati Falisht dhe një 17 vjeçar nga i njëjti fshat, të dielën rreth orës 2:20 minuta kanë denoncuar dhunë që ndaj tyre e kanë kryer katër persona nga Tetova, pjesa dërmuese të mitur. Derisa të denoncuarit kanë qëndruar në objekt hotelerik në rrugën "Boris Kidriç" në Tetovë, fizikisht janë sulmuar nga katër persona, kryesisht të mitur. Derisa dy të rinjtë kanë qëndruar në objektin hotelerik në rrugën e sipërpërmendur, ata janë sulmuar nga katër të miturit me shishe dhe grushte, ndërsa kanë ndërhyrë të tjerë të cilët i kanë ndarë. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

61-vjeçarja kafshohet nga qentë endacak

61-vjeçarja me iniciale S.B nga Tetova, të dielën mbrëma rreth orës 20 ka denoncuar se është sulmuar nga qen endacak. Sipas denoncimit, ajo ka qenë duke hedhur mbeturina në rrugën "Jane Sandanski" në Tetovë. Qentë kanë qenë tek kontejneri dhe e ka kafshuar në dorën e djathtë, ndërsa 61-vjeçarja ka kërkuar ndihmë mjekësore.

Padi kundër dy personave për dhunë

Prokuroria themelore publike Shkup solli urdhër për zbatim të procedurës hetimore kundër dy personave për shkak të dyshimit të bazuar për vepër të kryer penale "dhunë". Personat janë të dyshuar se më 7 tetor kanë kryer dhunë brutale në një objekt hotelierik në lagjen Draçevë. e ç'rast kanë lënduar dy persona dhe me atë në publik kanë shkaktuar ndjenjë të pasigurisë, rrezikimit dhe frikës. Në natën kritike, dy të dyshuarit kanë ardhur si mysafirë në atë lokal. fillimisht kanë filluar debat verbal me të dëmtuarin, i cili më pas është shndërruar në rrahje. Njëri nga të dyshuarit, me mjet të mbrehtë u ka shkaktuar lëndime të rënda trupore në lloj të plagëve therrëse dy të dëmtuarve. Gjatë hetimit do të merren në pyetje të dyshuarit, të dëmtuarit, si dhe disa dëshmitarë. Gjithashtu, gjatë hetimit do të sigurohet edhe ekspertizë mjeko-ligjore për llojin dhe karakterin e lëndimeve tek të dëmtuarit. Në bazë të atyre dëshmive të siguruara, prokurori kompetent publik do të vendosë për rrjedhën e mëtutjeshme të procedurës, në kuptim të gjendjes së konstatuar faktike në mënyrë të rregullt dhe zbatim i rregullt o Kodit penal. *(U.H)*

MAQEDONIA HEDHË 12.000 TONË USHQIM NË VIT

PAK NA KUJTOHET T'IA SHTRIJMË DORËN TJETRIT

"Vetëdija e ushqimit është më e lartë tek brezat më të moshuar, pasi kanë jetuar në kohën kur ushqimi ka qenë luks dhe ka pasur vlerë. Sot, pjesa më e madhe e qytetarëve kanë ushqim me bollëk, por më pak na kujtohet tjetrit t'ia shtrijmë dorën. Na intereson vetëm kënaqësia individuale", ka thënë Bllazhe Josifovski nga "Hajde Maqedoni"

Koha Qefser ABDYLI

Shkup, 15 tetor - Maqedonia është ranguar në vendin e tetë në korniza botërore sipas sasisë së ushqimit të hedhur sipas numrit të banorëve. Rreth 30 për qind e ushqimit të prodhuar apo importuar në Maqedoni asnjëherë nuk konsumohet. Vlerësimet se hedhim 12.000 tonë ushqim me të cilat mund të sigurohen nga tre shujta në ditë për 26.000 qytetarë, ndërkaq tepricat e përgjithshme tejkalojnë 100.000 tonë. Sipas lëvizjes "Eja Maqedoni", vetëm në Prespë këtë vit janë hedhur dhjetëra mijë tonë ushqim.

"Vetëdija tek kompanitë dhe organizatat joqeveritare është ngritur, gjithnjë e më shumë regjistrohen, ndërsa qytetarët paraqiten si vullnetarë. Por, ajo që shqetëson është vetëdija tek të rinjtë. Për fat të keq, ata rritën në 'konsumizëm klasik', të cilët duan diçka të shpejtë të shijojnë dhe të hedhin. Vetëdija e ushqimit është më e lartë tek brezat më të moshuar, pasi kanë jetuar në kohën kur ushqimi ka qenë luks dhe ka pasur vlerë. Sot, pjesa më e madhe e qytetarëve kanë ushqim me bollëk, por më pak na kujtohet tjetrit t'ia shtrijmë dorën. Na intereson vetëm kënaqësia individuale", ka thënë Bllazhe Josifovski nga "Hajde Maqedoni". Gjatë kremtimit apo ngjarjeve që mbahen në objekte hotelierike, mbi 50 për qind e ushqimit mbetet dhe pastaj hidhet.

"Ekspertët e huaj që për këtë kanë hulumtuar, na kanë informuar se kjo është për shkak të kulturës, e cila imponon 'shtrëngim' në pjesën më të madhe të kohës dhe gjatë kremtimit duhet të tregohet se ekziston. Në shtetet më të zhvilluara, ku ushqimi është larg luksit, një kohë të gjatë përmes ushqimit nuk tregohet nëse dikush ka apo s'ka", ka shtuar Josifovski. Në dyqane, praktikë kryesore për momentin është që gjatë skadimit të afatit të ngjitet edhe një produkt i njëjtë me afat më të gjatë. Në rast të këtillë më shpesh paraqitet problem, pasi "gënjehet" blerësi, që blen diçka që nuk mund ta përdor për periudhën e shkurtë dhe pjesa më e madhe e atij ushqimi me afat të shkurt nga dyqanet në tërësi amvisëritë e hedhin, në vend se përdoruesit apo dyqanet.

"Ajo që përmes sistemit për donimin e ushqimit tepricë 'Të gjithë të ngopur' kanë kaluar dhjetëra mijëra pjata ushqim të shkëlqyeshëm, shumë flet për krijimin e shpejtë të vetëdijes dhe përgjegjësisë që të mos e hedhim ushqimin. I ftojmë biznesmenët që të na bashkëngjiten në luftën kundër urisë dhe të mos e hedhim ushqimin, por ta donojmë", shton Josifovski. Kryetari i Këshillit kombëtar të "Slou fud Maqedoni", Nikollçe Nikolovski, tregon për paradoksin se mbi 25 për qind e ushqimit tonë shkon në mbeturina, ndërsa 20 për qind e popullatës nuk mund të sigurojë një racion në ditë.

MBI 815 MILIONË NJERËZ VUAJNË NGA KEQUSHQYERJA

Sipas raportit më të ri të Organizatës për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) e Kombeve të Bashkuara, pas periudhës rënëse, uria në botë përsëri është në rritje. Sot, mbi 815 milionë njerëz vuajnë nga kequshqyerja kronike apo një në nëntë njerëz. Pastaj, 60 për qind prej tyre janë gra. Konflikti, ngjarjet ekstreme të motit lidhur me ndryshimet klimatike dhe progresi i ngadalshëm ekonomik e vështirësojnë luftën kundër urisë. Siç thotë edhe drejtori i përgjithshëm i FAO-s, Hoze Graciano de Silva, në intervistën me rastin e Ditës Botërore të ushqimit gjatë vitit të kaluar 1.5 miliardë njerëz kanë vuajtur nga mungesa e mikronutrientëve që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e tyre, ndërsa 2.6 miliardë kanë qenë me mbipeshë, që paraqet 30 për qind të popullatës botërore. Qyteti sipas Da Silva, është kryesisht i kufizuar me rajone të përfshira prej konflikteve, të thatit dhe varfërisë ekstreme. Uria po mbyt më shumë njerëz në nivel vjetor se sa malaria, tuberkulozi dhe sida së bashku. Rreth 45 për qind e rasteve të vdekjes te foshnjat ndërlidhen me mosushqyerjen. Uria edhe më tej është përditshmëri për 155 milionë fëmijë të moshës nën pesëvjeçare, që e rrit rrezikun nga sëmundjet dhe zhvillimi i ngadalësuar mental.

Përveç të moshuarve dhe fëmijëve të vegjël, sipas rekomandimeve, në këtë grup të qytetarëve të cilët kanë nevojë për të mbrojtur veten nga gripi sezonal duhet të përfshihen të gjithë të punësuarit në shëndetësi, polici, punonjësit administrativ, punonjësit e arsimit...

NIS SEZONI I GRIPIT

VAKSINAT FALAS KUNDËR GRIPIT NGA FUNDI I MUAJIT

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 15 tetor - Ndryshe nga vitet e kaluara, këtë vit vaksinimi kundër gripit do të fillojë dhjetë ditët e fundit të tetorit. Kështu kanë informuar nga Instituti i Shëndetit Publik, ndërsa kanë njoftuar se tashmë janë siguruar 28 mijë doza që do të jepen falas për personat mbi 65-vjeç. Do të përfshihen edhe 20 mijë të tjera e që do të kushtojnë më shumë se 400 denarë, pasi siç sqarojnë kompetentët, është lloj i ri i vaksinave me cilësi më të lartë se sa ato që janë dhënën vitet e kaluara, konkretisht bëhet fjalë për vaksinë që mbron nga katër lloje familje të virozëve të gripit.

"Furnizimi publik përfshin 28.000 doza falas, sipas propozimit të Komisionit për sëmundjet infektive për një vaksinë me katër nivele të influencës, e cila është sipas rekomandimeve të OBSH-së dhe Agjencisë Evropiane të Mjekësisë. Ajo është projektuar për imunizimin e personave mbi 65 vjet, me një pension mesatar dhe pa të ardhura nën mesatare", thonë nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa shtojnë se janë siguruar tashmë 13 milionë denarë. Shumica e vaksinave, siç thonë në MSH, do të shpërndahen në rajonin e Shkupit.

"Më shumë se 10 mijë vaksina të gripit do të jenë në dispozicion në qytetin e Shkupit për herë të parë këtë vit. Sa i përket vaksinave për 65 vjeçarët që kanë pension mesatar, nën-mesatar dhe ata që nuk kanë të njëjtin, ato janë falas dhe duhet të sigurohen nga Ministria e Shëndetësisë", thonë nga Instituti i Shëndetit Publik. Megjithatë, epidemiologët janë skeptik nëse do të shpenzohen të gjitha vaksinat, por thonë se në bazë të rekomandimeve të OBSH-së, vetëm në Shkup duhet të vaksinon rreth 120.000 qytetarë. Sipas rekomandimeve, në këtë grup të qytetarëve të cilët kanë nevojë për të mbrojtur veten nga gripi sezonal duhet të përfshihen të gjithë të punësuarit në shëndetësi, polici, punonjësit administrativ, punonjësit e arsimit... Edhe pse mjekët thonë se vaksinimi kundër gripit nuk paraqet garancë 100 për qind mbrojtje, megjithatë të prekurit nga gripi do ta kalojnë atë në një formë më të butë dhe me një rrezik dukshëm më të ulët nga ndërlikimet e mundshme. "Ka shtatë vite dhe më shumë që jepen vaksina kundër virozave në periudhën kryesisht të gripit, ku padyshim preken më shumë grupmoshat e vjetra. Ne si mjek nuk u rekomandojmë të gjithëve, pasi ai lloj imunizimi nuk do të thotë që shmanget familja e madhe e viruseve. Ato vaksina janë të paraparë për një grup familjesh të viruseve. Nuk u rekomandohet të gjithëve dhe nuk është obligative të gjithë ta marrin këtë lloj të vaksinave", thotë doktor E. Rexhepi.

Ndryshe, të dhënat zyrtare tregojnë se viteve të kaluara, në sezonin para fillimit të përhapjes së gripit, janë përdorur më shumë se 30.000 vaksina, po aq janë dhënë falas për kategoritë e përfshira në listën e vaksinimit falas. Vaksinat kundër gripit, sipas rekomandimeve, u jepen personave mbi 65-vjeç, si dhe fëmijëve nën moshën 2-vjeç.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 Të Ligjit për marrëdhënie pune të Republikës së Maqedonisë – teksti final (Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr . 52/2005, 106/2008, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/2018), Ligji për ndërmarrjet publike (Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr . 38/1996, 6/2002, 40/2003, 49/2006, 22/2007, 83/2009,97/10, 6/12, 119/13 и 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16) dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik neni 20 (Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/2014, 27/2016, 35/2018, 64/18)

NP KOMUNALJA MANASTIR
Shpall
SHPALLJE PUBLIKE nr .03/2018

Për pranimin e :

1. **1 (një) realizuesi** në vendin e punës **„Punonjës i përgjithshëm "** me shifrën në vendin e punës KDR 03 05 B 02 031, grupi i dhënies së shërbimeve publike me kohë të pacaktuar pune, Sektori Gjelbërimi publik, Njësia e hortikulturës, njësia për mirëmbajtjen dhe rregullimin e sipërfaqeve të gjelbra:
   - Niveli i kualifikimeve I ose arsimi fillor ;
   - Me ose pa përvojë pune
2. **1 (një) realizuesi** në vendin e punës **„Drejtues automjeti komunal special "** me shifrën në vendin e punës KDR 03 05 B02 068, grupi i dhënies së shërbimeve publike me kohë të pacaktuar pune, Sektori Gjelbërimi publik, Njësia për mirëmbajtjen e higjienës publike/njësia e drejtuesve të automjeteve komunalë :
   - Niveli i kualifikimeve të paktën të arrijë deri në IV, 240 kreditë sipas ECVET ose MKCCO ose katër vjet arsim i mesëm ;
   - 2 (dy) vite përvojë pune në sektorin publik ose privat;
   - Kusht i veçantë leje qarkullimi kategoria „C"
3. **1 (një) realizuesi** në vendin e punës **„Fshesar "** me shifrën në vendin e punës KDR 03 05 B02 020, grupi i dhënies së shërbimeve publike me kohë të pacaktuar pune, Sektori Gjelbërimi publik, Njësia për mirëmbajtjen e higjienës publike/njësia fshesar:
   - Niveli i kualifikimeve I ose arsimi fillor;
4. Me ose pa përvojë pune
5. **1 (një) realizuesi** në vendin e punës **„Roje – zjarrfikës me licencë "**, shifra në vendin e punës KDR 04 02 A02 002 me kohë të pacaktuar pune, grupi personeli ndihmës –teknik :
   - Me nivelin më të ulët të kualifikimeve III, 180 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm tre vjeçar ;
   - Me ose pa përvojë pune;
   - Të tjera, kushte të veçanta : Licenca për sigurim
6. **1 (një) realizuesi** në vendin e punës **„Roje"** me shifrën në vendin e punës KDR 04 02 A03 005, me kohë të pacaktuar pune, grupi personeli ndihmës –teknik Sektori Gjelbërimi publik, Njësia për mirëmbajtjen dhe ngritjen e NPGJ:
   - Niveli i kualifikimeve I ose arsimi fillor;

   Me ose pa përvojë pune

Shpallja publikohet për shkak të rritjes së vëllimit të punës në NP KOMUNALJA MANASTIR

Për orarin e punës me numër rendor 1 (një) „ **Punonjës i përgjithshëm** " **orari ditor i punës nga e hëna në të premte zgjat nga ora** 7,00 deri më 15,00. Paga bazë neto arrin **16.307,00 denarë plus shtesa për punën e kaluar sipas** 0,5 % për çdo vit stazh pune.

Për vendin e punës me numër rendor2 (dy) **„ Drejtues automjeti komunal special " orari ditor i punës nga e hëna në të premte zgjat nga ora** 7,00 deri më 15,00. Paga bazë neto arrin **17.831,00 denarë plus shtesa për punën e kaluar sipas** 0,5 % për çdo vit stazh pune.

Për vendin e punës me numër rendor 3 (tre) **„ Fshesar " orari ditor i punës nga e hëna në të premte zgjat nga ora** 7,00 deri më 15,00. Paga bazë neto arrin **15.239,00 denarë plus shtesa për punën e kaluar sipas** 0,5 % për çdo vit stazh pune.

Për vendin e punës me numër rendor4 (katër) **„ Roje – zjarrfikës me licencë " është përcaktuar punë me turne** . Paga bazë neto arrin **16.307,00 denarë plus shtesa për punën e kaluar sipas** 0,5 % për çdo vit stazh pune.

Për vendin e punës me numër rendor5 (pesë) **„ Roje " orari ditor i punës nga e hëna në të premte zgjat nga ora** 7,00 deri më 15,00. Paga bazë neto arrin **16.307,00 denarë plus shtesa për punën e kaluar sipas** 0,5 % për çdo vit stazh pune.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme në vijim:
- Të jetë shtetas i RM
- Të zotërojë mirë gjuhën maqedonase
- Të jetë në moshën e pjekurisë
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- Me vendim të plotfuqishëm gjykate të mos i jetë shqiptuar ndalimi për ushtrimin e profesionit, aktivitetit ose detyrës

Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushte të veçanta si vijon:
- Të ketë kualifikimi profesionale adekuate për vendin e punës
- Të ketë përvojë pune të nevojshme për vendin e punës
- Te këtë kompetenca të posaçme pune për vendin e punës

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet në vijim për plotësimin e kushteve të nevojshme në origjinal ose në duplikat të noterizuar:
- Dëshmi për shtetësinë
- Certifikatë nga regjistri i lindjeve
- Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjykate të mos i jetë shqiptuar ndalimi për ushtrimin e profesionit, aktivitetit ose detyrës
-
- Diplomë për arsimin e kryer adekuat
- Vërtetim për përvojën e punës në rast se kërkohet
- Kërkesë të plotësuar të publikuar në ueb faqen e NP Komunalja Manastir

Procedura për seklektimin e punonjësve dhënës të shërbimeve në ndërmarrjen publike në vendet realizuese me numër rendor 1, numër rendor 2 dhe numër rendor 3 përbëhet nga verifikimi i të dhënave të dorëzuara në formularin e punësimit, me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike, kontrollimin e dëshmive të dorëzuara në formular dhe intervistë..

Procedura për punësimin e personelit teknik në vendet e punës me numër rendor 4 dhe numër rendor 5, do të zbatohet sipas dispozitave të Ligjit për marrëdhëniet e punës.

Shpallja do të zgjasë **15 (pesëmbëdhjetë) ditë**, në vendet realizuese me numër rendor 1, numër rendor 2 dhe numër rendor 3 llogaritet nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin e ditës, në tre gazeta ditore, një prej të cilave që publikohet në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve që flasin gjuhën zyrtare, të ndryshme nga maqedonishtja.

Shpallja do të zgjasë **5 (pesë) ditë pune** , <u>për</u> vendet e punës me numër rendor 4 dhe numër rendor 5 llogaritet nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin e ditës, në tre gazeta ditore, një prej të cilave që publikohet në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve që flasin gjuhën zyrtare, të ndryshme nga maqedonishtja.

Vërejtje: Sipas planit vjetor për punësime në NP Komunalja Manastir për vitin 2018, konform përfaqësimit adekuat realizuesit për të cilët publikohet shpallja janë me përkatësi maqedonase.

Formularët do të jenë në dispozicion në ueb faqen e NP Komunalja Manastir www.komunalecbt.com.mk. Së bashku me formularin kandidatët duhet që të dorëzojnë edhe dëshmitë e nevojshme për të dhënat e paraqitura.

Kandidatët janë të detyruar me përgjegjësi materiale dhe penale të konfirmojnë se të dhënat në formular janë të sakta, ndërsa dëshmitë e dorëzuara besnike me origjinalin.

Kandidatët duhet që formularët me të gjitha dokumentet e nevojshme t'i dorëzojnë me shkrim, në Arkivin e NP Komunalja Manastir, në adresën

NP Komunalja Manastir
Rr . 16-të pn
7000 Manastir

Personalisht ose me postë, me shënimin „Për shpalljen 03/2018."

NP Komunalja Manastir
UD Drejtor
Pande Bogoevski

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 62/2008, 106/2008, 161/2008, 114/2009....27/2016 dhe 120/2018) nenit 37-i të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/1996, 6/2002, 40/2003....39/2016 dhe 64/2018), nenit 21 paragrafi 2 i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016, 35/2018) dhe nenit 9 dhe nenit 10 të Marrëveshjes kolektive të NPK DERVEN Veles, Drejtori i ndërmarrjes

SHPALLJE
Për punësim të ofruesve të shërbimeve dhe personave ndihmës-teknik për kohë të pacaktuar të punës në NPK DERVEN Veles

Neni 1

Drejtori i NPK DERVEN Veles ka sjellë Vendim për punësim të ofruesve të shërbimeve dhe personave ndihmës-teknik për kohë të pacaktuar të punës për vendet e punës në vijim:

1. Punëtor i përgjithshëm në Sektorin Ujësjellës dhe kanalizim/Departamenti fabrika për përpunimin e ujit me shifër KDR 04 01 A03 012 – (1) realizues
   - Arsim fillor
   - Pa përvojë pune

2. Punëtor për ngarkim të bërllokut në Sektorin Higjiena Komunale - Departamenti për mënjanim të mbeturinave me shifër KDR 03 05 V02 002 – (1) realizues
- Arsim fillor
- Pa përvojë pune

3. Punëtor të përgjithshëm në Sektorin Higjiena Komunale - Departamenti për higjienë publike me shifër KDR 03 05 V02 031– (3) realizues
- Arsim fillor
- Pa përvojë pune

4. Punëtor – rojtar për mirëmbajtje të varrezave në Sektorin higjiena komunale/Departamenti i varrezave me shifër KDR 04 02 A03 005 – (2) realizues
- Arsim fillor
- Pa përvojë pune

5. Punëtor i përgjithshëm në Sektorin Parqe dhe gjelbërim/Departamenti për Mirëmbajtje të gjelbërimit dhe trajtim të drujve të degraduar me shifër KDR 03 05 V02 031 – (1) realizues
- Arsim fillor
- Pa përvojë pune

6. Punëtor i përgjithshëm në Sektorin Parqe dhe gjelbërim/Departamenti për ngritjen e sipërfaqeve të parqeve dhe përpunim të elementeve të parqeve me shifër KDR 03 05 V02 031 – (2) realizues
- Arsim fillor
- Pa përvojë pune

Neni 2

Për plotësimin e vendit të punës, kandidati duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme në vijim:
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Krahas përmbushjes së kushteve të përgjithshme për vendin e punës nga paragrafi 1 i këtij neni, kandidati duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:
- të ketë kualifikim profesional të nevojshëm për vendin e punës,
- të ketë përvojë përkatëse të nevojshme për vendin e punës dhe
- të posedojë kompetenca të posaçme përkatëse të nevojshme për vendin e punës.

Neni 3

Shpallja për punësim do të zgjasë 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit të saj në gazetat ditore. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në procedurën e realizuar të intervistës. Kandidatët do të ftohen në intervistë në afat prej 5 (pesë) ditëve pas përfundimit të konkursit publik.

Drejtor
NPK DERVEN Veles
Ekonomist i diplomuar Gjorgji Stojanov

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 62/2008, 106/2008, 161/2008, 114/2009....27/2016 dhe 120/2018) nenit 37-i të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 38/1996, 6/2002, 40/2003....39/2016 dhe 64/2018), nenit 21 paragrafi 3 dhe nenit 22 paragrafi 1 alineja 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016, 35/2018) dhe nenit 3, 4, 9 dhe nenit 10 të Marrëveshjes kolektive të NPK DERVEN Veles, Drejtori i ndërmarrjes

SHPALLJE
Për punësim të ofruesve të shërbimeve dhe personave ndihmës-teknik për kohë të caktuar të punës për gjashtë muaj në NPK DERVEN Veles

Neni 1

Drejtori i NPK DERVEN Veles ka sjellë Vendim për punësim të ofruesve të shërbimeve dhe personave ndihmës-teknik për kohë të caktuar të punës për gjashtë muaj për vendet e punës në vijim:

1. Vozitës në Sektorin Ujësjellës dhe kanalizim/Departamenti për distribuim dhe ujësjellje – Reparti për mirëmbajtje me shifër KDR 04 03 A02 004– (1) realizues
   - Arsim i mesëm
   - Leje e vozitjes të kategorisë B/C
   - 1 (një) vit përvojë pune
2. Punëtor i përgjithshëm në Sektorin Ujësjellës dhe kanalizim/Departamenti për distribuim dhe ujësjellje – Reparti për mirëmbajtje me shifër të vendit të punës KDR 04 01 A03 012- (3) realizues
   - Arsim fillor
   - Pa përvojë pune
3. Punëtor i përgjithshëm në Sektorin Ujësjellës dhe kanalizim/Departamenti për distribuim dhe ujësjellje – Reparti për kanalizim me shifër të vendit të punës KDR 04 01 A03 012– (1) realizues.
   - Arsim fillor
   - Pa përvojë pune
4. Punëtor i përgjithshëm në Sektorin Ujësjellës dhe kanalizim/Departamenti fabrikë për përpinim të ujit me shifër të vendit të punës KDR 04 01 A03 012- (1) realizues.
   - Arsim fillor
   - Pa përvojë pune
5. Instalues të ujësjellësit – montues në Sektorin Ujësjellës dhe kanalizim/Departamenti për distribuim dhe ujësjellje – Reparti për kyçje me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V01 006 – (1) realizues.
   - Arsim fillor
   - KU, KUL Kualifikime
   - 1 (një) vjet përvojë pune
6. Makinist i pompave dhe rezervuarëve në Sektorin Ujësjellës dhe kanalizim/Departamenti për mirëmbajtje të stacioneve të pompave dhe rezervuarëve me shifër të vendit të punës KDR 0401A02014 – (1) realizues.
   - PMP makinerisë, elektroteknikë
   - 1 (një) vjet përvojë pune
7. Punëtor i përgjithshëm në Sektorin higjiena komunale/Departamenti për higjienë publike me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 031 – (1) realizues.
   - Arsim fillor
   - Pa përvojë pune
8. Punëtor për ngarkim të mbeturinave në Sektorin higjiena komunale – Departamenti për mënjanim të mbeturinave me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 002 – (3) realizues
   - Arsim fillor
   - Pa përvojë pune
9. Pastrues i tregjeve në Departamentin Tregjet me shifër të vendit të punës KDR 04 01 A03 008 – (1) realizues
   - Arsim fillor
   - Pa përvojë pune

Neni 2

Për plotësimin e vendit të punës, kandidati duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme në vijim:
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- të jetë i moshës së rritur

Krahas përmbushjes së kushteve të përgjithshme për vendin e punës nga paragrafi 1 i këtij neni, kandidati duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:
- - të ketë kualifikim profesional të nevojshëm për vendin e punës,

Neni 3

Shpallja për punësim do të zgjasë 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit të saj në gazetat ditore.

Drejtor
NPK DERVEN Veles
Ekonomist i diplomuar Gjorgji Stojanov

MBËSHTETJE TURKE PËR SEKTORIN E SHËNDETËSISË NË MAQEDONI

INVESTIM I RI I TIKA-s NË GJINEKOLOGJINË E ÇAIRIT

Ayden në deklaratën e tij për gazetarët, duke tërhequr vëmendjen se si institucion në Maqedoni po zhvillojnë projekte dhe aktivitete në shumë fusha, tha se projektet në fushën e shëndetësisë kanë shumë rëndësi për to

Shkup, 15 tetor - Është bërë hapja e repartit për higjienë dhe para-sterilizim të spitalit të specializuar për obstetrikë dhe gjinekologji "Nënë Tereza" në Çair të Shkupit, i restauruar dhe furnizuar nga Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA). Në hapjen e projektit morën pjesë Koordinatori i TIKA-s në Shkup, Aytekin Ayden, kryetari i Komunës së Çairit ,Visar Ganiu dhe drejtori i Spitalit, Bashkim Ismaili, të cilët gjithashtu vizituan nga afër punimet e bëra. Ayden në deklaratën e tij për gazetarët, duke tërhequr vëmendjen se si institucion në Maqedoni po zhvillojnë projekte dhe aktivitete në shumë fusha, tha se projektet në fushën e shëndetësisë kanë shumë rëndësi për to.

Ai theksoi se janë duke zhvilluar projekte serioze në Maqedoni që kanë për qëllim një jetë të shëndetshme për brezat e rinj dhe zvogëlimin e vdekjeve të foshnjave. "Një ndër më të rëndësishmet e këtyre projekteve është veçanërisht klinika e kujdesit intensiv për të sapolindurit në Spitalin Shtetëror të Maqedonisë. Sot në masë të madhe do të zgjedhim problemin e higjienës dhe sterilizimit të Spitalit në Çair me rinovimin e tërësishme, dhe furnizimin e tij", tha Ayden. Ayden tregoi se ky projekt ka një rëndësi të veçantë për arsye se këtë vit planifikohet që numri i fëmijëve të lindur në këtë spital të arrijë në 4 mijë, ndërsa shprehu shpresën se spitali prej sot e tutje do të shërbejë në një mjedis të shëndetshëm dhe higjienik.

Ndërsa kryetari i Komunës së Çairit, u shpreh se kjo është një hapësirë e cila ka qenë më se e nevojshme për funksionimin e mirë të këtij spitali. "Numrat statistikor tregojnë që mbi 40 për qind është bërë rritja e lindjeve këtu në këtë spital. Njerëzit kërkojnë cilësi, unë jam i bindur me drejtorin në krye dhe gjithë mjekët tjerë dhe shërbimet që iu ofrojnë popullatës sonë do të vijnë shërbimet e mirëfillta", tha Visar Ganiu. Gjithashtu edhe drejtori i spitalit, Bashkim Ismaili falënderoi Turqinë dhe TIKA-n për mbështetjen tyre ndaj spitalit. Në kuadër të projektit përveç renovimit dhe rregullimin e mjedisit për këtë repart të spitalit, TIKA ka dhuruar lavatriçe, makina tharëse, hekur industrial, pajisje për zbutjen e ujit, peshore për tesha, karroca për mbajtjen e mbulesave dhe ndërresave të lagëta, të thata dhe të papastërta, lavabo për larjen e mbulesa dhe ndërresave, dollape, dhomë për pushim të personelit, tavolina dhe karrige. *(D.K)*

Rifillon parkimi zonal me pagesë në Gostivar

Gostivar, 15 tetor - Pas vendosjes së tabelave dhe përgatitjeve paraprake për rifillim të suksesshëm, prej dje pasdite ka filluar të zbatohet parkimi zonal me pagesë në Gostivar. Qyteti i Gostivarit është i ndarë në dy zona për parkim, në atë "të kuqe" dhe "të gjelbër". Për zonën "e kuqe", konkretisht për pjesën qendrore të qytetit, për një orë parkim çmimi është 25 denarë, kurse për zonën "e gjelbër" - zona periferike e qytetit, parkimi për një orë kushton 10 denarë. Parkimi do të paguhet prej të hënën deri të shtunën edhe atë e hënë - e premte prej orës 7 deri orën 21, ndërsa të shtunën prej orës 7 deri në ora 14. Të dielave dhe në ditët e festave shtetërore parkimi nuk do të paguhet.

"Në javën e parë nuk do të zbatohen masat ndëshkuese, e që nënkupton vendosjen e bllokatorëve apo bartjen nga karrotreci, por megjithatë kërkojmë prej qytetarëve që t'u përmbahen rregullave që kjo t'u kalojë prej tash në shprehi dhe të mos vijë deri në sanksione. Vlen të theksojmë se për ata të cilët nuk do të dërgojnë sms-porsoi përkatëse, pas bllokimit të automjetit - pronari obligohet të paguajë gjobë prej 1000 denarësh dhe nëse brenda një ore sërish nuk e paguan edhe bllokimin, atij automjeti i merret nga karrotreci", ka thënë drejtori i NP "Parkingje Publike dhe gjelbërime", Muzafer Zulbeari. Ndryshe, për transportuesit publik parkimi zonal nuk vlen. Për taksitë dhe furgonët mbetet procedura e deritanishme që paguhet që me marrjen e licencës për të ushtruar bartje publike dhe ata nuk do të paguajnë parkim. *(U.H)*

Fillon sezoni i ngrohjes për konsumatorët e BEG-ut

Shkup, 15 tetor - Prej dje filloi sezoni ngrohës për konsumatorët e kompanisë BEG. Konsumatorët e lidhur me sistemin e ngrohjes qendrore do të përdorin energji termike deri më 15 prill 2019.

Në këtë periudhë shpërndarja e energjisë termike kryhet sipas rregullave dhe diagrameve të vendosura strikte varësisht nga kushtet atmosferike dhe temperaturat e jashtme. Këto rregulla dhe diagrame janë përcaktuar në rregulloren për shpërndarjen e ngrohjes deri tek konsumatorët e miratuar nga Komisioni Rregulator Energjetik i Republikës së Maqedonisë.

Nëse temperaturat e jashtme janë më të ulëta, gjatë periudhës së rregullt do furnizohet sasi më e madhe e energjisë ngrohëse dhe anasjelltas, ashtu që konsumatorët kanë siguruar kushte komode dhe shtëpi të nxehta sipas standardeve, gjegjësisht temperatura në shtëpi jo më të ulëta prej 20 +1 gradë Celsius. Në kushte të caktuara atmosferike, në mot mjaftueshëm të ngrohtë, kur nuk ka nevojë për ngrohje, do të ndërpritet shpërndarja e energjisë termike në periudhat me temperatura të larta të jashtme, ndërsa menjëherë pas uljes së temperaturave të jashtme nën vlerat e specifikuara ngrohja përsëri do të kyçet. Gjatë shpërndarjes të energjisë termike sigurohet konsumimi optimal i energjisë ngrohëse me shpenzime minimale për ngrohjen e konsumatorëve, theksojnë nga BEG. Informojnë se gjatë këtij viti në krahasim me vitin e kaluar numri i konsumatorëve të rinj është rritur, ndërsa tendenca e rilidhjes është falë komoditetit të lartë të cilin e fitojnë konsumatorët për çmim më të mirë, në përputhje me të gjitha standardet ekologjike.

ÇEGRANI BËHET ME STADIUM TË RI

Gostivar, 15 tetor - Fshati më i madh i Komunës së Gostivarit, Çegrani, u bë me stadium bashkëkohor për futboll të vogël. Komuna e Gostivarit siguroi barë artificial cilësor, shenjëzim të terrenit, ulëse plastike dhe ndriçim përkatës, ndërkaq realizimi i punëve u bë kryesisht falë angazhimit të Bashkësisë Lokale të fshatit Çegran.

"Çegrani u bë me një stadium modern për futboll të vogël, për çka na i kanë lakmi jo vetëm fshatrat por edhe qytetet e këtij rajoni. Me barin artificial të shenjëzuar sipas të gjitha standardeve, me 330 ulëse për spekatatorët dhe me ndriçim adekuat, rinia e Çegranit do të mund ketë mundësi që të merret me këtë sport, por edhe të organizojë aktivitete të ndryshme me karakter lokal dhe rajonal", thotë Sabri Bafqari, kryetar i Bashkësisë Lokale të Çegrant, duke potencuar se realizimi i këtij projekti u bë falë angazhimit të pamohueshëm të bashkësisë lokale.

Ai falënderoi kryetarin e Komunës së Gostivarit, Arben Taravari, për mbështetjen e aktiviteteve të Bashkësisë lokale, por edhe banorët lokalë të cilët vihen në dispozicion që secili sipas mundësive të ndihmojë në realizimin e projekteve të ndryshme dhe tashmë Çegrani t'i ngjasojë një

mjedisi urban. Nga Komuna e Gostivarit thonë se janë planifikuar një sërë projektesh të cilat do të implementohen në Çegran gjatë këtij mandati, për të kompensuar mungesën e investimeve në këtë fshat gjatë mandatit të shkuar. *(U.H)*

Rosat e Robert Cooperit

Nga
Veton SURROI

1. Është ajo barsoleta e vjetër e rosave që sëmuren dhe për t'i shpëtuar, fermeri dëgjon këshillat e një mjeku magjistar. E dëgjon kur i rekomandon që t'i nxjerrë rosat në ajër të freskët në netët me hënë të plotë, pastaj kur nuk funksionon kështu, që t'i lajë me ujë të vakët para se të dalë dielli, pastaj kur nuk funksionon as kjo t'i lajë me ujë të ftohtë para se të perëndojë dielli... dhe pastaj receta të tjera me radhë derisa fermeri t'i thotë: "Ti receta paske boll, por unë nuk kam më rosa për to".

Është recetë e mirë për diplomatë, në veçanti për ata që janë marrë me Kosovën dhe posaçërisht për Robert Cooperin, ish- ndërmjetës i Bashkimit Evropian, që shkroi marrëveshjen historike mes Hashim Thaçit dhe Ivica Daçiqit, më 2013. Marrëveshja qe aq e mirë dhe aq historike saqë grupi socialist në Parlamentin Evropian nominoi Thaçin dhe Daçiqin për çmimin Nobel për paqe. Për fat të keq, rrethanat në terren qenë më kokëforte se marrëveshja historike për normalizim, dhe Thaçi me Daçiqin nuk e fituan çmimin Nobel për paqe. Rrethanat qenë po aq kokëforte saqë nuk dëgjuan Thaçin se me këtë marrëveshje Serbia de facto e ka njohur Kosovën, Daçiqin se me këtë marrëveshje Serbia u rikthye në Kosovë dhe Robert Cooperin se me këtë marrëveshje Serbia dhe Kosova normalizojnë marrëdhëniet e tyre.

2. Disa vjet pas kësaj marrëveshjeje fola në prani të Robert Cooperit në një konferencë në Oxford, duke përsëritur pak a shumë gjërat që ia kisha thënë edhe më herët, se marrëveshja nuk do të funksiononte pa parime më të forta udhëheqëse, se nuk ka "normalizim" të këtillë çfarë ai propozon dhe që madje, Serbia ka krijuar një avantazh të madh me Asociacionin e komunave serbe. Ai mohoi disa prej gjërave dhe pastaj mori një pozicion neutral, të ndërmjetësit: nëse palët janë dakorduar për një gjë të tillë, kush jam unë t'u them se e kanë gabim. Në njërën anë kishte të drejtë: nëse Hashim Thaçi dhe e dërguara e tij E.Tahiri pranonin me nënshkrim të tyre se Serbia ka të drejtë ta kontestojë pavarësinë e shpallur, pse duhet ta mbrojë Kosovën prej tyre Robert Cooperi?

Për më tepër, Cooper si diplomat i kishte dhënë vetes detyrë që të jetë asnjanës, ndodhi çfarë ndodhi. Dy vjet para se të arrinte marrëveshjen historike mes Thaçit dhe Daçiqit, që duhej t'u jepte çmimin Nobel për paqe, ai kishte udhëtuar në Bahrain, emirat të vogël në Gjirin Persik. Aty kishin shpërthyer demonstratat prodemokratike dhe policia kishte reaguar e vrarë nja 20 protestues. Robert Cooper, si i dërguar i BE-së u deklaroi anëtarëve të Parlamentit Evropian: "Nuk jam i sigurt se policia ka pasur rast të ballafaqohet me këto çështje të sigurisë publike më herët. Nuk është e lehtë të kesh punë me demonstrata të mëdha, në të cilat mund të ndodhë dhuna. Është çështje e vështirë për policinë. Nuk është një çështje që ia qëllojmë edhe në shtetet më të mira perëndimore dhe ndodhin aksidentet".

Pra, kishin të drejtë demonstruesit; demokracia është synim i mirë. Kishin të drejtë edhe policët që vranë demonstruesit; aksidentet ndodhin edhe në shtetet si Britania, Gjermania e Franca... Vetëm se nuk ndodhin: 20 të vrarë në demonstrata paqësore në Britani, Gjermani e Francë mund të kenë ndodhur para njëqind vjetësh, por jo në demokracitë e sotme.

3. Por Robert Cooper ndodhi të zgjedhë rol asnjanës edhe ndaj dimensionit kohor. Javën e kaluar botoi një editorial, në cilësinë e anëtarit të ECFR (Këshillit Evropian për Marrëdhënie të Jashtme), në të cilin pak a shumë avokonte që t'u lihet e drejta Thaçit dhe Vuçiqit që të hulumtojnë zgjidhje për këmbim territoresh e popullatash. "Zgjidhja evropiane ka qenë që kufijtë të mbesin siç janë, dhe të bëhen jorelevantë. Kjo ka funksionuar mrekullisht për ne. Por po ashtu duhet të pranojmë se ne bëmë shumë lëvizje kufijsh para se të mbërrinim në atë pikë". Rrjedhimisht, Kosova dhe Serbia, shqiptarët e serbët, mund të bëjnë nja njëqind vjet lëvizje kufijsh derisa të mbërrijnë në pikën ku bëhen evropianë, aty ku mbërritën francezët e gjermanët, pas dy luftërave botërore, e të konstatojnë se kufijtë duhet bërë jorelevantë dhe jo lëvizur ata. Kosova dhe Serbia nuk bën të jenë evropiane sot. Mund të bëjnë këmbim territoresh e popullatash. Sipas portalit "Politico", një përkrahës i kujdesshëm i këmbimit të territoreve e popullatave është "diplomati veteran Robert Cooper, ndërmjetësi evropian në dialogun e hershëm të pasluftës mes dy palëve. Pse?". Dhe përgjigjet Cooper: "Sepse gjendja e tanishme nuk funksionon". Por si nuk po funksionon: A nuk u nënshkrua marrëveshja historike për normalizim më 2013? A nuk u integrua veriu? A nuk u njoh de facto Republika e Kosovës?

Si u bë që njeriu i cili hartoi marrëveshjen e prillit 2013 dhe e shpalli atë të jetë arritje historike, tani thotë se situata mes Kosovës dhe Serbisë nuk funksionon. Por si nuk po funksionon: A nuk u nënshkrua marrëveshja historike për normalizim më 2013? A nuk u integrua veriu? A nuk u njoh de facto Republika e Kosovës?

4. Në "Politico", Cooper thotë se nëse veriu i Kosovës bëhet pjesë e Serbisë, kjo do të ishte njohje e realitetit dhe e dëshirave të shumicës së njerëzve që jetojnë aty". Kjo, pasi që më 2013 u nënshkrua marrëveshja me të cilën u tha, edhe nga Robert Cooper, se veriu e njeh realitetin e Republikës së Kosovës. Dje në Moskë, pas takimit me presidentin rus Putin, presidenti serb Vuçiq deklaroi se ndarja, këmbimi territorial dhe zgjidhje të ngjashme më nuk janë në agjendë, sepse kundër kësaj janë të gjithë: "shtetet e BE-së, shqiptarët, serbët". Tash Robert Cooper mund të sjellë një propozim të ri që e përkrah: daljen e rosave në mesnatë, larje me ujë të vakët në agim e të ftohtë para perëndimit të diellit. Derisa të ketë rosa. *(koha.net)*

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
Epërdëshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 15 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Mësonjëtorja si metaforë e shoqërisë në miniaturë

Nga
Xheladin MURATI

Mësonjëtorja, para së gjithash, e reflekton shumësinë e interesave dhe karaktereve, ku dukshëm vërehen dallimet mes nxënësve dhe problemet e integrimit social. Në fakt mes mureve ky mikrokosmos apo shoqëri në miniature fillon që nga klasa e pare, pra që nga mësonjëtorja. Këtu është shumë e rëndësishme që të fëmijët të krijohen qëndrime pozitive dhe emocione pozitive ndaj shkollës. Të zhvillohet dashuri ndaj shkollës dhe të mënjanohet frika eventuale, dilema e të ngjashme duke përkufizuar qartë ç'është loja, ç'është obligimi dhe puna. Praktikisht të ndërtohet qëndrimi: më shumë punë e më pak lojëra. Mësonjëtorja të kuptohet si mjedis edukimi dhe pune.

I. Premisat e trajtesë: Baza e njohurive për punën në mësonjëtore përfshin mijëra pyetje dhe sqarime që të gjitha relevante në aktivitete ditore të mësimit që zhvillon mësuesi. Për këtë qëllim me rëndësi janë tre premisat vijuese:

1. Sa më mire që dini dhe të kuptoni se çfarë ju jepni për nxënësit, aq më kreativ do të bëheni në mësonjëtoren brenda katër mureve.

2. Qasja më e madhe në punën tuaj pedagogjike e mësimore është fakti i sqarimit dhe prezantimit më të mire të dijeve tuaja.

3. Mësuesi është ekspert për punën pedagogjike dhe menaxhimin specifik të jetës në mësonjëtore.

II. Qasjet dhe aspektet: Në mësonjëtore arrihen suksese, por ka edhe situata konflikti. Nxënësit disa orë në ditë gjenden të "mbyllur" mes mureve të klasës . Por ato nuk mbeten kurrë të vetmuar, por as nuk janë kurrë të pavarur. Mësuesi është pjesëmarrës në madhështinë, forcën e në edukimin e tij. Ato janë në proces zhvillimi sipas kërkesave pedagogjike. Dhe ajo që është më e rëndësishme nxënësit nuk mund të zgjedhin me kë duan të jenë të "mbyllur". Kjo mbase 20 apo 25 ose më pak apo më shumë mes veti janë shumë të ndryshëm, por nuk janë zgjedhur mes tyre, ndërsa prej tyre pritet barabarësi në sjellje, në mësim, në respektimin e rregullave të mësonjëtores e të shkollës. Koncepte të tilla si përshtatja, reagimi, kohezioni i grupit, kontrolli, udhëheqja, mënyra e drejtimit të punës në mësonjëtore janë elemente qendrore për mbarëvajtjen dhe cilësinë e punës.

Që të arrihet sukses në situatat shkollore në mësonjëtore, raportet mes nxënësve dhe raportet në relacion nxënës-mësues duhet doemos të jenë burimore, të natyrshme dhe jo sjellje aktoriale. Këtë e them edhe për arsye sepse ka mësues që e konsiderojnë veten pakicë në raport me nxënësit dhe po këto, realisht nxënësit reagojnë dhe tregojnë një forcë ndaj mësuesve.

Këtu shtrohen shumë pyetje: Çfarë duhet ndërmarrë që nxënësit të adaptohen lehtë në mësonjëtore? Si të pritet që fëmija i cili në familje asnjëherë nuk flet gjuhën letrare, kurse në shkollë të flet pastër e rrjedhshëm në gjuhën letrare? Si të evitohet tek nxënësit përqeshja nga shokët? Si të punohet me nxënës të cilët nuk kanë asgjë të përbashkët të ulen dhe të punojnë për të njëjtat qëllime? Si të mënjanohet frika? Etj. Këto janë pyetje që nuk kanë të bëjnë vetëm me nxënësit në mësonjëtore por edhe në shkollë përgjithësisht. Aty ndodhin shumë padrejtësi, shumë gjëra të ndryshme, shumë interesa e motive dhe nuk flasin të gjithë njëlloj.

Në raportet që krijohen në mësonjëtore gjithnjë ka përpjekje që asnjëra pale të mos e mbroj ose gjykojë tjetrin. Të dy partneret në mësonjëtore kanë uljet dhe ngritjet e tyre, momente të shndërritshme dhe momente të dobësive dhe shpirtngushtësive. Secila pale apo secili partner nxënës-nxënës, nxënës- mësues paraqesin diçka sa paradoksale po aq edhe jashtëzakonisht pozitive, e kjo është se, pavarësisht të asaj sesa shkolla apo mësonjëtorja paraqet mikrokozmos apo shoqëri në miniature me momente sa të mira po aq edhe dëshiruese, ajo megjithatë prodhon fatmirësi të madhe. Nga ai kaos lindin shumë inteligjent.

Pikërisht në mësonjëtore pasqyrohet një opus ëndërror. Meqë aty shohësh fytyra të qeshura, të mrrolura e të zbehta. E gjithë që është e nevojshme është motivimi dhe inspirimi. Për këtë qëllim mësuesi në rolin e skenaristit ka nevojë të hartoje plan veprimi, të caktoje objektivat specifike dhe reale, qëllimet kryesore dhe parësore.

Në këto raporte garantoj se në mësonjëtore do të gjeni një motivim shtesë. Për këtë mësuesi për çdo ditë duhet të shpenzon disa minuta duke menduar për qëllimet dhe planin e veprimit për t'i arritur ato qëllime. Mësonjëtorja si ambient social dhe edukativ ka rëndësi në zhvillimin e vlerave si kurajon, nderin e dinjitetin, respektin e mirëkuptimin për tjetrin, besnikërinë, intuitën, imagjinatën, solidaritetin, shpirtin e kolektivit e të ngjashme. Mendoj se mësuesi duhet të bëhet i fuqishëm dhe të zbatoj planin në mësonjëtore. Nuk duhet të ketë "nëse", nuk ka "por...", ekziston fjala vetëm përpara.

Duhet të qartësoni mire se cilat janë aktivitetet që keni në plan të zhvilloni për të arritur kohezionin social, integrimin social dhe ekuilibrin emocional. Njëherësh duhet të gjenden metoda për të ekuilibruar zhvillimin intelektual të nxënësit dhe të përshtateni me ndryshimet që ndodhin në raportet nxënës-nxënës. Në këtë kontekst është shumë e rëndësishme përgatitja dhe pjekuria sociale e fëmijëve. Kjo nënkupton se te fëmijët duhet zhvilluar shprehitë kulturore në të folur, në sjellje dhe respektimin e të tjerëve, krijimin e komunikimeve mes fëmijëve dhe rrethit, të krijohen shoqëri të reja dhe të ketë përgjegjësi.

Kur fëmija ngadalë hynë në botën e obligimeve dhe në botën e të rriturve, kërkohet syçeltësi e barabarësi nga mësuesi ashtu edhe nga prindi dhe vetë fëmija. Ai, në fakt ka hyrë në mësonjëtore, e cila reflekton si metaforë e shoqërisë në miniature. Kjo edhe për faktin se mësonjëtorja paraqet bashkësi vlerash, bashkësi temperamentesh e karakteresh dhe bashkësi interesash

Kam mendimin se mësonjëtorja apo klasa do të funksionon si shoqëri në miniaturë nëse jepen: 1. Njohuri të mirëfillta për jetën e shoqërinë, 2. Të mësuarit e lehtë, 3. Parimet dhe normat e bashkëjetesës, 4. Të matet dhe të tregohet progresi social dhe 5. Të keni mekanizma për përgatitje për jetë.

III. Përfundim: Nisja në shkollë është një nga ngjarjet më të rëndësishme në jetën e fëmijës. Ajo paraqet kthesë zhvillimore në rrugëtimin e tij jetësor. Në këtë rast kur fëmija ngadalë hynë në botën e obligimeve dhe në botën e të rriturve, kërkohet syçeltësi e barabarësi nga mësuesi ashtu edhe nga prindi dhe vetë fëmija. Ai, në fakt ka hyrë në mësonjëtore, e cila reflekton si metaforë e shoqërisë në miniature. Kjo edhe për faktin se mësonjëtorja paraqet bashkësi vlerash, bashkësi temperamentesh e karakteresh dhe bashkësi interesash.

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Koha për Kulturë

Koha, e martë, 16 tetor 2018

MULLA IDRIZ GJILANI - EPIQENDRA E ''FLAKËS SË JANARIT 2019''

Këtyre ditëve, opinini gjilanas dhe më gjerë, u njoftua për nisjen e përgatitjeve për organizimin e Manifestimit Kombëtar të Kulturës, "Flaka e Janarit", nisma dhe selia e të cilit, ishte dhe mbeti Gjilani.Mirë, boll!Thënë të drejtën, përgatitjet (nëse nuk mbesin vetëm si fragment i një konference shtypi), po nisin pak më herët se herave tjera, e kjo është për t'u përshëndetur.Dhe, përshëndetja ime, shoqërohet me disa propozime që mund t'i ndihmojnë këtij Manifestimi, ndër më të veçantit në trevat e Ballkanit, shkruan në rrjetet sociale shkrimtari Sabit Rrustemi, organizuesi kryesor i të gjitha manifestimeve kulturore që mbahen në Gjilan.

E para, "Flaka e Janarit" është Manifestim Kombëtar i Kulturës që nderon përmes vlerave të artit (dhe vetëm përmes vlerave) martirët, dëshmorët dhe heronjtë e kombit. Nuk është Manifestim shumëkulturor (e as multikulturor), sepse në të dhe brenda tij, prej fillimit e këndej janë paraqitur vetëm vlerat e kulturës shqiptare të artit pamor, skenik, letrar e muzikor. Jo edhe të kulturave të tjera apo të popujve të tjerë.Pra, kësaj çështje duhet vënë PIKË, njëherë e përgjithmonë.Nëse në të ardhmen (gjë që nuk e besoj e as dëshiroj) pjesë e saj bëhen edhe kulturat e pakicave kombëtare që jetojnë, veprojnë e krijojnë në Kosovë, atëherë, po... mund të thuhet "Manifestim shumëkulturor" por, kjo e shtrembëron në thelb qëllimin dhe përkushtimin e "Flakës..." që u shpreh nga viti jo dhe aq i largët (1992) e këndej.

E dyta, Manifestimi i sivjem i "Flakës..." duhet t'i përkushtohet njërës prej figurave më të dinjitetshme të historisë së Gjilanit e të krahinës së Anamoravës, Mulla Idriz Gjilanit, në 70-vjetorin e djegies makabre të Tij nga argatët dhe urdfhër dhënësit e shërbimit më famëkeq që prodhoi ish Jugosllavia titiste – OZNËS, e cila do të duhej të rrumbullakësohet me ngritjen e Shtatores së tij, diku në pjesën qendrore të Gjilanit dhe, për këtë Komuna Ime duhet të tregohet e gatshme,serioze dhe këmbëngulëse që nga i pari i saj e deri të secili prej nesh.

E treta, vëmendje kryesore dhe preokupim i vetëm duhet të jetë rritja e cilësisë së përmbajtjes së këtij Manifestimi, meqë e kemi pas thënë qysh sa ishim nën pushtimin serb: më të shtrenjtit e kombit që u flijuan nëpër kohë për atdhe, do të nderohen vetëm me vlera të mirëfillta të artit e, këtë duhet ta përzgjedh dhe ta paraqes para publikut gjilanas e atij kombëtar, Këshilli Drejtues i këtij Manifestimi, përmes Grupeve të saja profesionale.

E katërta, meqë i përmenda Grupet Profesionale, Gjilani duhet të tregohet se është gjiithëpërfshirëse edhe me kuadrot nga fushat kryesore të artit, të cilat e përcollën këtë Manifestim, që nga fillimi. Pra, angazhimi i njerëzve të denjë të këtyre fushave, nga Prishtina, Tirana e Shkupi si dhe trevat tjera shqiptare, nëpër Grupe Punuese Profesionale, sepse nëpër Juri të ndryshme veç kanë qenë, duke e bërë edhe me këtë mënyrë, njëmend manifestim kombëtar, sepse, e meriton këtë "Flaka e Janarit".

E pesta, e që kujtoj se është mjaftë qenësore: Zgjedhja zyrtare e emblemës së Manifestimit apo logos siç e quajnë pa të drejtë disa, e që përfaqëson katër shtyllat kryesore të "Flakës...", kuptohet, përmes një konkursi publik, një jurie kredibile të artit si dhe miratimit në fund nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mënyrë që të përmbylet loja me Emblemën e këtij Manifestimi, sepse, kështu si e kemi bërë, nuk na ka hije ta bëjmë edhe mëtutje, e aq më pak, kur kemi të bëjmë me identitetion dhe përfaqësimin e këtij Manifestimi. Besoj se, përveç nivelit komunal e në këto kondita, do të ndihmojë edhe më shumë se vitin e kaluar niveli qendror, meqë dihet botërisht: "Flaka e Janarit" ndodh në Gjilan por, e përfaqëson krejt Kosovën dhe, shqiptarinë, përfundon Sabit Rrustemi.

Hapet ekspozita e fotografike "Unë jam Shqiptar"

Ekspozita fotografike kushtuar diasporës shqiptare ndër shekuj "Unë jam SHQIPTAR" në organizim të Muzeut Historik Kombëtar të Shqipërisë, Galerisë Kombëtare të Maqedonisë dhe Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni është hapur mbrëmë (e hën) në Galerinë Kombëtare të Maqedonisë, objekti "Malla Stanica" – Shkup.
Ekspozita e cila për tematikë ka emigrimin e shqiptarëve, përfshin materiale fotografike mbi diasporën shqiptare ndër shekuj. Ekspozita fillon në mënyrë kronologjike me fotografinë e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, si përfaqësues i epokës më të lavdishme të shqiptarëve por dhe kohës kur filluan valët e para të emigrimit shqiptar. Ajo gjithashtu përmban foto të arbëreshëve të parë me ngulimet e tyre në Italinë e Jugut, foto të arvanitasve dhe rilindësve shqiptarë. Fotoja e emigrantit të parë në SHBA është moment i rëndësishëm në ekspozitë, duke vijuar më fotografi të shoqërive të para patriotike në Sofje, Bukuresht, Kajro, Stamboll e Vjenë. Pjesa tjetër e ekspozitës, por jo më pak e rëndësishme, prezantohet nëpërmjet fotografive nga personalitetet e suksesshme shqiptarë në vendet e emigrimit të tyre.

NË EKSPOZITËN KUSHTUAR SKËNDERBEUT U PREZANTUAN AFËR 40 LIBRA

Këto libra u ekspozuan në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" Për dy ditë radhazi qytetarët e Republikës të Kosovës do të kenë rastin të shohin afër 40 libra të vjetër për Skënderbeun, të ekspozuar në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani".

Kjo pasi është hapur të hënën ekspozita "Jeta dhe kohërat e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, Heroit Kombëtar Shqiptar", e koleksionit të Librave Antikuar të koleksionistes së njohur britanike, Patricia Nugee. Drejtori i Bibliotekës kombëtare, Fazli Gajraku, vlerësoi se ekspozita e sotme është ndër më të rrallat që mbahet në këtë bibliotekë. "Sot hapim këtë ekspozitë të rrallë, ndër më të rrallat që mund të shihet në Bibliotekën Kombëtare, koleksionin e Patricia Nugee me 37 tituj që përfshijnë epokën nga shekulli XVI deri në shekullin e XVIII. Për ne ka kohë, sepse në mandatin e drejtorit Bashota është krijuar një bashkëpunim me Patricia Nugee dhe kemi pasur fatin në atë kohë ta pranojmë prej saj librin që tashmë në Bibiotekën Kombëtare është libri më i vjetër 'Historia e Skënderbeut' i vitit 1583 dhe kjo referencë na mban si frymëzim për ta nderuar dhe respektuar Patricia Nugee, jo vetëm si njerëz të Kosovës por edhe si bibliotekë nacionale", tha ai.

Këshilltari i kryeministrit të Kosovës, Jahja Lluka bëri të ditur se për nder të Vitit të Skënderbeut, Qeveria e Kosovës ka organizuar një mori aktivitetesh, e ndër to edhe mbledhjen e dy qeverive, asaj të Kosovës dhe të Shqipërisë, ku do të merren vendime të rëndësishme për tregti të lirë. "Sot jam i lumtur që në mesin tonë kemi 37 botime të vjetra për historinë tonë dhe dua të falënderoj zonjën Patricia dhe të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e veçantë që sot të jenë prezent në Bibliotekën Kombëtare. Ne kemi shumë aktivitete deri në fund të vitit, po iu them se nesër është konferenca ndërkombëtare për Skënderbeun, ku marrin pjesë shumë ndërkombëtarë", u shpreh ai.

Koleksionistja Patricia Nugiee, e cila ka filluar koleksionimin e librave për Skënderbeun 30 vjet më parë, u shpreh e kënaqur me ekspozitën e ardhur në Prishtinë. "Nuk do t'ju jap sot një mësim historie sepse thjesht nuk jam historiane. Për herë të parë dëgjova për Skënderbeun përmes një klienti kur punoja në një librari me libra antike në Londër... 5'58" Një ditë emri i Skënderbeut u përmend në një bisedë dhe kur klienti iku, unë kërkova për emrin e Skënderbeut në Enciklopedinë britanike, një imazh kolosal i shekullit XV. Shumë shpejt bleva librin e parë të koleksionit të Marin Barletit, publikuar më 1596, që është një martesë perfekte e tekstit dhe përmbledhjes së librit", u shpreh ajo. Ish-drejtori i Bibliotekës kombëtare, Sali Bashota tha se është krenari për popullin shqiptar grumbullimi i gjithë këtyre librave nga koleksionistja Ptricia Nugiee. "Ndoshta një mirënjohje nga kryeministri apo Presidenca do të ishte pak për gjithë këtë mund që bënë Patricia për mbledhjen e koleksionit për figurën e Skënderbeut", tha Bashota.

Krejt në fund, drejtori i Bibliotekës Kombëtare, Fazli Gajraku i dha dhuratë koleksionistes Patricia Nugie emblemën e Bibliotekës Kombëtare, të punuar me dorë. Ekspozita organizohet nën përkujdesjen e Zyrës së Sekretariatit të Qeverisë për Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani". Ndërsa ekspozita do të qëndrojë e hapur për dy ditë. Ndryshe, Patricia Nugee, në vitin 2004, ia dhuroi Bibliotekës Kombëtare të Kosovës librin e Marin Barletit "Jeta dhe Vepra e Skënderbeut" të vitit 1533, i cili njëherësh është edhe libri më i vjetër në bibliotekë.

MIRASH IVANAJ, MODELI I SHQIPTARIT TË MIRË QË PËRFUNDOI NË FERR

Mirash Ivanaj iu dedikua arsimimit shqiptar dhe reforma e tij synonte të prekte thelbin e paditurisë shqiptare. Përfundoi në mënyrë tragjike, i trajtuar shumë keq nga regjimi në fuqi, të cilit i besoi verbërisht, kur besoi se mund të punonte nën të. Maksi e ka trajtuar me një kujdes, falë atyre imazheve që kanë mbetur, duke përshfaqur dhe nderimin e tij. Nuk e ka braktisur stilin e tij duke e përshtatur dhe imazhin e mësuesit të njohur për korpusin e tij artistik...

Nga Ben Andoni

Mirash Ivanaj haset pak e gjithnjë shumë pak në literaturën tonë. Madje, edhe atë ditë vjeshte, 65 vjet më parë, kur do të ndërronte jetë, ai pothuaj ishte harruar. Kurrë nuk mund të kesh trishtim më të madh në të gjallë sesa të harrojnë. Kjo i ndodhi, njërit prej personaliteteve më të jashtëzakonshme të kulturës dhe arsimit shqiptar. I sfilitur, i stërmunduar, bashkëkohësit, kujtonin se të ndjerit i dukej më mirë të qëndronte në burg sesa të dilte jashtë hekurave ku nuk e priste askush. Artikullshkruesit e jetës së tij pohojnë se ai i drejtoi një letër drejtorit të burgut për t'i kërkuar ta mbante ende sepse nuk kishte asnjë të ardhur për të jetuar dhe po ashtu asnjë vend se ku mund të qëndronte. Dhe "u shpërblye" realisht, pasi më 22 shtator të vitit 1953 do të ndërronte jetë vetëm12 ditë para mbarimit të afatit të dënimit të tij. Ishte 62 vjeç. Atëkohë, një moshë e denjë për moshën e tretë.

SA I KULTURUAR, PO AQ EDHE NAIV

Mirash Ivanaj futet ndër idealistët e pakët që erdhën në vend pas Luftës së Dytë Botërore të thirrur prej besimit se Shqipëria e Re do të ndryshonte dhe se do ishte tash e tutje vendi i dashur i tyre. Që në ditët e para të pushtimit të vendit ishte larguar në Turqi dhe atje kishte jetuar duke u marrë me punë të ndryshme për të mbijetuar, kurse nga larg duke ndjekur Shqipërinë po i dukej se një soj i idealistëve të rinj shqiptarë po vinte në skenë. Në fakt, kishte rënë "pré" e besimit që i kish afruar Gjergj Kokoshi, një miku i tij, që asokohe ishte emëruar Ministër i Arsimit. Kokoshi, që ndryshe nga Ivanaj, luftoi me fashistët ishte një pasaportë e madhe besimi për të, që të besonte se rendi do të vinte dhe madje arriti t'i shprehte respektin person Enver Hoxhës. Por, Ivanaj sa i kulturuar ishte aq edhe naiv mund të konsiderohet, pasi nuk mund ta kuptonte realisht atë që fshihej pas imazhit ndryshe të shumë prej çlirimtarëve. Në kujtime për të thuhet se ndjente një peshë të madhe faji, që ishte larguar nga vendi dhe nuk kishte luftuar si të tjerët. Ditët e pakta që po mjedisohej kuptoi se çfarë ishte Shqipëria e Re.

DI TË LEXOJË FRIKËN

Përgatitja për zgjedhjet do ishin përballja e parë, por nga ana tjetër dhe fytyra e Frontit Demokratik nuk ndryshonte nga ajo që i kishin treguar të afërmit. Ndoshta këtu është burimi i atij zhgënjimi, ku ai nuk do pranojë asnjë post në qeverinë e re, ndërkohë që do t'i kthehet arsimit si mësues i thjeshtë. Anipse bagazhi i madh kulturoro-profesional dhe ajo që do të sjellë është larg për mjedisin ku do të kontribuojë. Patetizmi, që e rrethon ngado, shtuar me mësuesit e ri kanë koncepte krejt të tjera dhe e bëjnë të ndihet sa më keq. Që prej asaj kohe, Ivanaj, nis heshtjen dhe miqtë e pakët që i kanë mbetur i mjaftojnë të kontrollojë jetën që e rrethon. Di të lexojë frikën. Dhe zhgënjimin. Te pak miqtë shikon frikësimin dhe nga ana tjetër kompleksin e heshtjes. E nuk mjaftojnë këto, sepse edhe ai që e ka kthyer pas e burgosin. Këtu i vihet kapaku të keqes. Gjergj Kokoshi nuk mund të jetë kurrë i tillë. Tashmë heshtja e tij mund të konsiderohet si krejt e përligjur, teksa miqtë po i rrallohen frikshëm. Mundohet t'u përcjellë nxënësve të tij sa më shumë koncepte, kurse pas mësimit heshton. Diku e vigjilojnë dhe mezi presin që burrit të vjetër t'i vendosin prangat, të cilat do ia zbukurojnë duart më 15 maj të vitit 1947.

Nuk ka vend për zhgënjim pse la Turqinë dhe besoi sepse tani duhet të prodhojë fajin e tij, që të bëhet i besuar i regjimit. Burgu është i ashpër për të por edhe fyes. E venë të përkthejë. Burri që ishte munduar të krijonte arkitekturën e arsimit shqiptar, duhej tashmë të provonte pas muajve "trajtimi" dëmin që i kishte shkaktuar pushtetit popullor të kohës. Juristët përballë kanë përballë një burrë të kulturuar që vërtetë di të parashtrojë argumente të kundërta por edhe të tregojë se përballja e regjimit me njerëz të kalibrit të tij nuk është e drejtë dhe është fatale për ato që do e presin Shqipërinë. Dhe, paradoksi është sa më shumë argumente profesionale për mbrojtjen parashtron aq injorancë i kundërvihet përballë. Fituese është keqësia. Dënimi është shembullor: Plot 7 vjet heqje lirie, me punë të detyruar, konfiskim të pasurive të tundshme e të patundshme dhe pas daljes nga burgu privime nga të drejtat civile dhe politike për plot 5 vjet.

KTHIM PAS

Në fakt, nxënësit e tij do e përmendin si legjendë urbane, pasi në të vërtetë në curriculumin e tij, kur e caktuan mësues në Gjimnazin e Shkodrës, do të rendisë gjuhët që zotëronte. Gjuhët e gjalla që rreshton janë respektivisht: shqip, serbisht, italisht, rumanisht, bullgarisht, gjermanisht dhe frëngjisht; të vdekurat: latinisht, greqisht, sanskritisht, godix (gotisht?), gjuhët e Italisë së poshtme dhe gjuhën sllavonike. A thua vallë kultura e bënte që të kishte kaq armiq. Ka të ngjarë që ajo të ketë qenë një nga arsyet. Në vitin akademik 1912-1913, bashkë me të vëllain ndjekin kurse filozofie në Universitetin e Beogradit, kurse pak vjet më vonë u nis drejt Italisë ku studioi në Universitetin e Romës dhe u laureua në dy degë: Filozofi-Letërsi dhe Jurisprudencë. Pak vite më vonë me të afërmin e tij Nikollë krijojnë në Shqipëri "Republikën", një organ ku Mirashi bën gati të gjitha punët, deri korrektor dhe punëtor shtypshkronje. Në 30 numra ata tregojnë kulturën kurse që në numrin e parë në tetorin e 1923, Ivanaj shpalosi një program me 11 pika, ku që në pikën e parë shkruan "Shkolla fillore dhe të mesme duhet të jetë vetëm në dorë të shtetit", duke iu përveshur klerit në përgjithësi dhe etërve jezuitë në veçanti, ku ka studiuar për shumë kohë. Nuk la pa goditur edhe Kongresin e Durrësit dhe Traktatin e Fshehtë, i cili u zhvillua me qeverinë italiane me 20 gusht 1919, ku kritikoi Kuvendin Kushtetues, pasi nga 318 anëtarët shumë prej tyre linin shumë për të dëshiruar sa i përket arsimit. Konflikti me Nolin e bën të shpërngulet dhe rikthehet me kohën e Zogut në vitin 1925, ku punoi si avokat dhe më 10 shkurt nisi punën si drejtor në gjimnazin shtetëror të Shkodrës, por duke punuar edhe si mësues i thjeshtë, teksa jep mësim në çdo lëndë që mundet.

Kulmi i karrierës së tij do të shkonte në vitin 1933, ku erdhi në krye të dikasterit të Arsimit, si ministri më i ri i qeverisë së Pandeli Evangjelit. Nuk mjaftojnë problemet me shqiptarët sepse njësoj do përplaset me Italianët, që e akuzuan vazhdimisht për ashpërsi dhe deri elementë ksenofobie. Në kurrizin e tij mbeti dhe përpjekja e filluar nga Monarkia në luftën me fenë dhe sidomos me shkollat fetare. E gjithë kjo veprimtari bëri që ajo të mos qëndronte më shumë se dy vjet në këtë post dhe pastaj i duhej të ikte. Ndërkohë, ajo që lë në këtë dikaster është e jashtëzakonshme: Ai bën të detyrueshëm arsimin fillor, në një popullsi masive analfabete, ndërsa hartoi "Ligjin e Arsimit" me idenë për të ngritur dhe realizuar një sistem të tërë arsimi kombëtar. Ai iu kundërvu shkollave të huaja dhe vetëm dy vjet më vonë dha dorëheqjen. Por, megjithatë, ka njerëz që mendojnë se ai mund të japë ende. Mirash Ivanaj nuk ka mbaruar karrierën e tij, sepse caktohet kryetar i Këshillit të Shtetit dhe këshilltar i mbretit Zog deri më 7 prill 1939, kohë kur me familjen Butka do të largohet në drejtim të Turqisë.

...

Këto të vinë ndërmend për një shqiptar të drejtë, që u u strapacua dhe u la të vdesë nga bashkatdhetarët e tij vetëm se donte t'i jepte pak staturë kulturës së arsimit shqiptar. Plot, 65 vjet më parë, Mirash Ivanaj, ndërroi jetë pak ditë para se të fitonte lirinë e përkohshme. Sot, mbetemi, thjesht të numërojmë ato që ai la për arsimin shqiptar, cilësitë dhe atributet e tij, por asfare atë që ne i bëjmë njerëzve tanë.

Maks Velo na ka ofruar në këtë numër një cikël, kushtuar personalitetit të madh Marash Ivanaj. Një personazh i jashtëzakonshëm, që e ka bërë për vete arkitektin dhe piktorin e njohur, e të cilit i ka kushtuar këtë cikël. Mirash Ivanaj iu dedikua arsimimit shqiptar dhe reforma e tij synonte të prekte thelbin e paditurisë shqiptare. Përfundoi në mënyrë tragjike, i trajtuar shumë keq nga regjimi në fuqi, të cilit i besoi verbërisht, kur besoi se mund të punonte nën të. Maksi e ka trajtuar me një kujdes, falë atyre imazheve që kanë mbetur, duke përshfaqur dhe nderimin e tij. Nuk e ka braktisur stilin e tij duke e përshtatur dhe imazhin e mësuesit të njohur për korpusin e tij artistik...

Në bazë të Vendimit të KRE me nr. ark. 02-1927/1 prej më 03.10.2018 për aprovimin e Rregullave për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e elektrodistribuimit, EVN Elektrodistribuimi DOOEL Shkup, Shoqëria për distribuimin e energjisë elektrike shpall

THIRJE TË HAPUR PUBLIKE

për shfaqjen e interesit për lidhjen e Marrëveshjeve kornizë për prokurimin e energjisë elektrike për një periudhë më të gjatë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e elektrodistribuimit

1. Lëndë e Thirrjes së hapur publike

Shpallet Thirrje e hapur publike me të cilën EVN Elektrodistribuimi DOOEL Shkup, Shoqëria për distribuimin e energjisë elektrike (në tekstin e mëtutjeshëm: EVN Elektrodistribuimi) i fton të gjitha palët e interesuara të shfaqin interes për lidhjen e Marrëveshjes kornizë për prokurimin e energjisë elektrike për një periudhë më të gjatë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e elektrodistribucionit. Marrëveshja kornizë paraqet bazë mbi të cilën EVN Elektrodistribuimi e definon prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e elektrodistribuimit.

2. Përkufizime dhe shkurtesa

(1) Nocionet e përdorura në këtë Thirrje të hapur publike e kanë domethënien në vijim:

Marrëveshje kornizë (MK)	Marrëveshje e lidhur ndërmjet Shitësit dhe OSD.
Ofertues	Prodhues ose tregtarë ose furnizues i energjisë elektrike i regjistruar në përputhje me rregullat ligjore të Republikës së Maqedonisë dhe të cilët posedojnë licencë përkatëse të lëshuar nga Komisioni Rregullator i Energjetikës i Republikës së Maqedonisë, si edhe kod EIC i lëshuar nga ana e SHA MEPSO e cila merr pjesë në Thirrjen e Hapur Publike
Ofertues i kualifikuar	Ofertues i cili ka lidhur Marrëveshje Kornizë me OSD
Ofertues i zgjedhur	Ofertues i cili ka lidhur Marrëveshje Individuale me OSD
Thirrje e Hapur Publike	Ky dokument i cili është publikuar në dy gazeta ditore në Republikën e Maqedonisë dhe është në dispozicion në faqen www.elektrodistribucija.mk
Prokurimi i energjisë elektrike	Marrëveshje e shitblerjes ndërmjet ofertuesit të kualifikuar dhe OSD me të cilin përcaktohen kushtet komerciale për shitblerjen e energjisë elektrike.
Marrëveshje individuale	Купопродажен договор помеѓу квалификуван понудувач и ОДС со кој се утврдуваат комерцијалните услови за купопродажба на електрична енергија.
Oferta	Oferta për shitjen e energjisë elektrike (MWh) me çmim të caktuar (EUR/MWh) e rrumbullakuar në dy decimale, e dërguar nga ana e ofertuesit të kualifikuar
Kërkesë Individuale për Dërgimin e Ofertave (KIDO)	Dokument në formë elektronike i cili është dërguar nga ana e OSD te të gjithë ofertuesit e kualifikuar me anë të postës elektronike ku në mënyrë precize përcaktohen kushtet sipas të cilave do të zbatohet procedura për prokurimin e energjisë elektrike për periudhë më të gjatë në treg të hapur nëpërmjet procedurës së tenderit
Procedura për prokurimin e energjisë elektrike	Radhitja e ngjarjeve të ndërlidhura me prokurimin e energjisë elektrike të cilat fillojnë me KIDO nga ana e OSD, oferta të dërguara nga ana e ofertuesve të kualifikuar, evaluimi dhe përzgjedhja e ofertuesve më të volitshëm dhe përfundojnë me lidhjen e Marrëveshjes Individuale me ofertuesit e zgjedhur.
Diagrami për distribuimin e energjisë elektrike dhe fuqisë	Kërkesë e OSD në të cilën përmbahet shpërndarja e energjisë elektrike dhe fuqisë, në nivel orësh, për periudhë të caktuar kohore.

(2) Shkurtesat e përdorura në këtë Thirrje të Hapur Publike do e kenë domethënien në vijim:

OSD	Operator i sistemit të elektrodistribuimit EVN Elektrodistribuimi DOOEL, Shkup
KRE	Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe Shërbime Ujore i Republikës së Maqedonisë
MK	Marrëveshje kornizë
MI	Marrëveshje Individuale
KIDO	Kërkesë Individuale për Dërgimin e Ofertave

3. E drejta për pjesëmarrje në Thirrje publike

Të drejtë për shfaqjen e interesit për lidhjen e MK kanë të gjithë prodhuesit e interesuar, furnizuesit dhe tregtarët me energji elektrike nga Republika e Maqedonisë të cilët janë të regjistruar në përputhje me rregullat ligjore të Republikës së Maqedonisë, dhe të cilët posedojnë licencë përkatëse të lëshuar nga ana e Komisionit Rregullator të Energjetikës të Republikës së Maqedonisë si edhe kod EIC i lëshuar nga ana e SHA MEPSO.

4. Përshkrimi i procesit për prokurimin e energjisë elektrike

OSD do të prokurojë energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e distribucionit në proces transparent, konkurrent dhe jodiskriminues. Ky proces është strukturuar në mënyrën në vijim:

A) Thirrje e Hapur Publike për lidhjen e MK

Ky dokument.

B) Vlerësimi dhe kualifikimi para lidhjes së MK

Vlerësimin e Ofertuesve të cilët shfaqin interes për lidhjen e MK e bëjnë personat e autorizuar nga ana e OSD. Personat e autorizuar prej OSD pas dorëzimit të dokumenteve nga ana e ofertuesit a që janë theksuar në pikën 5 të kësaj Thirrjeje të Hapur Publike bëjnë kontroll nëse dokumentet e dorëzuar janë të vlefshëm (jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj), dhe nëse janë lëshuar nga organet kompetente përkatëse të Republikës së Maqedonisë.

Personat e autorizuar nga OSD e informojnë Ofertuesin për kompletimin e dokumenteve dhe në qoftë se të njëjtat janë të tërësishme e ftojnë të lidhë MK me OSD dhe të fitojë statusin e ofertuesit të kualifikuar i cili mund të marrë pjesë në procesin e prokurimit të energjisë elektrike.

Në të kundërtën, në rast se dokumentacioni i dorëzuar nga Ofertuesi nuk është i kompletuar dhe i tërësishëm, i njëjti do të informohet për mangësitë dhe për të njëjtin procesi i kualifikimit do të zgjasë deri në kompletimin e dokumenteve të theksuara.

B) Склучување на РД

Ofertuesi i cili do të lidhë MK me OSD, fiton të drejtën e ofertuesit të kualifikuar dhe i njëjti mund të marrë pjesë në procesin e prokurimit të energjisë elektrike.

Ç) Kërkesa Individuale për Dorëzimin e Ofertave (KIDO)

Të gjithë ofertuesit e kualifikuar do të pranojnë KIDO nëpërmjet ueb platformës elektronike dhe/ose postës elektronike, në rastin kur është iniciuar procesi i prokurimit të energjisë elektrike. Çdo KIDO do të përmbajë instruksione dhe rregulla për dorëzimin e ofertës nga ana e Ofertuesit. Ofertuesi, me dorëzimin e ofertës së tij i pranon në tërësi rregullat e përkufizuara në KIDO dhe obligohet të procedojë sipas të njëjtave deri në përfundimin e procesit për prokurimin e energjisë elektrike dhe lidhjen e MI.

D) Rangimi dhe Zgjedhja e Ofertuesit më të Volitshëm

Rangimin e ofertuesit më të volitshëm e bëjnë persona të autorizuar nga OSD nëpërmjet evaluimit të ofertave me anë të "Listës së renditjes meritore". Lista e renditjes meritore formohet me radhitje rritëse ashtu që, e para e ranguar është oferta për energji elektrike me çmimin më të ulët. Çmimet për energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e elektrodistribuimit për prokurimin e energjisë elektrike për periudhë më të gjatë në treg të hapur llogariten për kriter primar për rangim dhe për zgjedhje të Ofertave. Koha e pranimit të Ofertave do të merret si kriter sekondar, vetëm në rast se dy ose më tepër oferta janë me çmim të njëjtë. Në rast të atillë përparësi do i jepet ofertës me kohën më të hershme të regjistruar të pranimit. Zgjedhjen e Ofertuesit më të volitshëm e bëjnë Drejtuesit e OSD, duke e marrë parasysh rangimin e ofertuesve më të volitshëm.

Dh) Shpallja e rezultateve dhe njoftimi

Shpallja e rezultateve nga procesi i prokurimit të energjisë elektrike për nevojat e OSD bëhet me dërgimin e njoftimit nëpërmjet postës elektronike te të gjithë Ofertuesit të cilët kanë marrë pjesë në procesin e prokurimit të energjisë elektrike dhe të cilët kanë pasur ofertë të vlefshme sipas instruksioneve dhe rregullave të përkufizuara në KIDO.

E) Nënshkrimi i Marrëveshjes individuale

Para skadimit të vlefshmërisë së ofertës, OSD do e ftojë Ofertuesin e përzgjedhur të lidhë MI brenda afatit të përkufizuar në KIDO. Në MI do të definohen të drejtat dhe obligimet ndërmjet OSD dhe Ofertuesit.

5. Dokumentacioni

Shfaqja e interesit nga ana e Ofertuesve të interesuar duhet ti përmbajë dokumentet në vijim:

- Deklaratë se në 5 (pesë) vitet e fundit nuk i është kumtuar aktgjykim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminele, për korrupsion, mashtrim ose larje parash;.
- Vërtetim se nuk është hapur procedurë falimentimi nga organi kompetent;
- Vërtetim se nuk është hapur procedurë likuidimi nga organi kompetent;
- Vërtetim për tatime, kontribute dhe detyrime tjera publike të paguara, nga organi kompetent i vendit ku Ofertuesi është i regjistruar;
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra penale të kryera të personave juridikë se nuk i është kumtuar dënim dytësor ndalese e përkohshme ose e përhershme për kryerjen e veprimtarisë së caktuar;
- Vërtetim nga Regjistri se me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është kumtuar sanksion kundërvajtës - ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, respektivisht, ndalesë e përkohshme për kryerjen e veprimtarisë së caktuar.
- Dokument për veprimtari të licencuar si provë se parashtruesi është i regjistruar si person juridik për kryerjen e veprimtarisë të ndërlidhur me shitblerjen e energjisë elektrike nga organi kompetent;
- Gjendja rrjedhëse e lëshuar nga organi kompetent;
- Raport për bilancin e gjendjes dhe të dhëna për bilancin e suksesit;
- Njoftim nga SHA MEPSO për kod identifikimi ENTSO-E O (EIC) të aprovuar dhe të regjistruar;
- Deklaratë se i pranon kushtet e MK dhe MI në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar;

Të gjitha dokumentet e duhura të theksuara dorëzohen vetëm në origjinal ose fotokopje e verifikuar në noter.

Dokumentet duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e vendit ku gjendet selia e subjektit që paraqitet në thirrjen publike dhe të njëjtat mos jenë më të vjetra se gjashtë muaj.

Vërejtje: *Fletëparaqitjet për shfaqjen e interesit për lidhjen e MK me dokumentacion jo të plotë nuk do të llogariten si të vlefshme derisa të kompletohen. Shtojcat e dorëzuara nuk kthehen.*

6. Mënyra e shfaqjes së interesit për lidhjen e MK

Të gjithë Ofertuesit e interesuar të cilët dëshirojnë të shfaqin interes për lidhjen e MK me OSD për prokurimin e energjisë elektrike, duhet ti dërgojnë të gjithë dokumentet e duhur në përputhje me këtë Thirrje të hapur publike të numëruara në pikën 5.

Shfaqja e interesit për lidhjen e MK për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e distribucionit duhet të jetë me dorëzimin e dokumenteve në adresën: EVN Elektrodistribuimi DOOEL Shkup, Shoqëri për distribuimin e energjisë elektrike, rr. 11 oktomvri nr 9, 1000 Shkup, në arkivin e EVN Elektrodistribuimi në zarf të mbyllur me shënim – Fletëparaqitje për lidhjen e Marrëveshjes kornizë për prokurimin e energjisë elektrike për periudhë më të gjatë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e elektrodistribuimit – MOS E HAP.

7. Dispozita tjera

Të gjitha harxhimet e shkaktuara për Ofertuesin gjatë përgatitjes dhe dërgimit të dokumenteve në lidhje me këtë Thirrje të hapur publike bien në barrë të Ofertuesit.

OSD do i marrë parasysh vetëm dokumentet e kompletuara në përputhje me pikën 5 të kësaj marrëveshjeje.

Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë Thirrje të hapur publike duhet të përcillen në formë të shkruar në postën elektronike në vijim : blagica.popovska@evn.mk ose ljuben.ilioski@evn.mk

8. Dispozitat përfundimtare

MK të lidhura ndërmjet OSD dhe ofertuesve të kualifikuar në bazë të Thirrjes publike paraprakisht të shpallur (01/17) do të vazhdojnë të vlejnë si MK për prokurimin e energjisë elektrike për periudhë më të gjatë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e distribuimit.

MK pushon të vlejë në rast se ofertuesi i kualifikuar:

- kërkon prishje të MK mbi çdo bazë,
- ka bërë kundërvajtje të obligimeve në përputhje me nenin 15 të Rregullave për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e elektrodistribuimit,
- nuk e vazhdon vlefshmërinë e licencës për kryerjen e veprimtarisë energjetike pas skadimit të afatit të vlefshmërisë, ose po e njëjta është suspenduar ose hequr nga ana e KRRE.
- e ka prishur marrëveshjen për kushtet dhe mënyrën e pjesëmarrjes në tregun e energjisë elektrike me operatorin e tregut për energji elektrike.

EVN

ESE TË PROTESTËS DHE TË SHPRESËS

(Reçencë për librin "Im atë dhe këlyshët e Titos" të autores Delvina Kërluku)



Nga Shaban MURATI

Esetë janë ndër gjinitë më të vështira të publicistikës, por edhe më interesantet për t'u lexuar, sepse identifikojnë gazetarinë si një lloj arti. Ndaj libri me ese i gazetares së talentuar Delvina KËRLUKU, me titull "Im atë dhe këlyshët e Titos" ngjall natyrshëm një kureshtje të veçantë njohëse dhe estetike. Me një sy të mprehtë vëzhgimi profesional autorja qëmton atë tematikë, e cila jo vetëm përgjithëson, por edhe simbolizon karakteristikat tipike të zhvillimit aktual të shoqërisë në Maqedoninë e sotme. Si gazetare, intelektuale dhe qytetare, që i përket popullit shqiptar në Maqedoni, esetë e saj sjellin përpara lexuesit përjetimet dhe shqetësimet e saj dhe të popullit të saj për problemet e shumta dhe të mëdha, që përballohen në marrëdhëniet e përditëshme shoqërore, ekonomike, politike, linguistike, historike, akademike, juridike, etj. Pasqyrohet një panoramë realiste, që dëshmon një zhvillim dhe ecuri disproporcionale, të cilat e kanë burimin në ndërtimin e pabarabartë të marrëdhënieve ndëretnike në një shtet, që u krijua dhe mbahet pikërisht në sajë të ekuilibrit midis dy popujve përbërës, popullit maqedonas dhe popullit shqiptar.

SHTJELLIM ARTISTIK I FENOMENEVE

Esetë e saj nuk kanë emocione nacionaliste dhe as hiperbolizim të ndjenjës dhe përkatësisë kombëtare, por shquhen për vështrimin mbi kohën, mbi njerëzit dhe mbi konfliktet, për të bazuar analizat e saj tek e verteta dhe tek e drejta për të gjithë. Ato kanë mprehtësinë e kapjes dhe të shtjellimit pothuaj artistik të fenomenit në dritën e realizmit dhe të kuadrit të mundshëm, ku duhej të ishin të zgjidhura çështjet. Duke hedhur pyetjen hamletiane: "Çdo të bëhet me ty populli im?" autorja ndërton boshtin e librit me ese mbi nevojën e njohjes dhe zgjidhjes së asaj pyetje madhore, që e bën të vuajë atë si autore dhe intelektuale dhe popullin e saj. Spektri i plotë i tipizimeve të situatave në fusha të ndryshme të jetës, që nga ekonomia e deri tek gjuha amtare, shfaq natyrshëm një protestë sociale dhe intelektuale, e cila shpreh zërin dhe aspiratën e një populli të tërë. Esetë e saj shkojnë përtej protestës dhe ngjallin dhe inkurajojnë shpresën. Ajo nuk pajtohet me padrejtësitë, që sheh dhe përjeton, por kërkon zgjidhjen e tyre.

Zgjidhjet, që ofron libri, janë në një sens realist, humanist e pozitiv, me një mendim të pjekur e të qartë se ndërtimi i një shoqërie dhe i një shteti të barabartë në Maqedoni për të dy popujt përbërës, është ndihmë jetike për vetë shtetin dhe popullin tjetër.

Autorja rrok një gamë të gjerë problemesh, të cilat jashtë çdo retorike, ftojnë për ndërgjegjësim qytetar. Ndërgjegjësim të vetë shqiptarëve për atë, që provojnë dhe vuajnë nga padrejtësitë, të cilat burojnë vetëm nga institucionet e një historie dhe të një gjuhe tjetër.

Esetë e Delvina Kërlukut zbulojnë gjenezën e padrejtësive tek historia dhe pabarazia e të kaluarës jugosllave e titiste dhe vazhdimësia e kësaj trashëgimie, të kaluare të hidhur, e cila u sanksionua edhe me shtetin e ri të Maqedonisë. Një shtet i ri, që adoptoi mentalitetin jugosllav ndaj populliti shqiptar dhe që gabimisht mendoi se duke mënjanuar popullin shqiptar nga barazia që i takon, do të ndërtojë një shtet njënacional vetëm për vete. Ndaj autorja refuzon të pranojë shovinizmin e brendshëm të projektit "Shkupi 2014", i ndërtuar mbi idiolatri inekzistente në planin historik, por shtypëse në planin psikologjik aktual.

AUTORJA KRITIKON FSHIRJEN E HISTORISË ME DORËN DHE PARATË TONA

Meritë e librit të autores është se jep një analizë të ekuilibruar, duke kërkuar disa herë rrënjët e së keqes, jo vetëm tek pala tjetër dhe as vetëm tek monpolizimi i pushtetit nga pala tjetër. Ajo nuk pajtohet me kompleksin e nënshtrimit të popullit të saj ndaj realitetit, dhe ka një kritikë edhe për popullin e saj, i cili është pajtuar me krijimin e situatave diskriminuese nëpërmjet gjendjeve shpirtërore e mendimore fataliste. Autorja kritikon fshirjen e historisë me dorën dhe paratë tona. "Të mjerë janë ata, që bien preh e sistemit dhe e pushtetit, që i krijojnë vetë", thekson me një filozofi proteste Delvina Kërluku. Është një konkluzion sa i vërtetë, aq edhe i pakëndshëm, që ia nxit asaj vete realiteti i gjërave në shoqërinë e sotme maqedonase. Për autoren është jashtë normales që shqiptarët të kontribuojnë dhe maqedonasit të ndërtojnë. Nga pikëpamja e së drejtës, që ajo ndërton esetë e saj, është e papranueshme që të ekzistojë një sistem selektiv i drejtësisë, në një kohë që të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit në një shtet demokratik, pavarësisht racës, gjuhës apo fesë. Është e papranueshme për autoren që shqiptarët të mos kenë të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe në institucionet e shtetit, njësoj si gjuha maqedonase, dhe autorja refuzon psikologjinë e robit që nënshtrohet.

Delvina Kërluku shtron me forcë disa çeshtje të realitetit etnik, të cilat kërkojnë ndërgjegjësimin si të institucioneve të shtetit, ashtu dhe të vetë popullit shqiptar e të përfaqësuesve të tij. Ajo ngren me forcë çështjen e shqiptarëve ortodoksë të krahinës së Rekës, të cilët janë shqiptarë të asimiluar dhe të cilët po fitojnë ndërgjegjen e tyre kombëtare në vitet e demokracisë. Delvina Kërluku si kryetare e shoqatës "Josif Bageri" ka dhënë një kontribut të madh në sensibilizimin e opinionit shqiptar dhe maqedonas për të drejtat njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve ortodoksë të Maqedonisë. Në libër autorja shtron me forcë çështjen e të drejtës së shqiptarëve ortodoksë të Maqedonisë për Kishën Ortodokse Shqiptare në Maqedoni, një e drejtë për të cilën duhet ta ngrejnë zërin partitë politike shqiptare dhe përfaqësuesit e tyre në qeveri, siç duhet ta ngrejë zërin e kësaj të drejte edhe Shqipëria dhe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë. Në këtë frymë është e lavdërueshme ngritja e çështjes së torbeshëve si shqiptarë të sllavizuar dhe të cilët gjithashtu janë zgjuar në kërkim të rrënjëve të tyre kombëtare dhe po u vënë fëmijve emra shqiptarë.

Në libër nuk mund të mos gjejnë pasqyrim çështjet të mëdha të marrëdhënieve ndëretnike si ajo e Lubotenit apo vendosja e kryqit të madh në Vodno në Shkup, të cilat japin penelata të profilit të një pushteti arrogant, që kërkon të imponohet me dhunë fizike dhe psikologjike mbi popullin shqiptar në Maqedoni. Duke i ballafaquar realitetet maqedonase me parametrat e drejtësisë, të lirisë dhe të demokracisë, të familjes europiane dhe të Bashkimit Europian, ku Maqedonia aspiron të hyjë, autorja shtron pyetjen migjeniane "fati ynë-deri kur"?.

Veçori e eseve të Delvina Kërlukut është kapja e tipikes në aktualitetin e shoqërisë së sotme të Maqedonisë. Libri mund të konsiderohet si një lakmus për të kuptuar dhe për të skanuar Maqedoninë e sotme. Esetë janë shkruara me një frazë dinamike dhe energjike, plot gjallëri e metafora, dhe me një gjuhë të mprehtë dhe të kulturuar, të cilat i japin librit një peshë ideoemocionale të veçantë. Do ta quaja një sukses të autores që esetë e saj po ecin gjurmëve të rrugës së prozës së shkurtër dhe të publicistikës së mprehtë të Migjenit dhe të Nonda Bulkës.

Libri "Im atë dhe këlyshët e Titos" sjell një kontribut në literaturën publicistike dhe në mendimin intelektual të popullit shqiptar në Maqedoni. Por vlera e librit të Delvina Kërlukut shkon përtej dimensionit dhe interesave të mjedisit, ku ajo jeton, dhe zgjon një interes më të gjerë, përtej kufijve të shtetit të Maqedonisë. Është një libër i nevojshëm për t'u lexuar nga cilido, shqiptar, maqedonas apo europian, që kërkon të njohë dhe të kuptojë Maqedoninë e sotme.

PARLAMENTI I BLLOKUAR

Zenun Pajaziti, deputet i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës, subjekt ky politik brenda koalicionit qeverisës, thotë për Radion Evropa e Lirë se agjenda e Kuvendit është e bllokuar njëanshëm dhe kjo do ta vështirësojë punën e tij edhe për proceset e rëndësishme

MBI 120 PROJEKTLIGJE PRESIN MIRATIMIN E DEPUTETËVE "DEMBELË"

Kuvendi i Kosovës do të tentojë që këtë javë t'u kthehet punimeve të rregullta me agjendë të stërngarkuar. Njëzet e pesë pika të rendit të ditës do të jenë në vazhdimin e seancës plenare të mbetur në gjysmë para tri javë. Po të hënën Kryesia do të vendosë për një tjetër seancë me 44 pika të rendit të ditës. Në mesin e tyre janë edhe projektligjet që kanë të bëjnë me shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri, pika e vetme që ka bërë bashkë partitë në pushtet dhe opozitën. Janë mbushur tri javë qëkur kryeparlamentari Kadri Veseli ka ndërprerë punimet e Kuvendit, për shkak të mungesës së kuorumit. Për pasojë, një sërë ligjesh presin vetëm votën e deputetëve. Nga 170 projektligje të parapara, janë miratuar vetëm 46 prej tyre. Në procedurë janë 71, ndërsa në pritje janë 53 projektligje të tjera.

Përplasjet dhe mosmarrëveshjet e partive politike të pushtetit dhe opozitës lidhur me mundësitë e miratimit të rezolutave të propozuara nga të dy palët për çështjen e dialogut të Kosovës me Serbinë, e kanë bllokuar punën e Kuvendit të Kosovës për miratimin e ligjeve, të cilat tashmë janë proceduar në legjislativ, vlerësojnë deputetët e partive në pushtet dhe opozitë. Zenun Pajaziti, deputet i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës, subjekt ky politik brenda koalicionit qeverisës, thotë për Radion Evropa e Lirë se agjenda e Kuvendit është e bllokuar njëanshëm dhe kjo do ta vështirësojë punën e tij edhe për proceset e rëndësishme.

"Kjo, në fakt, nuk do të duhej të ndodhte. Nuk do të duhej të bllokohej agjenda e rregullt e Kuvendit për shkak të këtyre zhvillimeve, sado që të jenë të rëndësishme. Madje edhe këto zhvillimet e rëndësishme dhe gjetja e zgjidhjeve për to, siç është zhbllokimi i procesit të bisedimeve, nuk mund të bëhet me qëndrime të njëanshme dhe me bllokim të institucionit kryesor. Do të jetë vështirë edhe për proceset e rëndësishme. Nuk mund të jetë justifikim asnjë kauzë tjetër me bllokimin e punës së rregullt të Kuvendit të Kosovës", theksoi Pajaziti. Ai ka shtuar se përpjekja e kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli, që t'i tubojë faktorët politik për një agjendë të përbashkët lidhur me dialogun me Serbinë, ishte, sipas tij, kërkesë reale për të pritur një vullnet pozitiv të subjekteve politike.

Por, në anën tjetër, Driton Selmanaj, deputet i subjektit më të madh opozitar në Kuvendin e Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke folur për Radion Evropa e Lirë, thotë se subjekti politik që ai i takon, pati thirrur shumë më herët një seancë të jashtëzakonshme për një rezolutë, e cila do ta artikulonte qëndrimin politik të Kuvendit që asnjë institucion nuk ka mandat që t'i diskutojë apo, siç thotë ai, t'i vë në pazar kufijtë e Kosovës. Ftesën e kryetarit të Kuvendit për krijimin e një agjende të përbashkët për dialogun, ai e quan lojë politike.

"Kuvendi, përfundimisht, është nën bllokadë. Tash, këto lojërat politike të partive politike në pushtet për të sjellë një rezolutë ku kinse artikulohen edhe qëndrimet dhe zëri i opozitës, por edhe themelimi i grupit negociator i qeverisë, kjo për ne është e pakuptimtë. Kjo për shkak se ushtrimi i kompetencave kushtetuese nuk ëhstë çështje sezonale. Tash i ka ra ndërmend Qeverisë se duhet një ekip i saj për të negociuar me Serbinë? Jo, këtë mandat kushtetues e kanë ata. Edhe me rezolutë, në vitin 2011 dhe 2012, Kuvendi i ka dhënë autoritet Qeverisë të negociojë. Nuk ka nevojë që qeveria të sjellë dokumente ku themelohen grupe të tjera ose emërohen mandatar, njerëz të ri, për të negociuar me Serbinë", theksoi Selmanaj.

Përderisa puna e rregullt e Kuvendit tashmë është bllokuar, në legjislativ tashmë janë proceduar mbi 70 projekt-ligje, të cilat presin të dalin para deputetëve për tu miratuar. Por, a mund ta çojë, ky bllokim i punës së Kuvendit, vendin në zgjedhje të parakohshme? Deputeti Pajaziti shpreh mendimin se një qasje e tillë, në momentin e tanishëm, do të ishte në kundërshtim me interesin e qytetarëve të vendit.

"Unë mendoj që ditëve në vijim, Kuvendi duhet ta vazhdojë punën me shumicën e tij, pavarësisht disponimit të vullnetit politik të një pjese të opozitës. Kjo do t'i mundësojë institucionit kryesor që të vazhdojë me agjendën e vet të rregullt dhe do të mundësojë që të krijohet një klimë e debatit në mes nesh, pushtet dhe opozitë, në Kuvend. Mendoj që kjo është ajo që i duhet vendit dhe mendoj që është interesi kryesor i qytetarëve", u shpreh Pajaziti. Por, deputeti Selmanaj ka hedhur poshtë mundësinë që puna e Kuvendit të zhbllokohet pa një mbledhje të jashtëzakonshme që do ta shqyrtonte propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

"Ne mund të mos e kalojmë asnjë ligj, me vite të tëra, por, ruajtja e integritetit, sovranitetit dhe dinjitetit shtetëror është gjëja më kryesore që mund t'i ndodhë Kosovës. Prandaj, nuk ka masa sanksionuese nëse nuk miratohen ligje, ky është realiteti dhe nuk ka masa sanksionuese nëse Kuvendi është jofunksional. Krejt çfarë duhet është reflektimi. Kush duhet të reflektojë? Në radhë të parë, partitë në pushtet, sepse ata në diskursin publik, shumica prej tyre, po e kanë qëndrimin e njëjtë me opozitën dhe pajtohen që kufijtë nuk janë pjesë e pazareve politike. Por, ndërkohë, ata nuk vijnë në Kuvend për t'i dhënë aprovim. Ne po u themi, diskursin publik që e kanë, ejani dhe ta artikulojmë edhe në dokument politik të Kuvendit, siç është rezoluta", theksoi Selmanaj.

Ai ka shtuar se edhe në rast të miratimit të një rezolute të tillë, Kuvendi e ka të vështirë që t'i kthehet normalitetit për shkak se partitë në pushtet, sipas tij, nuk e kanë shumicën parlamentare. Kjo, situatë, siç tha ai, imponon që vendi të përgatitet që të shkojë në zgjedhje të parakohshme. *(REL)*

TË ENJTEN, USHTRIA NË KUVEND

Kryesia e Kuvendit ka marrë vendim që në seancën e së enjtes të diskutohet për transformimin e FSK-së në ushtri. Me këtë rast, gjatë së enjtes kuvendi do t'i shqyrtojë në parim tri projektligjet për transformimin e FSK-së, të miratuara tashmë nga qeveria e Kosovës. Me këtë rast, kryetari i kuvendit Kadri Veseli, ka thënë se ushtria do të bëhet gjatë vitit 2018. "Ushtria e Kosovës do të kryhet brenda këtij viti. Duhet të shkojmë me mençuri dhe maturi që ta kryejmë brenda këtij muaji", theksoi ai. Ndërkohë, edhe LDK e LVV kanë pohuar tashmë se do të marrin pjesë në këtë seancë.

Emigracioni i paligjshëm rikthen kontrollet e dyfishta në kufirin Shqipëri-Kosovë

Janë rikthyer kontrollet e dyfishta në kufirin Shqipëri-Kosovë, në pikë-kalimin kufitar kryesor Morinë-Vërmicë. Por ndryshe nga tre vjet më parë, kësaj radhe është Shqipëria që në mënyrë të njëanshme ka vendosur kontrollin e dyfishtë, ndërkohë që në pjesën e Kosovës kontrollet vazhdojnë si më parë, vetëm në hyrje të këtij shteti. Përgjegjësi i turnit në pikë-kalimin kufitar të Morinës ka bërë të ditur se rikthimi i kontrolleve të dyfishta në kufi me Kosovën është bërë pas një urdhri të Drejtorisë së Policisë së Shtetit të Shqipërisë, por pa dhënë detaje se çfarë përmban ai. Në interesimin e "Kohës Ditore" për arsyet e rikthimit të kontrolleve të dyfishta, drejtori i kufirit dhe migracionit për Kukësin, Ferdinad Gjeta, i është përgjigjur përmes zëdhënëses së Drejtorisë së Policisë së Qarkut Kukës, Diana Deda. Por arsyeja e vërtetë e rivendosjes së kontrolleve të dyfishta është emigracioni i paligjshëm i shtetasve të Shqipërisë. Burime të policisë kufitare dhe atyre doganore në Morinë të Kukësit kanë bërë të ditur për "Kohën Ditore" se frenimi i azilkërkuesve nga Shqipëria drejt vendeve të BE-së është emergjencë kombëtare, pasi BE-ja i ka vënë si kusht kryesor Shqipërisë frenimin e azilkërkuesve për hapjen e negociatave në qershor të vitit të ardhshëm.

MARKUS SÖDER, KRYEMINISTRI MË I PADASHUR

Kryeministri bavarez, Markus Söder është mjeshtër i ndryshimit. Por shumë vetë në Bavari nuk i ka bindur kthesa e tij nga përçarës në babanë e përkushtuar të bavarezëve

Në Bavari u mbajtën zgjedhjet parlamentare, ku partia CSU shënoi rezultate më të dobëta se në zgjedhjet e kaluara. Markus Söder pretendon të rizgjidhet në postin e kryeministrit. Por kush është ai? Markus Söder është krenar me postin e tij si kryeministër i Bavarisë, me pushtetin, CSU-në dhe Bavarinë e bukur të "tij". Për Söder ka qenë gjithmonë një ëndërr që të bëhet kryeministër i Bavarisë. Për këtë ai ka punuar shumë - me vite. Pas marrjes së pushtetit nga Horst Seehofer në mars të këtij viti, partia CSU ishte në nivelin e mbështetjes në sondazhe mbi 40%.

Por CSU më nuk do të jetë e vetme në pushtet, si në të kaluarën. Markus Söder është tani përgjegjës për humbjen e shumicës absolute në Bavari. Me dekada të tëra atje ka qenë një lloj automatizmi zgjedhja e CSU në pushtet. Kristiansocialët janë në pushtet në Bavari më shumë se gjashtë dekada - ndonëse ndonjëherë në koalicion me të tjerët. Söder ka fajësuar qeverinë federale në Berlin për rënien e vlerave të CSU në Bavari. Në radhë të parë drejton gishtin drejt ministrit të Brendshëm, Horst Seehofer, që ishte edhe paraardhësi i tij në Bavari dhe ende është kryetar i CSU. Por edhe Söder ka bërë disa gabime strategjike. Tema kryesore e tij në fushatë ishte politika e migrimit në vend. Söder në fushatë shumë shpejt është armiqësuar me partinë djathiste populiste Alternativa për Gjermani (AfD), e cila vërtet ka arritur të përvetësojë shumë votues të mëparshëm të CSU-së.

Migrimin në Gjermani e ka quajtur "Asyltourimus", (Azil-turizëm), dhe me këtë meritoi nga gazeta New York Times titullin "Donald Trumpi i Gjermanisë". Por duket se zgjedhësit nuk ishin tepër të kënaqur me retorikën e tij radikale. Ai nuk arriti me këtë retorikë të stopojë as ngritjen e AfD në Bavari. Söder ka kërkuar edhe vendosjen e domosdoshme të kryqit në institucionet e vendit. Kjo nuk është mirëpritur fare nga shumë zgjedhës, por as nga përfaqësuesit e kishës. Javët e fundit toni i Söderit ishte më i butë, sulmet ndaj kundërshtarëve më të qeta. Ndërsa për qeverisjen në kohën e tij tha se Bavaria është "shndërruar në një vend përrallor". Markus Söder ka lindur në "këtë vend përrallor", më saktësisht në Nyremberg, me 5.1.1967. Fëmijë i një familjeje modeste ai e ka përfunduar gjimnazin me nota të shkëlqyeshme. Söder ka studiuar shkencat juridike dhe ka doktoruar. Më pas ka punuar si gazetar në TV. Idoli i tij politik që në rini ishte: Franz Josef Strauß, kryeministër dhe njeriu më i rëndësishëm i Bavarisë në vitet 80-të. Söder është i martuar dhe ka katër fëmijë. Në vitin 1994 ai është futur në parlamentin bavarez, ku është emëruar në disa poste ministrore. Me 16 mars 2018 mori postin e kryeministrit ë Bavarisë.

AMBICIET

Por këtë post ende nuk e ka mësuar sa duhet. Do të zgjatë edhe ca kohë deri sa të shndërrohet nga një figurë përçarëse në udhëheqës të landit dhe të bëhet një kryeministër i të gjithëve. Söder është i afërt me popullin, por ai nuk duket i natyrshëm. Ndër 16 kryeministrat e landeve në Gjermani, ai është më i padashuri, thuhet në sondazhet e fundit. Gjatë fushatës së fundit ka rënë në sy për taktizime të shumta. Ky imazh e ka dëmtuar Söderin por edhe partinë e tij CSU. Megjithatë askush në këtë moment nuk e beson se Markus Söder mund të heqë dorë nga kandidatura e serishme për postin e kryeministrit të Bavarisë. Pavarësisht rezultateve.

Khashoggi, Erdogani bisedë telefonike me mbretin saudit

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan dhe mbreti i Arabisë Saudite, Selman Bin Abdulaziz kanë zhvilluar një bisedë telefonike transmeton Anadolu Agency (AA). Sipas informacioneve të marra nga burimet e Presidencës së Turqisë, Erdogan dhe Selman në bisedën telefonike kanë diskutuar për zbardhjen e çështjes së gazetarit saudit, Jamal Khashoggi. Ndërkohë mësohet se presidenti Erdogan dhe mbreti Selman kanë vënë theksin në rëndësinë e formimit të grupit të përbashkët të punës në kuadër të hetimit për ngjarjen. Ndërkohë, ekipe të shumta gazetarësh vazhdojnë të qëndrojnë para Konsullatës së Arabisë Saudite në Stamboll, në pritje të ndonjë informacioni për fatin e gazetarit Jamal Khashoggi, i cili që nga data 2 tetor, atëherë kur hyri në konsullatë, llogaritet një person i zhdukur. Ekipet mediatike që mëngjesin e së shtunës janë vendosur para konsullatës, e cila ndodhet në një mbikëqyrje maksimale policore. Gazetari dhe kolumnisti i gazetës "The Washington Post", Khashoggi, u zhduk më 2 tetor, pasi kishte hyrë në kompleksin e Konsullatës së Arabisë Saudite në Stamboll. Ai ishte i njohur si kritikues i politikave që udhëheq qeveria aktuale saudite.

Holanda në "luftë kibernetike" me Rusinë

Ministrja e Mbrojtjes, Ank Bijleveld njoftoi se Holanda është në një "luftë kibernetike" me Rusinë, pasi parandaloi në muajin prill një sulm kibernetik rus, raportoi radio televizioni holandez NPO. Shërbimet sekrete holandeze njoftuan në fillim të tetorit se kanë dëbuar katër agjentë rusë, të cilët po planifikonin një sulm kibernetik që kishte si objektiv "Organizatën për Ndalimin e Armëve Kimike" (OPCW), me seli në Hagë, përcjell ata. Agjentët rusë kishin vendosur një makinë të mbushur me pajisje elektronike në parkingun e një hoteli pranë selisë së OPCW-së në përpjekje për të hakeruar sistemin kompjuterik, sipas autoriteteve holandeze.

Edhe qentë kundër Brexitit

Rreth 1 mijë qenë dhe pronarët e tyre kanë marshuar këtë javë rreth parlamentit britanik duke kërkuar fundin e Brexitit nëpërmes një referendumi të dytë lidhur me kushtet e daljes së shtetit nga bloku Evropian. Organizatorët e fushatës Wooferendum argumentonin se edhe kafshët do të vuanin nëse Britania largohet nga BE-ja nga se do të ketë mungesë të veterinerëve dhe rritje të çmimit të ushqimit për kafshë.

Largimi potencial i pasaportës për kafshë, po ashtu është temë e ndjeshme. "Unë e kam themeluar Wooferendumin para një viti sepse ishte shumë e qartë se shumë njerëz ishin të pakënaqur me Brexitin dhe ishte temë e rëndë për shumë më. Është subjekt i zbrazët, përçarës dhe nuk do të ju bëjë të popullarizuar nëse në pub filloni të flisni për Brexitin" deklaroi Daniel Elkan themelues i organizatës.

E në mesin e qeneve që dolën për të protestuar më së shumti kishte bulldog. Por qenë të shumtë të tjerë kishin pllakate që bartnin në protestë në të cilat shkruante i tmerruar nga Brexiti apo unë nuk jam salsiçe që leh. Ky marsh i qeneve me pronarë ndryshe ishte përkrahje e fushatës Vota e Popullit për Brexit e që angazhohet që britanikët të votojnë për çfarëdo marrëveshje që kryeministrja arrin me Brukselin. Deputetja britanike Stella Creasy dhe ish-këshilltari i ish-kryeministrit Tony Blair, Alastair Campbell po ashtu ishin pjesë e këtij marshi .

Të pastrehëve nuk mund të flenë në hapësira publike!

Një ligj që i ndalon personat të cilët nuk kanë një banesë fikse të flenë në hapësirat publike në Hungari, u miratua nga qeveria e kryeministrit hungarez, Viktor Orban dhe pritet të hyjë në fuqi të hënën, një masë e cilësuar "mizore" nga një raportuese OKB-së për strehimin. Një amendament kushtetues i miratuar nga parlamenti hungarez më 20 qershor ndalon "qëndrimin e vazhdueshëm në një hapësirë publike", përcjell ata. Ky amendament e forcon një ligj të vitit 2013 që e bën atë një vepër penale të dënueshme me gjobë. Policia është autorizuar tashmë për të larguar të pastrehët dhe për të prishur kasollet dhe ambientet e improvizuara për strehim.

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, neni 22 paragrafi 1 i Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 167 / 2015-tekst i rishikuar) dhe neni 142 paragrafi 1 i Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (Gazeta Zyrtare të RM nr.23 / 2013), Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të IPKÇF "Nasha Idnina " Prilep, publikon:

NJOFTIM PUBLIK
për punësim të papërcaktuar

Logoped i diplomuar
një (1) person për një periudhë të pacaktuar kohe
Kushtet e nevojshme të veçanta
Logoped i diplomuar – me pike të fituar 180 kredi sipas ECTS ose të ketë përfunduar shkallën VI / 1 – përgatitje profesionale – logopedi e përgjithshme
- pa përvojë pune
- një licencë të vlefshme për bashkëpunëtor profesional.

Orari i punës është 40 orë në javë. të cilat vendosen në 30 orë për punë me fëmijët dhe pjesa tjetër e kohës për aktivitete të tjera, nga e hëna deri të premten; Shpërndarja e orëve të punës përcaktohet në bazë të orarit të punës nga 6:30 në 12:30
Paga neto bazë është 18.841,00 denarë

Edukator i fëmijëve të moshës nga 2-6 vjeç – një person (1) për një kohë të pacaktuar

- Kërkohen kushte të veçanta

Profesor i diplomuar me shkollë të lartë/ fakultet, profesor i arsimit parashkollor, edukatori diplomuar për fëmijët e moshës parashkollore dhe një mësues i diplomuar për arsimin parashkollor - me pike të fituara 240 kredi sipas SETK ose diplomë universitare me shkallë VII / 1 ose të ketë përfunduar një arsim përkatës të lartë për edukator
- pa përvojë pune
- një licencë të vlefshme për edukator

Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat janë rregulluar për 30 orë për punë me fëmijët dhe pjesa tjetër e kohës për aktivitete të tjera, nga e hëna deri të premten; Orari i shpërndarjes së orëve të punës përcaktohet me orar në orët e punës nga ora 6:30 deri në orën 12:30.

Paga neto bazë 20.524,00 denarë për formim profesional të lartë ose 19.286,00
për arsimin e lartë.

-Kujdestar -katër (4) persona për një periudhë të pacaktuar kohe
- Kërkohen kushte të veçanta
- PMP - arsim i mesëm katërvjeçar
- pa përvojë pune
- një licencë të vlefshme për kujdestari
Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat ndahen në 35 orë për të punuar me fëmijët dhe pjesa tjetër e kohës për aktivitete të tjera nga e hëna deri të premten; shpërndarja e orarit të punës përcaktohet me orar 9: 30-16: 30.
Paga neto bazë është 15.477,00 denarë.
Përveç kushteve të posaçme të deklaruara, kandidatët duhet gjithashtu të plotësojnë kërkesat e përgjithshme ligjore.
Me aplikacion kandidatët duhet të dorëzojnë:
- Diplomë (Certifikatë), Certifikata e përfundimit të arsimit të përshtatshëm (origjinal ose transkript e vërtetuar);
- Certifikata e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Certifikata e lindjes
- vërtetim që nuk është shqiptuar dënim ose kundërvajtje për ndalimin e kryerjes së një profesioni, veprimtarie ose detyre.
- Vërtetim që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë me dënim për një krim të dhunës në familje, heqjes së një të mituri, moskujdes apo abuzimi i një të mituri apo të ngjashëm, për çështje penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore.

Shpallja zgjat pesë (5) ditë pune nga data e publikimit të saj.
Zgjedhja bëhet brenda dyzet e pesë (45) ditësh pas skadimit të afatit të aplikimit.
Dokumentacioni i plotë duhet të dorëzohet në adresën: IPKÇF "Nasha Idnina " Prilep, rr. "Beidimazh" p.n - Prilep
Dokumentet jo të plota nuk do të merren parasysh.

IPKÇF "Nasha Idnina "
PRILEP

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 217/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institucionin publik komunal Shtëpinë e Kulturës Brand Petrushev Bogdanc "për vendet e punës në vijim:

1. KUL0102V03001 Bashkëpunëtor për punë administrative, të përgjithshme dhe juridike — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike ose ekonomike
- së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 22.501,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.
Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.
Derisa nuk do të paraqiten kandidat me arsimin adekuat, do të pranohen edhe kandidat me arsimim jo adekuat.
VËRREJTJE:Vendi I punës plotësohet me **afat të caktuar** deri më 31.08.2019 vit, gjegjësisht deri në kthimin e punëtorit (Drejtorit) në vendin e punës si Arsimtarë I Matematikës.
Dokumentet të dërgohen në adresën: **Sh.f.k "Luigj Gurakuqi" Zhelinë-Zhelinë.**
Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatit të shpalljes nuk do të shqyrtohen.
Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune.

15.10.2018 vit **DREJTORI**
Zhelinë
_____
/ Ruhi Demiri /

Në bazë nenit 22, paragrafi 1, pika nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/2005-27/2016) dhe Pajtimi i fituar nga Ministria e arsimit dhe shkencës nr. 12-1041/1 nga 29.01.2018, Shkolla e mesme e mjekësisë së Qytetit të Shkupit Dr. Pançe Karagjozov.

Publikon
SHPALLJE
për plotësimin e vendeve të punës në afat të pacaktuar

Publikohet shpallje për plotësimin e këtyre vendeve të punës:
1. Hausmajstor, shifra e vendit të punës OBN 04 01 A01 005, mbarim i shkollës së mesme profesionale-elektroteknik, për afat të pacaktuar
2. Mirëmbajtës I higjienës për vendin e punës OBN 04 01 A01 001, mbarimi i shkollës fillor/mesme për afat të pacaktuar.

Orari i punës është 40 orë në javë. Orari i punës ditor është I organizuar në ndërrime dhe atë ndërrimi I parë nga ora 6.00 deri në ora 14.00 dhe ndërrimi i dytë nga ora 13.00 e deri në ora 21.00.
Rroga bazë për vendin e punës hausmajstor është 16.240 denarë, ndërsa rroga bazë për vendin e punës mirëmbajtës I higjienës është 12.600 denarë.
Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat prej 15 ditëve pas përfundimit të paraqitjeve
Dokumentet e nevojshme:
1. Fletëparaqitje-Lutje
2. Diplomë- Dëftesë për mbarimin e shkollimit
Dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohet përmes postës në rr. 50 Divizion 2 A Shkup apo në arkivin e shkollës. Tel. për kontakt 02 3120-187

SHMPQSH Dr. Pançe Karagjozov



Tumori i prostatës, 7 sinjale që duhet t'iu alarmojnë

Tumori i prostatës është shumë i rrezikshëm, pasi përparon në mënyrë të ngadaltë, pa dhënë asnjë shenjë dhe pa shfaqur çrregullime të veçanta. Rreziku është i heshtur, madje shkon deri në atë pikë sa mund ta bëjë të pamundur ndërhyrjen.
Sipas shoqatës italiane për luftën kundër tumoreve (LILT) janë 7 sinjale që mund ta sinjalizojnë. Por duhet sqaruar se secili prej tyre jo domosdoshmërisht mund të jetë i lidhur me një tumir në prostatë, pasi mund të ketë të bëjë me patologji në zhvillim. Në çdo rast nëse hasni në simptomat e mëposhtme, është mirë të flisni me mjekun:
- Vështirësi për të nisur urinimin
- Nevojë e shpeshtë për urinim
- Ndjesi sikur nuk urinohet në mënyrë totale
- Gjak në urinim apo në sekrecione
- Ndjesi peshe në zonën e fshikëzës
- Dhimbje në kocka
- Vështirësi gjatë ereksionit
Profesor Mauri Dimitri, kirurg urolog dhe president i World Foundation of Urology, thotë se, "Në ditët e sotme mundësia e mbijetesës nga tumori i prostatës është 60%. por sa më parë të diagnostikohet tumori, aq më i lehtë është trajtimi".

TRI PORCIONE NË DITË BULMET, TË NEVOJSHME

Bulmetet janë një burim i rëndësishëm energjie, por kjo nuk do të thotë që njerëzit të konsumojnë shumë racione në ditë. Sipas studiuesve kanadezë, konsumimi me masë, i produkteve të bulmetit, është gjithmonë rruga që duhet ndjekur

Konsumimi i deri tri porcioneve me prodhime bulmet në ditë mund të jetë me përfitime për shëndetin. Ky është përfundimi i një studimi të kryer në Kanada. Studiuesit thonë se ky zbulim lidhet me nivelin e sëmundjeve kardiovaskulare.

Por mjekët thonë se përfundimet e këtij studimi nuk e justifikojnë ndryshimin në masë të udhëzimeve të ushqyerjes, që këshillojnë pakësimin e bulmeteve me yndyrë të plotë. Raporti i fundit lidhur me konsumimin e produkteve të bulmetit ndoqi mënyrën e ushqyerjes së 130 mijë njerëzve në 21 vende të botës, në mbi 5 kontinente, për një periudhë 9-vjeçare. Një nga krahasimet kryesore të studimit ishte mes grupit të njerëzve që nuk konsumonin produkte bulmeti dhe atyre që konsumonin më tepër: deri në 3,2 porcione bulmeti në ditë. Doli se konsumatorët më të mëdhenj të bulmeteve ishin në Amerikën Veriore dhe në Europë, ku njerëzit konsumonin mbi katër porcione në ditë. Sipas autorëve të studimit, një porcion normal bulmeti mund të jetë një gotë qumësht prej 244 mililitrash, një gotë kosi prej 244 mililitrash dhe një copë djathi prej 15 gramësh, ose një lugë e vogël gjalpë, prej 5 gramësh. Ekipi i studiuesve të Universitetit McMaster arriti në përfundimin se grupi që konsumonte më tepër bulmet pati nivele më të ulëta të kolesterolit dhe prekej më pak nga ishemia cerebrale.

Ky grup po ashtu kishte nivelin më të ulët të vdekshmërisë. Autorja kryesore e studimit, dr. Mahshid Dehghan, nga Universiteti "McMaster" i Ontarios, thotë se ekipi i studiuesve e përqendroi studimin kryesisht te njerëzit që nuk konsumojnë bulmet në dietën e tyre të përditshme: "Historia e yndyrave të saturuara ka filluar shumë kohë më parë: përfundimi ka qenë se produktet me nivel të lartë të tyre ngrenë nivelin e kolesterolit, që shkakton arterioskleroz ën dhe kjo e fundit është përgjegjëse për sëmundjet koronare të zemrës; por studimet e mëparshme nuk merrnin në konsideratë pasojat e yndyrave të saturuara te komponentët e tjerë lipidë të gjakut, si dhe te faktorët e tjerë të rrezikut", -thotë Dehghan. Ky studim është në nivel vëzhgues, që do të thotë se studiuesit i nxorën konkluzionet të lidhura me faktorë të tjerë, pra ata nuk kanë hyrë në mekanizmat që sjellin këtë rezultat.

Sipas autorëve të Universitetit McMaster, ne harrojmë shumë nga komponentët e dobishëm që përmbajnë produktet e bulmetit. Në mesin e tyre janë aminoacidet, vitaminat K1 dhe K2, si dhe kalciumi, potasiumi dhe magnezi. "Ne vumë re se në mesin e personave që nuk konsumonin fare produkte bulmeti, rreziku i vdekshmërisë, apo i sëmundjeve kardiovaskulare, kryesisht ishemia cerebrale, vdekja nga sëmundjet kardiavaskulare dhe ato jo kardiovaskulare, është më i lartë", tha studiuesja Dehghan. Studiuesja thotë se bazuar te ky studim, njerëzit që konsumonin bylmet ishin 10 për qind më pak të rrezikuar nga shumica problemeve shëndetësore. Rreziku për ishemi cerebrale ishte 34 për qind më i vogël se te personat që nuk konsumojnë bylmet. Por ajo shtoi se pjesëmarrësit në studim nuk konsumonin më tepër se tri porcione bulmeti në ditë. Disa kritikë të studimit kanë ngritur pikëpyetje të ndryshme.

Një prej tyre është dr. Jimmy Chun Yu Loui i Universitetit të Hong Kongut. Ai argumenton se në studim janë përfshirë njerëz nga India apo Kina, që kanë patur një zhvillim të madh ekonomik në 10 vitet e fundit dhe struktura ushqimore e tyre ka ndryshuar gjatë kësaj kohe. Pra, sipas tij 9 vjet nuk janë të mjaftueshme që një studim të arrijë në konkluzione. Në kushtet kur flitet shumë për problemin e obezitetit, ky studim mund të shkaktojë konfuzion te njerëzit. Por autorët thonë se ai nuk u bën thirrje njerëzve të konsumojnë në masë produkte me sasi të lartë yndyre, si djathi dhe gjalpi. Ata thonë se bulmetet janë një burim i rëndësishëm energjie, por kjo nuk do të thotë që njerëzit të konsumojnë shumë racione në ditë. Sipas studiuesve kanadezë, konsumimi me masë, i produkteve të bulmetit, është gjithmonë rruga që duhet ndjekur.

Mos i krahasoni fëmijët me moshatarët e tyre

Prindërit kanë tendencë që zakonisht për model të marrin fëmijët e tjerë të fqinjëve apo në mesin e familjes, në rastin kur fëmija i tyre dështon në ndonjë fushë të caktuar, apo edhe sepse thjesht ata nuk janë të kënaqur me ta për çfarëdo arsye tjetër. Kjo praktikë tashmë po njihet si e keqe, e në lidhje me këtë ka folur edhe mjekja pediatër në NYU, Dr. Robin Jacobson. Sipas saj, nënat janë gjithmonë të shqetësuara për peshën e fëmijës së tyre, por ajo që duhet të kuptojnë dhe të fiksojnë mirë është që fëmijët nuk janë njëlloj.

"Burimi më i mirë për të mësuar rreth zhvillimit të fëmijës është pediatri", tha ajo. Dr. Jacobson pranoi se të gjithë prindërit shqetësohen kur shohin një fëmijë më të vogël se fëmija i tyre që flet ose ecën më mirë. Por prindërit duhet të kuptojnë që të gjithë fëmijët janë të ndryshëm.

Zakonisht, pediatrit nuk japin receta me gramë dhe as nuk thonë sa duhet të shtojë një fëmijë gjatë një muaji. Mirëpo, këtu nuk është fjala vetëm për peshën në kohën kur fëmijët janë më të vegjël. Edhe mësimi, shoqëria, aktivitetet jashtë mësimore, apo sjellja e tyre, asnjëherë nuk duhet të krahasohet me të tjerët, sepse kështu mund ta dëmtoni fëmijën tuaj, duke i mbjell atij xhelozi për të tjerët, dhe pasiguri për veten.

LIGA E KOMBEVE

MAQEDONIA PAS FITORES SË KATËRT

"Armenia është një kombëtare kualitative, ne nuk duhet të mashtrohemi nga humbja e tyre ndaj Gjibraltarit. Ai takim neve vetëm nga ka sjellë një përparësi në tabelë, por gjithsesi ndeshja e së martës do të ketë një rëndësi të madhe. Ne dëshirojmë që të vazhdojmë me rezultatet pozitive dhe në këtë përballje të futemi me seriozitet të lartë. Dua që të përsërisim ndeshjen si ndaj Lihtenshtajnit dhe mendon se do të kemi sukses", deklaroi Igor Angelovski

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 15 tetor - Reprezentacioni i Maqedonisë të martën do ta zhvillon ndeshjen e katër në kuadër të Ligës së Kombeve përballë Armenisë. Pas tre fitoreve në grup dhe thuajse të siguruar vendin e parë dëshira e përfaqësueses së Maqedonisë është që edhe ndaj Armenisë të shënon fitore. Trajneri Igor Angelovski, thekson se janë duke menduar dhe përgatitur për të zhvilluar një ndeshje të mirë që të vazhdohet me serinë e fitoreve. "Armenia është një kombëtare kualitative, ne nuk duhet të mashtrohemi nga humbja e tyre ndaj Gjibraltarit. Ai takim neve vetëm nga ka sjellë një përparësi në tabelë, por gjithsesi ndeshja e së martës do të ketë një rëndësi të madhe. Ne dëshirojmë që të vazhdojmë me rezultatet pozitive dhe në këtë përballje të futemi me seriozitet të lartë. Dua që të përsërisim ndeshjen si ndaj Lihtenshtajnit dhe mendon se do të kemi sukses. Më gëzon fakti se të gjithë futbollistë janë shëndosh dhe janë të gatshëm për lojë, dhe nesër pra të martën dua që në fushë të hedh formacionin më të mirë. Për formacioni do të vendosë pak para fillim të përballjes",deklaroi trajneri i Maqedonisë, Igor Angelovski. Nga ana tjetër kapiteni i Maqedonisë, Goran Pandev i cili është vetëm tre ndeshje afër për të barazuar me Goce Sedloskin për ndeshjet e zhvilluar me fanellën e përfaqësueses së Maqedonisë. Pandev tani më ka më shumë se 10 vite që është pjesë e reprezentacionit dhe beson se kjo Maqedoni është më e fortë në histori. "Jam krenar për arritjen time, por më shumë gëzohem se kemi arritur të ndërtojmë një përfaqësuese të fortë, ku lirisht mund të them se më të fortën në histori, e udhëheq nga seleksionuesi më i mirë. Kemi arritur që të marrim tri fitore po në aq ndeshje. Kemi ardhur ne Erevan për të fituar dhe për të vazhduar me serinë e fitoreve. Armenët kanë një formacion kualitative, në Shkup arritëm që të marrim fitore të merituar, ndërsa neve do të mundohemi që ta përsërisim atë ndeshje dhe të marrim fitoren e radhës", theksoi Goran Pandev. Pas një pauze të shkurtër për shkak të transferimit të tij në kampionatin arab, Ferhan Hasani përsëri iu është bashkuar reprezentacionit të Maqedonisë dhe pret që në ndeshjen ndaj Armenisë të arrihet fitorja e radhës. "Atmosfera në reprezentacion është shumë e mirë. Neve tani duam që të sigurojmë vendin e parë, dhe këtu në Erevan nuk kemi ardhur vetëm për një pikë, por mendojmë vetëm për tre pikët. Jam i lumtur që përsëri jam pjese e ekipit. Pres që të zhvillojmë një ndeshje kualitative ndaj Armenisë dhe të vazhdojmë me serinë e fitoreve dhe pse Armenia është një përfaqësuese me kualitet të lartë", theksoi Ferhan Hasani. Takimi mes Maqedonisë dhe Armenisë do të zhvillohet të martën në Erevan të Armenisë, me fillim prej ora 18:00.

Challandes: I kënaqur me paraqitjen, por jo me rezultatin

Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës, Bernard Challandes, ka folur pas barazimit 1-1 si mysafir të Ishujt Faroe në kuadër të Ligës së Kombeve. Zvicerani ka thënë së është i kënaqur me paraqitjen e lojtarëve të tij, por tha se duhet të ishim më konkret në fazën sulmuese. "Jam i kënaqur me paraqitjen, por jo me rezultatin. Skuadra ka luajtur mirë në pjesë e parë, nuk ishte e lehtë pasi Ishujt Faroe janë skuadër e fortë.

Lojtarët tonë u paraqiten mirë, i uroj Ishujt Faroe për pikën". "Edhe në pjesën e dytë luajtëm mirë, por në 20 minutat e fundit kishim disa probleme. Na mungoi efikasiteti, por ne duhet të vazhdojmë me punën dhe të besojmë". "Kishim posedimin e topit, por në 20 metrat e fundit duhet të ishim më konkretë. Tani synimi jonë është të fitojmë në Maltë", ka thënë Challandes pas ndeshjes. Pas këtij barazimi Kosova vazhdon e para në Grupin 3 me tetë pikë, dy më shumë se Azerbajxhani. Ishujt Faroe vazhdojnë me katër pikë, kurse Malta me dy. Ndeshja e ardhshme e Kosovës është si mysafir i Maltës.

BASKETBOLL

Alaudin Musatafa afrimi më i ri i KB Shkupit

Shkup, 15 tetor - Basketbollisti shkupjan, Alaudin Mustafa pas përfundimit të kontratës së tij dyvjeçare me ekipin e kampionatit turk Trakya, ka vendosur që karrierën e tij basketbollistike ta vazhdon në Superligën e Maqedonisë, te ekipi ku nisi hapat e para si basketbollistë KB Shkupi. Musatafa me ekipin e KB Shkupit ka nënshkruat kontratë për një vit me mundësinë për ta vazhduar atë, ndërsa deri tani ka zhvilluar edhe një takim me ekipin e ri në humbjen ndaj MZT. Mustafa në këtë përballje ka luajtur afër 28 minuta ndërsa ka arritur të shënon 10 pikë. "Te Shkupi erdha si lojtarë i lirë, edhe pse në adresën time kishte shumë oferta nga klube të ndryshme, mirëpo vendosa që në fund të bashkëngjitëm me klubin ku jam rrit si basketbollistë. Duke patur parasysh se KB Shkupi kishte mungesë të lojtarëve e pashë të arsyeshme që të bashkëngjitëm me ta, për ti ndihmuar në realizimin e planeve që kemi. Po ashtu mendoj se ardhja ime në klub sadopak e ngrit moralin e lojtarëve, trajnerëve si dhe publikut të mrekullueshëm "Shvercarat". Nuk dua që prej tani të premtoj ndonjë sukses me ekipin, por do të punojmë me vullnet dhe të japim maksimum në stërvitje që të jemi të përgatitur sa më mirë për ndeshje", deklaroi basketbollisti më i ri i KB Shkupit, Alaudin Musafa. *(F.N)*

E dija që do ta kem më të vështirë në Liverpool

Mesfushori me origjinë shqiptare i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, ka thënë se ai e dinte se do e kishte më të vështirë ta dëshmonte veten në një skuadër të nivelit të Liverpoolit në krahasim me ish-klubin e tij, Stoke Cityn. Shaqiri u transferua gjatë afatit kalimtar të verës në Liverpool nga Stoke City për 13.5 milionë euro. Ai kishte shpenzuar tre sezone me Stoke Cityn, megjithatë vendosi të largohej kur ata ranë nga Premierliga në Championship, niveli i dytë i futbollit në Angli. Shaqiri nënshkroi kontratë pesëvjeçare me Liverpoolin në korrik të këtij viti, megjithatë ai ende nuk ka arritur ta lë shenjën e tij në këtë klub, pasi që i ka bërë vetëm gjashtë paraqitje në të gjitha garat këtë sezon, duke startuar në vetëm dy prej tyre. Për dallim, në Stoke City, Shaqiri ishte lojtari më i rëndësishëm i skuadrës dhe ai ishte në formacionin e parë në çdo xhiro. Ndërsa, në Anfield deri më tani e ka pasur më të vështirë ta dëshmojë talentin e tij. "Ata nuk kanë nevojë të më mbajnë mua të lumtur. Ky proces ka shkuar mirë deri tani për mua. Natyrisht, çdo profesionist dëshiron të luajë sa më shumë, por ka ende shumë ndeshje në këtë sezon", ka thënë Shaqiri. "Përpos kësaj, ne duhet ta shikojmë dhe ta vlerësojë atë që ka arritur ta bëjë deri më tani Liverpooli. Shumë futbollistë kanë bërë punë shumë të mirë. Për këtë arsye, skuadra nuk është ndryshuar plotësisht brenda

natës. Ajo që po ndodhë në Liverpool është pikërisht ajo që prisja të ndodhte. Unë vendosa të transferohesha në Liverpoolin i vetëdijshëm se do e kishte më të vështirë në një klub të këtij niveli sesa në disa klube të tjera, të cilët më bënin oferta", ka deklaruar Shaqiri.

FORMA E MIRË E SUSOS, FALË GATTUSOS

Sulmuesi anësor i Milanit, Suso, ia ka dhënë meritat trajnerit të tij Gennaro Gattuso për formën e tij të mirë së fundmi. 24-vjeçari realizoi dy asistime në fitoren 4:1 kundër Uellsit në javën e kaluar, ndërsa gjithashtu ka realizuar 2 gola dhe 6 asistime me fanellën e gjigandi italian gjatë këtij edicioni. "Njerëzit të cilët më njohin e dinë se çfarë mund të bëj unë. Ata i dinë fuqitë dhe dobësitë e mia", ka deklaruar Suso për të përditshmen spanjolle "Marca". Ndeshja ndaj Uellsit në Kardif ishte vetëm paraqitja e dytë e plotë për Spanjën, 12 muaj pas debutimit të tij nën urdhrat e ish-trajnerit Julen Lopetegui. "Të qenit në ekipin kombëtar është një ëndërr, Spanja është njëra prej ekipeve më të mira në botë dhe është një nder i madh për mua. Nuk ka diferenca të mëdha mes (trajnerit të Spanjës) Luis Enrique dhe (trajnerit të Milanit) Gattuso. Ata të dy kanë ide të veçanta dhe iu pëlqen që të sulmojnë me anësorë", shprehet reprezentuesi spanjoll. Pasi që kishte dështuar te Liverpoolit, Suso ishte paska filozofik për rrugëtimin e karrierës së tij. "Ju mësoni çdokund, aty ka një kulturë të madhe të futbollit dhe pavarësisht se nuk mu mundësua të luaja shumë, më ndihmoi që të piqesha më shpejt", thotë ai. Suso kishte bërë vetëm 14 paraqitje për gjigandin anglez para se të transferohej për 1.9 milion euro te Milani në janar të vitit 2015. "Jam spanjoll në këndvështrimin tim për futbollin, por futbolli italian është shumë taktik, shumë sfidues për lojtarët sulmues", deklaroi Suso. Forma e Susos në këtë edicion ka tejkaluar imagjinatën e tifozëve të Milanit dhe tani ai e gjen veten të rehatuar në ekipin e Gattusos. "Ai është i njëjti që ishte si lojtar, i pasionuar dhe i gjallë, por jashtë fushës është plotësisht ndryshe, ju mund të flisni me të për gjithçka. Ai është njëshi", përfundoi 24-vjeçari

Federer qetëson fansat: Do të luaj edhe vitin e ardhshëm

Roger Federer, pas eliminimit në gjysmëfinalen e turneut Masters të Shangait, ka humbur vendin e dytë të renditjes botërore, duke ia lëshuar atë Novak Djokovic, fitues në Kinë. Por tenisti zviceran nuk ka humbur dëshirën për të vazhduar të luajë sportin e tij të zemrës dhe pas rikthimit në vendlindje, ai ka deklaruar se do të vazhdojë të zbresë në fushë edhe gjatë vitit 2019. "Një gjë është e sigurtë, do të jem në fushë edhe sezonin tjetër. Unë ende nuk kam një plan të detajuar për 2019-ën, por shpresoj të luaj sa më shumë të jetë e mundur. Në dilemë jam për turnetë në fushat me dhè. E rëndësishme është të jem mirë fizikisht dhe të luaj mirë në çdo ndeshje, për të arritur objektivin, fitoren", u shpreh Federer, që përgatitet për turnetë europianë.

Barça "kërcënon" Interin

Në një intervistë të dhënë për "RMC Sport" me rastin e Festivalit të Sportit që u zhvillua në Trento, përgjegjësi i marrëdhënieve institucionale dhe sportive i Barcelona-s, Guillermo Amor, ka folur për sfidën e ardhshme të Champions League që do të luhet mes katalanasve dhe Interit. "Shpresojmë që Inter të gjejë një ambient të vështirë në Camp Nou. Kemi fituar ndeshjen e parë kundër PSV-së në shtëpi dhe atë kundër Tottenham në transfertë. Duam të dominojmë dhe të fitojmë edhe ndaj zikaltërve. Një ekip i madh si Inter mund të jetë gjithmonë i rrezikshëm, por do ta respektojmë dhe do të kërkojmë të marrim rezultatin më të mirë të mundshme", ka thënë Amor. Më pas ai ka folur edhe për kapitenin e milanezëve, Mauro Icardi: "Nuk besoj se do të ketë dëshirë për hakmarrje ndaj nesh. Sipas mendimit tim, ai ka një kujtim të mirë nga Barcelona. Mund të ndodhë që të largohesh dhe të kesh sukses diku tjetër, nuk besoj se ka arsye për të kërkuar hakmarrje. Thjesht do të dojë të tregojë se është një futbollist i mirë dhe të ndihmojë Interin të ketë sukses", ka përfunduar Amor.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009 130/2009 120/2011, 10/2012, 11/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), J.O.U.D.G "Avionçe " – Komuna Petrovec publikon

SHPALLJE

Për punësimin në Entin komunal publik për fëmijë Kopshti i fëmijëve "Avionçe "-Komuna Petrovec

1. Shpallja përfshin punësimin e tre personave në kohë të pacaktuar dhe 1(një) personi në kohë të caktuar dhe atë në vendet e punës si vijon :
1.1. Numri rendor 1- vendi i punës – Edukator , me shifrën e vendit të punës DEZ 03 03 B01 001 në kohë të caktuar deri më 31.12.2018 - 1(një)realizues
1.2. Numri rendor 2- vendi i punës – Edukator , me shifrën në vendin e punës DEZ 03 B01 001 në kohë të pacaktuar - 1(një) realizues
1.3. Numri rendor 3- vendi i punës –Përkëdhelës , me shifrën në vendin e punës DEZ 03 03 G01 001 në kohë të pacaktuar - 1(një) realizues
1.4. Numri rendor 4- vendi I punës – Ndihmës kuzhinier , me shifrën DEZ 04 04 A03 001 në kohë të pacaktuar - 1(një) realizues
2. Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parashikuara me Ligjin për marrëdhënie pune (të jetë shtetas i RM , të jetë i rritur dhe të mos ketë ndalim të plotëfuqishëm për kryerjen e profesionit , veprimtarisë apo detyrës , vërtetimit të mjekut) duhet ti plotësojë edhe kushtet e tjera të veçanta të nevojshme për realizimin e detyrave :
2.1. –për vendin e punës –Edukator :
- Të ketë të kryer arsim të lartë – profesor i diplomuar i arsimit parashkollor , edukator i diplomuar i fëmijëve të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për arsim parashkollor – me 240 kredi të fituara sipas EKTS ,ose me arsim të përfunduar të lartë shkalla VII/1 ;
- Licencë valide për edukator ;
- Njohjen e punës me kompjuter (internet , MS Office);
- Njohjen e gjuhës angleze ;
- Me ose pa përvojë pune .

2.2. –për vendin e punës – Edukator :
- Të ketë të përfunduar arsimin e mesëm katërvjeçar ;
- Licencë valide për edukator ;
- Me ose pa përvojë pune

2.3. –për vendin e punës – ndihmës kuzhinier :
- Të ketë të përfunduar arsimin e mesëm – shkalla e III ose e IV ,
- Me ose pa përvojë pune

Krahas paraqitjes , ku në mënyrë obligative duhet të theksohet numri rendor për vendin e punës për të cilin aplikohet , krahas biografisë së shkurtër – CV, kandidatët janë të obliguar të dorëzojnë edhe dëshmitë përkatëse në origjinal apo kopjet e noterizuara , në aspektin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta dhe atë :
- Diplomë për shkallën e përfunduar të arsimit që kërkohet për atë vend pune ;
- Vërtetim për përvojën e punës (nëse e posedon);
- Vërtetim për shkathtësitë e kompjuterit (Internet , MS OffiCe)-vetëm për vendin e punës nën numrin rendor 1.1. dhe 1.2.;
- Vërtetim për njohjen gjuhës angleze –vetëm për vendin e punës nën numrin rendor 1.1. dhe 1.2.
- Vërtetim për nënshtetësi ;
- Vërtetim se nuk ka ndalim të plotfuqishëm për kryerjen e profesionit , veprimtarisë apo detyrës
- Vërtetim mjekësor se personi është I shëndoshë në aspektin psikofizik
- Vërtetim se nuk I është shqiptuar dënim I plotfuqishëm gjyqësor me të cilin është dënuar për veprën penale e dhunës familjare , marrjen e personit të mitur , pakujdesin apo abuzimin me person të mitur ose incest , apo vepër penale e grupit kundër lirisë së gjinive , përkundër sanskionit të shqiptuar dhe tek i cili në bazë të ligjit është përcaktuar sjellje diskriminuese
- Të dhënat për kontakt

Afati për dorëzimin e dokumenteve është 5 ditë puna nga dita e publikimit të shpalljes
Orari i punës së :
- Orari i punës së edukatorit në vendin e punës është 40 orë në javë (e hënë - e premte), ndërsa orari I punës ditore është 8 orë dhe shkon nga ora 07:00 deri në ora 16:00;
- Orari i punës së edukatorit në vendin e punës është 40 orë në javë (e hëna - e premte), ndërsa orari i punës ditore është 8 orë dhe shkon në mes 06.00-18.00.
- Orari i punës së kuzhinierit ndihmës është 40 orë në javë (e hënë-e premte) , ndërsa orari i punës është 8 orë në ditë.
Paga neto bazë për vendin e punës :
Edukator është 20.401,00 denarë, edukatorët kanë 15.477,00 denarë, kuzhinieri ndihmës ka 12.496,00 denarë
Dokumentacioni i parakohshëm, jo i plotë dhe i çrregullt nuk do të merret parasysh.
Kërkesa me dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohet në:
JU.U.D.G. "Avionçe" – Komuna Petrovec rr.1 nr. 17 n.m. Petrovec - Komuna e Petrovecit.

J.O.U.D.G "Авионçe"
Komuna Petrovec

Në pajtim me nenin 9 alineja (1), (2), (3) dhe (5) nga Statuti ESH Qendra për kulturë "Grigor Prliçev" – Ohër (nr. 01-396/1) dhe Rregullores se për mënyrën e implementimit të konkursit (nr. 01-576/1) shpalle:

KONKURS
PËER ZGJIDHJEN E POEMËS
"GRIGOR PRLIÇEV" PËR VITIN 2018

Konkursi për zgjidhjen e poemës adekuate zgjatë deri më 16 nëntor të vitit 2018 Përmbajtja tematike e poemës që do të konkurrohet është me karakter të lirë, poema nuk guxon të jetë më e vogël se 912 vargje deh çdo i pesëdhjeti varg të jetë i numëruar. Vepra duhet të jetë e shkruar me font të madhësisë minimum 11 (njëmbëdhjetë), i shtypur në njërën faqe të formatit A4 në 4 (katër) ekzemplarë me shifra të njëjtë. Në konkurs një autor mund të paraqes vetëm një vepër, vepra ko autoriale nuk pranohen. Konkursi është anonim, ndërsa për poemën më të mirë parashihet dhe shpërblim në të holla.

Për zgjidhjen apo shpërblimin vendosë 3 (tri) anëtarët e jurisë e emëruar nga autorë të njohur nga RM. Ju bëjmë thirrje të gjithë autorëve të interesuar të dorëzojnë poemën në adresën ESH Qendra për kulturë "Grigor Prliçev" – Ohër rr. "Makedonski Prosvetiteli" nr. 4, 6 000 Ohër, me shënim "Paraqitja për zgjidhjen e poemës më të mirë "Grigor Prliçev për vitin 2018". Poemat që nuk do të arrijnë në afatin e caktuar nuk do t'i plotësojnë kushtet dhe të njëjtat nuk do të merën parasysh për shpërblimin. Komisioni në pajtim me Rregulloren për kritere deh procedurës për zgjidhjen e poemës, do t'i njoftojë autorët të cilët në rregull kanë dorëzuar aplikacionit për rezultatet e përzgjedhjes.

Për informata plotësuese:
Tel. 046/ 261 - 063
E-adrea: centarzakultura_ohrid@yahoo.com

ESH Qendra për kulturë "Grigor Prliçev" –Ohër,
Drejtor ,
u.d. Strezo Stamatoski

Në bazë të nenit 17 të Rregullores për organizim të ekskursioneve për nxënës dhe aktivitete tjera të lira për shkollat fillore nr. 07-9992/2 nga 05.06.2014 , drejtori SHQF "Sando Masev" Strumicë publikon:

SHPALLE PUBLIKE

Për organizmi e ekskursionit dy ditorë me nxënësit e klasë së gjashtë deh ekskursion tre ditorë me nxënësit e klasë së nëntë

Përmbajtja dhe kushtet ja të shkruara në dokumentacionin tenderik e cila mund të merret në hapësirat e shkollës fillore. Afati I fundit për dorëzimin e ofertave është 22.10.2018 deri në 12.00 .

Adresa rr."Mosha Pijade " nr.6 Strumicë ,
Kontakt tel. 034 325 532.

SHQF"Sando Masev " - Strumicë

Janë humbur diploma dhe vërtetimi i Fakultetit stomatologjik - Shkup të personit Rexhep Lusjani dhe njëkohësisht shpallen të pavlefshme.

CAPELLO: SI MUND TA HUMBASË TITULLIN JUVENTUSI, KUR NUK KA KONKURRENT?!

"Unë nuk e si Juventusi mund ta humbasë titullin. Po jep shfaqje të forta, pothuajse plot krenari, kundër të gjithë kundërshtarëve. Unë e shoh skuadrën e Allegrit ultrafavorite në Seria A dhe pa konkurrent", ka theksuar Capello

Fabio Capello promovon Roberto Mancinin. Ekipi kombëtar italian, që fitoi minimalisht mbrëmë kundër Polonisë, ishte shumë i pëlqyer nga Don Fabio. "Kombëtarja luajti një lojë të mirë. Kam parë tashmë diçka të mirë në këtë ndeshje. Lojtarët u shprehën në mënyrën më të mirë. Pashë energji dhe ekuilibër në të gjithë ekipin. Ndoshta në repartin ku kemi diçka që mungon, mund të kërkojmë një shtytje shtesë", ka deklaruar Capello. Për Fabio Capellon, "zgjedhjet e Mancinit kanë sjellë fryte": "Trajneri e di se lojtarët përpiqen të bëjnë një lojë të bazuar në atë që kanë mundësi. Dje vendosi të mos përdorë Immobile, por unë nuk do ta argumentoj këtë zgjedhje. Immobile është ai që mund të luajë nga fillimi, por natën e kaluar zgjedhja e Mancinit ishte fituese". Capellos i ka pëlqyer Barella, për të cilin sheh një të ardhme të ndritur me blutë: "Ai është lojtari, që i jep ndryshim ritmit në mesfushë. Barrela jep diçka më shumë në aspektin e cilësisë dhe sasisë. Një lojtar si ai na ka munguar. Është pak a shumë si Tardelli në nivelin dinamik. Futbolli italian tani është orientuar drejt posedimit të topit, ADN-ja e të gjithëve është atje. Kjo skuadër është teknikisht shumë e mirë, por le të mos harrojmë se Polonia dukej pak e lodhur. Mesfusha është motori i ekipit dhe çdo gjë sillet rreth saj. Kjo fitore na bën të ndihemi më konkurrues". Ish-trajneri i Rusisë (dhe shumë skuadrave të tjera, përfshirë Real Madridin) ka shpërndarë disa "vota" për axurrët: "Lasagna është një lojtar interesant, ai mund të jap diçka më shumë për ekipin kombëtar. Pati një aktivizim të shkurtër, çka është shumë pak për të dhënë një vlerësim të plotë. Cutrone? Më pëlqen, është lojtar dinamik. Me të, Italia mund të ketë prirje për të kërkuar më shumë në frontin e shënimit të golave". Trajneri i njohur italian ka folur edhe mbi situatën në Seria A dhe favoritët për titullin: "Unë nuk e si Juventusi mund ta humbasë titullin. Po jep shfaqje të forta, pothuajse plot krenari, kundër të gjithë kundërshtarëve. Unë e shoh skuadrën e Allegrit ultrafavorite në Seria A dhe pa konkurrent", ka theksuar Capello.

Guardiola: Messi apo Ronaldo? Epoka e të dyve është fenomenale

Trajneri i Manchester City, Pep Guardiola, beson se bota e futbollit po përjeton një epokë "dy fenomenësh", të Lionel Messit dhe Cristiano Ronaldos. Gjatë 10 viteve të fundit, argjentinasi dhe portugezi kanë dominuar skenën ndërkombëtare, madje ata janë ende shumë të fortë, pavarësisht se i kanë kaluar të tridhjetat. Çdo çmim i "Topit të Artë", që kur Kaka e fitoi atë në vitin 2007, është marrë në shtëpi nga Ronaldo dhe Messi. Të dy janë të lidhur me nga pesë tofe të tillë individualë, secili. Guardiola e di mjaft mirë se çfarë është Messi, që nga koha kur ishte trajner i tij në Barcelonë. Gjithashtu, trajneri katalanas shton se edhe ylli i Juventusit, Ronaldo, është një prerje mbi gjithë të tjerët. "Leo është një "kafshë" konkurruese dhe e egër, – u tha Pep gazetarëve në "Festival dello Sport". – Kjo i ndihmon të tjerët të jenë konkurrues. Ai e urren humbjen dhe luan me të njëjtën dëshirë sikur ishte fëmijë. Në ndeshjet e mëdha, nëse ekipi e ndihmon, Messi bën dallimin. Së bashku me Cristiano Ronaldon na kanë bërë të jetojmë (dhe po e jetojmë) një epokë të dy fenomenëve. Ata kanë kaluar 10 vite duke shënuar nga 50 gola secili në sezon. Kjo është e pabesueshme. Nuk ndodh një vit, por rregullisht vit pas viti, gjithnjë e më shumë", ka deklaruar Guardiola.

Arrivabene: Vettel kampion me Ferrarin është thjesht çështje kohe

Drejtori sportiv i Ferrarit, Maurizo Arrivabene, pranon se Sebastian Vettel nuk ka shumë shanse që të shpallet kampion në Formula 1 këtë sezon, por ai premton se shumë shpejt kjo gjë do të ndodhë. "Këtë vit titulli është bërë një "mision i pamundur", pasi Hamilton ka një avantazh të madh. Por unë jam i sigurt se herët a vonë, Sebastian do të shpallet kampion me Ferrarin", u shpreh Arrivabene. Duke folur për largimin e Kimi Raikkonen, shefi i "kokëkuqes" shton: "Është një profesionist dhe kemi vite që punojmë bashkë. Na pat kërkuar ta lajmërojmë kohë më përpara për të ardhmen dhe e respektuam kërkesën e tij. Ndaj në Monza komunikuam ardhjen e Leclerc, duke i dhënë mundësi një piloti të ri dhe të talentuar të rritet në krah të një kampioni si Vettel, duke e ndihmuar të shpallet kampion", ka deklaruar Arrivabene.

Giovanni Simeone: Do të ishte diçka e mrekullueshme të stërvitesha nga babai im

Sulmuesi i Fiorentinas Giovanna Simeone do të kishte shumë dëshirë të punonte me babanë Diego te Atletico Madrid. 23-vjeçari ka pranuar se do të ishte diçka e mrekullueshme të luash me skuadrën spanjolle. "Nuk kam pasur asnjëherë mundësinë të stërvitesha nga babai im. Ai nuk më ka pyetur asnjëherë por do të ishte diçka e mrekullueshme të kisha mundësinë të luaja për Atletico-n," shprehet Giovanni për Fox Sports Argentina. "Ai trajneri i Argjentinës? Ai gjithmonë thotë se nuk është momenti i duhur, por si lojtar do të kisha shumë dëshirë ta shihja të trajnonte ekipin kombëtar. "Mendoj se çdo argjentinas do të donte që ai të ishte trajneri i përfaqësueses." Giovanni ka shënuar dy gola dhe ka dhënë një asist te Fiorentina këtë sezon dhe shënoi 15 gola sezonin e kaluar.

Antidopingu "troket" në derën e Bolt, atleti: Nuk jam ende një futbollist

Usain Bolt është befasuar kur në derën e shtëpisë së tij në Sidney të Australisë, ka trokitur mëngjesin e sotëm antidopingu, me një kërkesë për të kryer një test surprizë nga ana e Federatës Australiane të Futbollit. Ish-atleti xhamajkan, që po lufton ende për të siguruar një vend dhe kontratë si futbollist profesionist në A-League të Australisë, ka mbetur i befasuar nga kjo vizitë e papritur. Përmes një postimi në rrjetet sociale, rekordmeni i botës ka shkruar se ai ende nuk është një futbollist profesionist, ndaj kjo kërkesë e antidopingut australian është e habitshme: "Siç e dini, jam tërhequr nga atletika dhe po përpiqem të bëhem një futbollist profesionist. Por shihni se çfarë më ndodh, me vjen një kërkesë për të bërë një test surprizë antidoping. Si ka mundësi, unë nuk jam ende një futbollist profesionist? E keni seriozisht...?" Bolt, rekordmen i botës në 100 e 200 metra, fitues i 8 medaljeve të arta olimpike, ka më shumë se një muaj që ka nisur të stërvitet me skuadrën australiane të Central Coast Mariners, me shpresën që të bëhet një futbollist profesionist. Në miqësoren e dytë, luajtur javën e kaluar, ai realizoi dy gola. "Pyeta vajzën që erdhi për testin antidoping se përse duhet ta kryej atë, për sa kohë ende nuk kam firmosur me asnjë ekip. Më tha se jam një sportist elitar dhe që duhet të kryej kontrollin", shkruan Bolt.

DASHI — **21. mars - 20. prill**

Edhe pse do dëshironi te kaloni me tepër kohe me partnerin, nuk do e keni këtë mundësi. Te dy do jeni shume te angazhuar dhe nuk do mundeni dot te shkëputeni. Beqaret do ndihen mjaft mire ashtu si janë dhe nuk do e kërkojnë me ngulm princin e tyre te kaltër. Ne planin financiar duhet ta verifikoni mire buxhetin para se te kryeni çdo lloj shpenzimi.

DEMI — **21. prill - 21. maj**

Pozicionimi i yjeve nuk do jete shume i mire gjate kësaj dite sa për te ndikuar pozitivisht tek jete juaj ne çift. Çdo gjë do jete si zakonisht dhe here pas here mund te keni debate te vogla. Beqaret do jene mendjemëdhenj dhe kjo do i beje te tjerët te mos ju afrohen shume. Me financat duhet me shume maturi se kurrë. Situata do jete shume delikate. Kujdes!

BINJAKET — **22. maj - 21. qershor**

Do jeni shume serioze ne jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite dhe do e hidhni çdo hap pasi ta keni menduar mire. Nuk pritet pasion i zjarrte, por as probleme. Beqaret do kenë një dite harmonike dhe plot emocione. Do ndiheni mire edhe ashtu si jeni, por as takimet nuk do mungojnë. Ne planin financiar do keni goxha vështirësi. Menaxhojini me kujdes te ardhurat.

GAFORRJA — **22. qershor - 22. korrik**

Adrenalina do shtohet gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne çift dhe emocionet do jene te papërshkrueshme. Shfrytëzojeni ditën deri ne minutën e fundit. Beqaret nuk duhet te ëndërrojnë me shume sesa duhet sepse do përballen me zhgënjime. Financat do jene te mire, por serish nuk rekomandohet te kryeni investime te pamenduara mire.

LUANI — **23. korrik - 22. gusht**

Konfigurimi i yjeve do jete pozitiv gjate kësaj dite dhe ju do jeni me te qarte për atë qe doni te bëni. Shprehjani gjithçka partnerin ne mënyre qe lidhja juaj te ece ne rrugën e duhur. Beqaret do jene me humor shume te mire dhe do tregohen me te hapur ndaj ftesave qe do ju bëhen. Ne planin financiar do e dini mire çfarë hapash te hidhni qe situata te stabilizohet.

VIRGJERESHA — **23. gusht - 23. shtator**

Dite mjaft pozitive dhe interesante kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do ndiheni për mrekulli ne krahët e partnerit tuaj dhe mund te merrni edhe vendime mbi te ardhmen. Për beqaret nuk do ketë dashuri ne këto momente. Duhet ende te bëni pak durim. Ne planin financiar mos shpenzoni kuturu sepse do keni vështirësi te mëdha me vone.

PESHORJA — **24. shtator - 23. tetor**

Dite mjaft e animuar dhe e bukur kjo për te dashuruarit. Do përjetoni emocione te shumëfishta dhe do doni qe ato momente te mos mbaronin kurrë. Beqaret nga ana tjetër do jene sharmante dhe do e kenë me te lehte për ta bere për vete personin qe pëlqejnë. Financat duhen pasur me ne vëmendje se kurrë. Po i late pas dore do keni probleme serioze.

AKREPI — **24. tetor - 22. nëntor**

Nëse jeni ne një lidhje qe prej kohesh sot do mendoni te hidhni disa hapa me tej. Do përjetoni emocione për këtë fakt dhe disa do kenë frike për gjërat qe mund te ndodhin, Relaksohuni sepse gjithçka do shkoje për mrekulli. Për beqaret nuk priten surpriza te mëdha gjate kësaj dite. Gjithçka do jete si zakonisht. Financat do jene aq te favorshme sa ju mund te kryeni investimet e menduara.

SHIGJETARI — **23. nëntor - 21. dhjetor**

Kjo sotmja do jete një nga ditët me te bukura te jetës suaj. Do kaloni momente pasionante dhe emocionuese me partnerin dhe do merrni edhe një propozim te mrekullueshëm prej tij. Beqaret gjithashtu do jene me fat ne dashuri. princi i kaltër do jete shume afër tyre. Ne planin financiar nga ana tjetër duhet te mbizotërojë vigjilenca dhe kujdesi.

BRICJAPI — **22. dhjetor - 20. janar**

Sot do i tregoni edhe njëherë partnerit tuaj sa shume e dashuroni dhe marrëdhënia me te do filloje te ngrohet akoma me tepër. Ne mesdite mund te merrni edhe një dhurate surprize prej tij. Asgjë e re nuk pritet për beqaret. Mundohuni te kaloni me tepër kohe me miqtë qe te mos mendoni për dashurinë. Ne planin financiar do e keni te nevojshme te hiqni dore nga shpenzimet e mëdha.

UJORI — **21. janar - 19. shkurt**

Dite mjaft premtuese kjo e sotmja për te dashuruarit. Do flisni hapur për gjithçka qe ju shqetëson dhe me mirëkuptim do gjeni edhe zgjidhjen e duhura. Beqaret do bëjnë për vete shume persona dhe do arrijnë me pas te zgjedhin personin e duhur. Saturni do ju ndihmoje te zgjidhni problemet financiare. Do ndiheni me te qete ne këtë sektor.

PESHQIT — **20. shkurt - 20. mars**

Me më shume komunikim dhe bashkëpunim ne jetën tuaj ne çift do mund t'i sqaroni mosmarrëveshjet dhe debatet qe keni pasur. Kjo do ju beje te ndiheni me te qete. Beqaret do mahniten nga personat qe do takojnë dhe do bëjnë gjithçka për t'i joshur. Ne planin financiar mos shpenzoni kuturu për gjera pa vlere sepse do pendoheni shpejt.

Mensur Mamuti	TEMPULL PERËNDISH TE ROMAKËT / KËNGË E KËNG. NË FOTO "... TRIBU"	P	NDAJFOLJE PYETESE	KËNGË E KËNGËTARES NË FOTO						
LLOJ PALLTOJE / KËNGËTARI ROM, SERBEZOVSKI										
A										
QYTET NË ITALI										
AKTORJA AMERIKANE, UEST			GJ / ISH DIKTATORI KILIAN, AUGUST							
KOHA	OFFICE OF PRIMARY INTEREST / KËNGË E KËNGËTARES NË FOTO									
QYTET NË KROACI										
Ë / AA		NATRIUMI / NJËRI NGA XHEJMS BONDAT, TIMOTI (SHQ.)								
KOHA	LUAJ NË FILM	NEVOJË PËR USHQIM	KRYEMINISTRI EDI	EPOPE	LLOJ ANALGJETIKU / BREND ÇAJI ANGLEZ					
KËNGËTARJA JONË E NJOHUR NË FOTO										
LLOJ PESHKU (SHQ.)						LLOJ BIRE / HALLKË ZINXHIRI				VEPËR E JOSIP RELES
EKIP, SKUADËR				QERPIÇ, PLITHAR (BISED.) / NONPROFIT ORGANIZATION					AZOTI / DETEKTIVI AMERIKAN, ELIOT	
RUMANIA		ELEMENT KIMIK (SB) / HELIUMI								
OHRI			PLUHUR LULESH (SH.) / HIDROGJENI							
KËNGË E KËNGËTARES NË FOTO							REGJISORI QOSJA			

ZGJIDHJET: P, SAKO, AJNUR, ATRI, ME, GJ, OPI, KNIN, Ë, NA, ANDOL, AURELA GAÇE, KRAPI, ALE, TIM, PLIT, N, R, ANTIMONI, OH, POLENET, JEHONË, ISA.

Sudoku

shumë i lehtë

4					3			6
5	1						4	8
	9				7		5	
9	5			7			2	3
	8		6		4		9	
				9				
	7		3				8	
8	3						1	5
1			4					9

mesatar

8			6					2
		3			4	7		
				7	5			
	9						5	3
	3		8		7		9	
6	5						7	
				9	6			
		4			1	8		
3			4					7

Shumë i lehtë: 428513976, 517926348, 693847152, 956178423, 782634591, 341295867, 279351684, 834769215, 165482739. **Mesatar:** 879613542, 523984716, 146275389, 798162453, 432857691, 651349278, 287596134, 964731825, 315428967.

NJIHUNI ME VAJZA KA 25 EMRA, NUK I DI ENDE TË GJITHË

Një vajzë ka 25 emra të mesëm dhe ende nuk i ka mësuar të gjithë. Mbani frymën, Willow-Sullivan Corbett Fitzsimmons Jefferies Hart Burns Johnson Willard Dempsey Tunney Schmeling Sharkey Carnera Baer Braddock Louis Charles Walcott Marciano Patterson Johansson Liston Clay Frazier Fareman Taylor-Brown. Nëna e 10 vjeçares Maria tha se kjo është një traditë familjare që u nis nga familja e saj në vitin 1974. 44-vjeçarja tha se familja i vendosi 25 emra. Të gjithë emrat e mesëm të 10-vjeçares janë emra futbollistësh të famshëm. Gjyshi i Willow udhëtonte shumë jashtë vendit për të parë ndeshjet e boksit.

Willow Taylor-Brown, emri shkurt, mori emrat e çdo kampioni boksi të peshës së rëndë deri në vitin 1974. Emri i boksierit të madh Muhammed Ali, Joe Frazier, George Foreman, Sonny Liston dhe Rocky Marciano janë të gjithë në funksion të emrit të vajzës së vogël. Dhe të 25 emrat shfaqen të gjitha në certifikatën e lindjes së Willow dhe në pasaportë. Maria u shpreh: "Willow nuk i di të gjithë emrat, vetëm disa. As unë nuk i kujtoja dot emrat derisa u rrita. Por tradita nuk ndalet me Willow, vajza ime tjetër Autumn, 11 vjeç, ka gjithashtu të njëjtë emra të mesëm. Tradita e emrave është diçka që ka mbajtur familjen në qendër të vëmendjes prej vitesh.

Fiton 184 milionë franga në loto, por nuk shkon ende t'i marrë

Javën e kaluar një person me fat nga Zvicra veriperëndimore fitoi 184 milionë franga. Por, ai nuk i ka marrë ende paratë, siç njofton Swisslos. Zëdhënësi i Swisslos, Willy Mesmer, thotë për BLICK se zakonisht fituesit e çmimit të parave marrin disa ditë, një javë është normale. Edhe herën e fundit, djaloshi me fat priti pothuajse katër javë përpara se të merrte 157 milionë franga nga lotaria në fjalë, përcjell albinfo.ch. Në fund të fundit, paparacët gjithmonë do të kërkonin fituesit e çmimit përpara zyrës së Swisslos në Bazel. Gjithashtu, transferimi i parave mund të rregullohet në një vend tjetër përveç zyrës. Swisslos i dha fituesit gjashtë muaj kohë për t'i marrë paratë e fituara në lotarinë evropiane "Euro Millions".

Kush jetojnë më gjatë, besimtarët apo ateistët?

Shkencëtarët kanë bërë një studim në lidhje me jetëgjatësinë e besimtarëve dhe ateistëve. Studiuesit kanë marrë në studim, rreth 1000 lajmërime vdekjeje në SHBA, dhe në përfundim kanë arritur se besimtarët jetojnë rreth 4 vite më shumë sesa ateistët.

Shkencëtarët thonë se kjo lidhje ekziston për disa arsye: E para sepse besimtarët zakonisht angazhohen në aktivitete sociale gjatë gjithë jetës së tyre – një faktor ky që lidhjet me jetëgjatësinë. Përveç socializmit, elemente të tjera të besimit fetar, si konsumimi i ulët i alkoolit, mund të kontribuojnë.

"Ka akoma më shumë përfitime të besimit fetar, të cilat nuk mund të shpjegohen", thotë autorja kryesore e studimit, Laura Wallace. "Studimi siguron të dhëna bindëse që ka një lidhje mes besimit fetar dhe sa gjatë jeton një person", thotë ai.

Shet trupin për nënën e sëmurë

E rritur në familje mesatare, ajo ka shkruar se nuk mund të grumbullojë fonde të mjaftueshme për kancerit e së ëmës kështu që ka treguar se ka 'nxjerrë veten në shitje'. Cao Mengyuan ka shkruar se operacioni kërkon 41 mijë paund dhe tani po kërkon 'blerësin' me shumën më të madhe dhe ai do të mund të vendosë së çfarë do të kërkoj në këmbim. Burime pranë 'MailOline' kanë treguar se adoleshentja ka pranuar një 'ofertë bujare' duke grumbulluar të tëra paratë por që s'është bërë e ditur se çfarë do të kërkojë personi nga Cao. E ëma e saj është diagnostifikuar me kancer të lëkurës dhe mjekët kanë thënë se operacioni është rrugëdalja e vetme për të shpëtuar. Nëna e Caos është shtruar në spital dhe pritet t'i nënshtrohet operacionit në muajt në vazhdim.

KALENDARI HISTORIK 16 TETOR

1600 - Anijet e Olivier van Noorts arrijnë në Filipine.
1710 - Trupat britanike okupojnë Port Royal, Nova Scotia
1757 - Trupat austriake okupojnë Berlinin.
1813 - Beteja e Laipcigut (Napoleoni kundër Prusisë, Austrisë dhe Rusisë)
1903 - Themelohet organizata e parë vetëmbrojtëse e hebrenjve Homel në Rusi.
1915 - Britania e Madhe i shpall luftë Bullgarisë.
1923 - Themelohet Kompania Disney.
1926 - Mohammed Nadir Khan fillon krim të organizuar në Afganistan, 1200 të vrarë.
1940 - Benjamin Oliver Davis Sr emërohet gjenerali i parë zezak në armatën e rregullt.
1941 - Legjionarët rumun futen në Odesa të Rusisë.
1943 - Trazira kundër hebrenjve në Romë.
1964 - Kina shpallet fuqia e 5-të nukleare në botë.
1973 - Tanket izraelite nën Gjen. Sharon lëvizin në Kanalin e Suezit.
1973 - Kissinger dhe Le Duc Tho së bashku marrin Çmimin Nobel për Paqe.

A E DINI SE...

MUNGESA E GJUMIT DHE VETËVRASJA

Shkencëtarët amerikanë kanë gjetur se sasia e gjumit më pakë se gjashtë orë gjatë natës trefishon mendimet për vetëvrasje te të rinjtë e moshës nga 13 deri në 19 vjeç. Gjatë studimit, rezultatet e të cilit janë publikuar në revistën "JAMA Pediatrics", janë përdorur të dhënat e Hulumtimit i Sjelljeve të Rrezikshme te të Rinjtë të kryer në mes të shkurtit të vitit 2007 dhe majit të vitit 2015. Në studim, pjesëmarrësit janë ndarë në tre grupe, persona që flenë tetë orë ose më shumë, shtatë orë dhe gjashtë orë ose më pak, ndërsa janë analizuar sjelljet e konsideruara si shumë të rrezikshme te këto grupe. Në studim u konstatua se të rinjtë që flenë më pak se gjashtë orë në natë, në krahasim me ata që flenë tetë orë ose më shumë, kanë tre herë më shumë sjellje të rrezikshme, siç janë mendimet për vetëvrasje, planifikimi ose tentativa për vetëvrasje.

BARSOLETA

DJALI INTELIGJENT

Një djalë shumë "inteligjent" shkon për të kërkuar dorën e vajzës, tek shtëpia e të atit të saj.
- Kam ardhur t'ju kërkoj dorën e vajzës suaj?
- Cilën, të madhen apo të voglën?
- Më falni, por nuk e dija që vajza juaj paska një dorë të madhe dhe tjetrën më të vogël...

THËNIA E DITËS

Mos shko aty ku të shpie shtegu, por shko atje ku nuk ka shteg dhe lër gjurmë.
(Ralph Ualdo Emerson)